AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

RAPORT VJETOR

Për Gjendjen e Mjedisit

2022

Korrik, 2023
Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS	KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE	KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit 2022

Korrik 2023
Prishtinë,

Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 98 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, në Seancën plenare të mbajtur më 28 mars 2024, pasi e shqyrtoi Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2022, nxori këtë:

V Ë N D I M

Miratohet Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2022.

Nr. 08-V- 705

Prishtinë, 28.03.2024

Glauk Konjufca
Kryetar i Kuvendit

Kopja e Vendimit i dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Drejtorisë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/169
Datë: 27.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë për vitin 2022.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Përmbajtja

1. Hyrje **11**
2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit **12**
3. Gjendja e mjedisit dhe trendi **16**
3.1. Ajri 16
3.1.1. Cilësia e ajrit 16
3.1.2. Emisionet në ajër 22
3.1.3. Emisionet e gazrave serrë (GHG) 24
3.2. Uji 26
3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore 26
3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore 30
3.2.3. Trajtimi i ujërave të ndotura 31
3.3. Toka/dheu 32
3.3.1. Përdorimi i tokës në bujqësi 33
3.3.2. Monitorimi i tokave 34
3.3.3. Ndotja e tokave 35
3.4. Menaxhimi i Mbeturinave 36
3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale 38
3.4.2. Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale 39
3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare 41
3.4.4. Mbeturinat spitalore 43
3.4.5. Trajtimi i mbeturinave 44
3.4.6. Mbeturinat industriale 44
3.4.7. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës 46
3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit 47
3.5.1. Zonat e mbrojtura 47
3.5.2. Flora dhe vegjetacioni 49
3.5.3. Fauna 51
4. Shfrytëzimi i resurseve natyrore 53
4.1. Shfrytëzimi i resurseve minerare 53
4.2. Shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve 54
4.3. Shfrytëzimi i resurseve ujore 55
4.4. Shfrytëzimi i resurseve pyjore 56
5. Ndikimet mjedisore në shëndetin publik **57**
5.1. Shëndeti publik 57
5.2. Cilësia e ujit të pijes 60
6. Gjendja e mjediseve të rrezikuara **62**
6.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut 62
6.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit 64
6.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem 65
6.4. Zonat tjera të rrezikuara (Hotspotet mjedisore 67
7. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit **69**

7.1. Përafrimi i legjislacionit mjedisor kombëtar me Direktivat e BE-së 69
7.2. Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore 71
7.3. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit 74
7.4. Leje- dhënia 76
7.5. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale 77
7.6. Investimet në mbrojtjen e mjedisit 78
8. Rekomandimet 82
9. Referencat 85
10. Shtojcat 87

Lista e Shkurtesave

3R	Reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi.
AKS1	Aglomeracioni i Kosovës 1.
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës.
AQI	Air Quality Index (Indeksi i Cilësis së Ajrit).
ARPL	Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore.
ARRU	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit.
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës.
BB	Banka Botërore.
BE	Bashkimi Evropian.
BEZH	Banka Evropiane për Zhvillim.
CH_4	Metani
CLC	Mbulueshmëria e Tokave sipas Metodologjisë CORINE.
DPQ	Departamenti i Prodhimit të Qymyrit.
ECRAN	Rrjeti Regjional i Paraaderimit për Mjedis dhe Klimë.
EIONET	Rrjetit Evropian për Monitorim dhe Vëzhgim.
ELV	Emission Level Values
EQ	Equivalent
ESS L.L.C	Environmental Sustainable Solution
FLII	The Forest Lanscape Integrity Index
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
Gg	Giga gram
GHG	Gazra serrë
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman.
H	Niveli
IHMK	Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës.
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës.
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së.
IPCC	Leje e Integruar Mjedisore.
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës.
IWRM-K	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë.
JICA	Agjencia Ndërkombëtare Japoneze për Zhvillim.
KE	Këshilli Evropian.
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës.
KFOR	Kosovo Forces
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.
KPMMK	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë.
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave.
KRU	Kompania e Ujësjellësve Rajonal.
LM	Leje Mjedisore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural.
MEF	Ministria e Financave.
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
MN	Monument i Natyrës.
MNRV	Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë.

MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
MTS	Materiet Totale te Suspenduara.
MTS	Materiet totale të suspenduara
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë.
OE	Operatorë Ekonomik.
OJQ	Organizatë Joqeveritare.
PK	Park Kombëtar.
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis.
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.
PMK	Programi Mjedisor i Kosovës.
PT	Pluhuri Total.
Q	Prurje
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës.
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare.
RM	Rezervat Natyrorë.
SIDA	Agjencia Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar.
SKZH	Strategjinë Kombëtare për Zhvillim
SNK	Strategjia për Ndryshime Klimatike.
SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit.
SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit.
TC	Termocentral.
TCA	Termocentrali A.
TCB	Termocentrali B.
UA	Udhëzim Administrativ.
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara.
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.
UNFCCC	Konventa Kornizë për Ndryshime Klimatike e Kombeve të Bashkuara.
VML	Vlera Maksimale të Lejuara.
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZKS1	Zonë Monitoruese Kosova 1.
ZRRE	Zyra Rregullatore e Energjisë.

Lista e Figurave

Figura 1:Vendndodhja e statcioneve për monitorim të cilësisë së ajrit 16
Figura 2: Aglomeracionet për monitorim të cilësisë së ajrit 17
Figura 3. Koncentrimi i parametrave të monitoruar të cilësisë së ajrit në AKS 1 18
Figura 4. Koncentrimi vjetor i parametrave të cilësisë së ajrit në ZKS 1 19
Figura 5.Trendi i mesatareve vjetore të PM_{10} për vitet 2013-2022 20
Figura 6. Trendi i mesatareve vjetore të $PM_{2.5}$ për vitet 2013-2022 20
Figura 7. Trendi i mesatareve të O3 për vitet 2013-2022 21
Figura 8. Trendi i mesatareve vjetore të SO_2 për vitet 2013-2022 21
Figura 9. Trendi i mesatareve vjetore të NO_2 për vitet 2013-2022 22
Figura 10. Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2022 22
Figura 11. Trendi i emetimeve në ajër 2014-2021 (ton/vitë) 24
Figura 12. Gazrat e emetuara (%) 26
Figura 13. Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëvë- IHMK 2022 (Pellgu i Drinit të Bardhë) 27
Figura 14. Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve- IHMK 2022 (Pellgu i Ibrit) 27
Figura 15. Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve- IHMK 2022 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit) 28
Figura 16. Trendi i vlerave mesatare të nivelit të ujit H (cm) 2021- 2022 sipas statcioneve matëse... 31
Figura 17. Përbërja e mbeturinave në Kosovë 41
Figura 18. Deponimi i mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë, 2017-2021 42
Figura 19. Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë, 2017-2021 42
Figura 20.Trajtimi i mbeturinave në Kosovë, 2021 44
Figura 21. Gjenerimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë, 2021 45
Figura 22. Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2017-2021 45
Figura 23. Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës së importuar, 2017-2022 dhe Figura 24. Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të eksportuara, 2017-2022 46
Figura 25. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950-2022 47
Figura 26. Tulipani shqiptar (Tulipa albanica) (Foto:Xh.Mala) 49
Figura 27. Harta e Indeksit të Paprekshmërisë së Pyjeve të Kosovës 51
Figura 28. Trendi i emsioneve te NOx dhe SOx për vitet 2020-2022 66
Figura 29. Opsionet e depozitave të mbeturinave të rrezikshme në zonën e Termocentralit A 68

Lista e Tabelave

Tabela 1.Të dhënat për cilësnë e ajrit sipas parametrave dhe statcioneve monitorue se në aglomeracionin KS1 për vitin 2022 18
Tabela 2.Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe statcioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2022 18
Tabela 3.Emisionet në ajër për ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vitë) 23
Tabela 4.Emetimet e përgjithëshme të gazrave serrë në Kosovë, sipas sektorëve për vitin 2021 25
Tabela 5. Kategoritë kyçe të emetimeve për vitin 2021 sipas IPCC 25
Tabela 6. Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjëve 2021-2022 29
Tabela 7. Vlerat mesatare vjetore të nivelit të ujit H (cm) sipas statcioneve matëse për vitin 2022 dhe trendi në raport me vitin 2021 30
Tabela 8. Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive 34
Tabela 9. Burimet e ndotjes së tokave në Kosovë 35
Tabela 10. Gjenerimi i mbeturinave komunale kg \banor\vitë (2021 & 2022) 38
Tabela 11. Përbërja e mbeturinave 40
Tabela 12. Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale 43
Tabela 13. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2022) 48
Tabela 14. Numri i llojeve të myshqeve në Kosovë dhe statusi i kërcënimit 50
Tabela 15. Numri i llojeve të kërpurdhave në Kosovë 50
Tabela 16. Indeksi i paprekshmërisë së pyjeve të Kosovës 51
Tabela 17. Vlerësimi i numrit të llojeve të faunës sipas grupeve në Kosovë dhe numri i tre në listën e kuqe të IUCN 52
Tabela 18. Dendësia mesatare e popullatave për disa lloje të gjitarëve të egër 52
Tabela 19. Sasia e rezervave të shfrytëzuara minerare për vitin 2022 53
Tabela 20. Sipërfaqet e degraduara të disa lumenjëve në Kosovë 54
Tabela 21. Shfrytëzimi i ujit 2021-2022 nga ndërrmarrjet e mëdha industriale 55
Tabela 22. Prodhimi i ujit (mil.m³/vitë) 2019-2022 55
Tabela 23. Ujitjet në bujqësi 2019 -2022 mil.m/vitë 56
Tabela 24. Sasia e masës drunore (m³) e shfrytëzuar sipas regjioneve dhe sektorëve për vitin 2022 56
Tabela 25. Ndërlidhja e vdekjeve të parakohshme me nivelin e koncentrimit të ndotjes së ajrit 57
Tabela 26. Sëmundjet të ndërlidhura nga ndikimet mjedisore 58
Tabela 27. Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-ve 2022 60
Tabela 28. Disa nga treguesit kryesor të operimit të KEK-ut gjatë vitit 2022 62
Tabela 29. Mbeturinat metalike, vajra, shirit transportues 63
Tabela 30. Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO2, NOx dhe pluhurin total nga TCA dhe TCB 2021-2022 63
Tabela 31. Sasia totale vjetore e pluhurit të emetuar nga Feronikeli për vitin 2022 64
Tabela 32. Sasia totale vjetore e ndotësve CO, NOx dhe SO2 për vitin 2022 nga Feronikeli 65
Tabela 33. Gjenerimi i mbeturinave industriale nga Feronikeli për vitin 2022 65

Table 34. Koncentrimi vjetor i parametrave të cilësisë së ajrit në zonën e fabrikës 2021-2022 66
Tabela 35. Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2022 67
Tabela 36. Niveli i transpozimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian për mjedis në legjislacionit nacional mjedisor 69
Tabela 37. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit 71
Tabela 38. Planet mjedisore në nivel lokal 2022..... 73
Tabela 39. Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore 2020-2022 74
Tabela 40. Kallëzimet penale në prokurorotë themelore për dëmet në resurset natyrore në PK 2022..... 75
Table 41. Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2022 75
Tabela 42. Aktivitetet për leje -dhënie gjatë vitit 2022 76
Tabela 43. Buxheti i MMPHI për 2021-2022 78
Tabela 44. Disa nga projektet kapitale mjedisore të mbështetura nga buxheti i MMPHI 2022..... 79
Tabela 45. Disa nga projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2022 80

1. Hyrje

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është i bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit[1]. Sipas nenit 25, të këtij ligji, Qeveria e Kosovës me propozim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ia paraqet Kuvendit Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit.

Raporti duhet të përmbajë të dhëna për: gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm, shfrytëzimin e resurseve natyrore, ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës, gjendjen e mjediseve të rrezikuara, zbatimin e strategjisë së mjedisit dhe planin e veprimit, masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e institucioneve mjedisore, si dhe financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është institucioni që harton këtë dokument. Ky raport vjetor paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2022, por edhe të dhënat e më hershme kanë zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi.

Për hartimin e raportit, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore, që tani janë prezantuar në këtë raport.

Prezantimi i gjendjes për disa sektor mjedisor është më pak i mbuluar, si pasojë e mungesës së të dhënave, mungesës së monitorimit, bazës ligjore të pamjaftueshme apo edhe aspekte tjera institucionale e menaxhuese. Andaj, përmbajtja dhe cilësia e këtij raporti deri në një masë, është edhe reflektim i cilësisë së monitorimit që zbatohet në shkallë vendi, si dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor.

Qëllimi kryesor i këtij raporti, është informimi i institucioneve vendimmarrëse për gjendjen e mjedisit në Kosovë, me qëllim që të dhënat e prezantuara të shërbejnë për hartimin e politikave adekuate mjedisore, si dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis, siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

[1] *Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025*

2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit

Ajri - Të dhënat nga monitorimi, përmbajnë të dhëna për tejkalimet e vlerave maksimale të lejuara për disa parametra, e në veçanti për PM10 dhe PM2.5, dhe kjo kryesisht gjatë sezonit të dimrit. Numri më i madh i ditëve me tejkalime është regjistruar në stacionet matëse në Prishtinë Rilindja (59), Obiliq (40), Pejë (41) dhe Gjilan (52). Koncentrimi më i lartë i mesatares vjetore për PM10 është regjistruar në stacionet `Rilindja-Prishtinë` me 32.5 µg/m3 dhe në Gjilan 30.2 µg/m^3. Sa i përket trendit të koncentrimit vjetor të parametrave të monitoruar, bazuar në të dhënat vjetore për periudhën 2013-2022, vërehet një rënie e ndjeshme e koncentrimit të ndotësve, e që mund të ndërlidhet edhe me masat që janë ndërmarrë për reduktimin e ndotjes. Sa i përket emetimeve në ajër, sipas vlerësimit të bazuar në konsumin e lëndëve djegëse, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO2 dhe SO2 është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, pluhurit total dhe monoksidit të karbonit (CO), burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO2 pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese dhe e ndërtimit është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2021, janë vlerësuar rreth 10266 Gg (Giga gram) CO2 eq, (equivalent) ose rreth 10.6 milion ton CO2 eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë me pjesëmarrje prej 87% të totalit te emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 7%, kurse sektori i mbeturinave përfaqëson 4% të totalit të emisioneve. Gazi kryesor i emetuar është CO_2 me 88%, Metani (CH_4) merr pjesë me rreth 10% të emetimeve totale, ndërsa N_2O dhe HFC marrin pjesë me rreth 1% të emetimeve. Implementimi i ligjeve, akteve nënligjore dhe i politikave për sektorin e ajrit, sikurse është rasti i politikave për kontrollin e emisioneve nga burimet e lëvizshme dhe atyre për kontrollin e cilësisë së naftës, konsiderohet të jetë në nivel jo të kënaqshëm. Nivel i ulët i zbatimit të kërkesave ligjore është edhe në nivelin lokal.

Uji - Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja, që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve dhe fertilizerëve në bujqësi, dëmtimit të shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve, si dhe nga ndërtimet ilegale. Gjatë vitit 2022, monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore është realizuar në 54 pika monitoruese në lumenj. Treguesit e cilësisë së ujërave të prezantuara në këtë raport, tregojnë për prani të ndotësve organik në ujërat e lumenjve, megjithëse mund të konstatohet që ujërat sipërfaqësore nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi. Monitorimi i sasisë së ujërave është realizuar në 25

stacione matëse, sa i përket nivelit H (cm) dhe 8 stacione matëse sa i përket prurjeve Q (m^3 /sec). Kosova ende nuk ka monitorim të rregullt të cilësisë së ujërave të liqeneve, dhe ujërave nëntokësore, sikurse që nuk ka as monitorim biologjik të ujërave sipërfaqësore. Po ashtu në Kosovë ende nuk është i zhvilluar plotësisht sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura, edhe pse gjatë vitit 2022 ka pasur progres në këtë fushë. Trajtimi i ujërave të ndotura mbetet ende në shkallë të ulët me vetëm 25% nga tërë sasia e ujërave të ndotura. Mbështetja nga donatorët për menaxhimin e integruar të resurseve ujore gjatë vitit 2022, ka qenë një nga zhvillimet pozitive në këtë sektor.

Toka - Aktualisht Kosova, nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulueshmërisë së tokave, është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. Bujqësia, konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokave bujqësore, që vije si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kimikateve tjera për trajtimin e tokave. Po ashtu edhe deponitë sanitare dhe ilegale të mbeturinave, industritë aktive dhe ato të vjetra, janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kimikateve, që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

Menaxhimi i Mbeturinave - Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori, është vlerësuar të jetë 248 kg/banorë/vit. Aktualisht, në nivel nacional grumbullohen rreth 90% të mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohen në deponi sanitare, ndërsa ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes së mbeturinave në burim, si dhe riciklim të mbeturinave. Në vitin 2022 shënohet një rritje e deponimit të mbeturinave në sasi prej 43,623 ton, apo 9.77% më shumë krahasuar me vitin paraprak 2021. Menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës nuk është i mirë dhe ndër problemet kryesore janë mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara si dhe mbulimi jo adekuat i mbeturinave. Në kuadër të përbërjes së mbeturinave, mbeturinat organike marrin pjesë me 30.4%, plastika 20%, letër dhe karton 15%, mbeturinat e gjelbra me 5%, tekstili 5%, qelqi 5%. Gjatë vitit 2022 ka pasur një rritje prej 157,970 kg më shumë të mbeturinave spitalore të trajtuara-sterilizuara, respektivisht 920,780.25 kg mbeturina, apo 20% më shumë krahasuar me vitin 2021. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm të institucioneve qendrore, komunave dhe donatorëve, deponitë ilegale vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori. Aktivitetet për ndarjen në burim, trajtimin e mbeturinave, riciklimin e mbeturinave dhe aspektet tjera që ndërlidhen me ekonominë qarkore, ende janë në një shkallë të ulët.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti - Gjatë vitit 2022, regjistri kombëtarë i zonave të mbrojtura është shtuar edhe për 12 zona të reja, duke e rritur numrin e zonave të mbrojtura në 260 zona, me një sipërfaqe prej 126,115.8 ha ose 11.6% e territorit të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës. Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes, të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse. Problem, vlerësohet të jetë edhe Mungesa e planeve menaxhuese dhe planeve rregulluese për zonat e mbrojtura. Nga monitorimi i faunës përmes kamerave kurthe, janë marrë informacione për praninë e disa llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës në Kosovë dhe gjendja e tyre vlerësohet e kënaqshme. Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi, apo llojeve të veçanta në veçanti. Si aktivitete me rëndësi dhe me ndikime pozitive për menaxhimin ndërkufitar të zonave natyrore, vlerësohen disa iniciativa dhe projekte ndërkufitare.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore - Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare që realizohen përmes gurëthyesve, është një nga format më të shpeshta të shfrytëzimit të resurseve natyrore në Kosovë. Gjatë vitit 2022 janë lëshuar 232 licenca për shfrytëzim të gurit dhe 170 licenca për hulumtime të rezervave të gurit.
Të dhënat flasin se ka edhe operatorë ilegal që merren me këtë veprimtari. Bazuar në vlerësimet e realizuara, sipërfaqet e degraduara të lumenjëve nga shfrytëzimi i inerteve janë në rritje.
Prodhimi total i ujit të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2022 ka qenë 156,8 milion m^3, ndërsa sasia e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi në vitin 2022 ishte 93.34 milion m^3 ujë. Sa i përket pjesëmarrjes së llojeve të burimeve të ujit në të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2022, 58% e tyre janë marrë nga liqenet akumuluese, 28% nga lumenjët, 5% nga burimet dhe 10% nga puset.

Vlerësohet se gjatë vitit 2022, sipas planifikimit janë shfrytëzuar rreth 145,705 m^3 dru nga pyjet publike. Prerjet ilegale mbeten një nga sfidat kryesore të sektorit të menaxhimit të pyjeve. Gjatë vitit 2022, nga Njësitë Komunale të Pylltarisë janë konfiskuar 1,789.86 m^3 masë drunore, nga e cila 151.92 m^3 dru teknik dhe 1,637.94 m^3 dru zjarri. Kurse nga Inspeksioni Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë të APK-së janë konfiskuar gjithsejtë 225.64 m^3 masë drunore, (prej tyre 194.67 m^3 dru zjarri dhe 30.97 m^3 dru teknik).
Gjatë vitit 2022 nga zjarret pyjore janë përfshirë 1,596.98 ha pyje dhe toka pyjore, nga të cilat 976.12 ha në pyje publike dhe 620.86 ha në pyje private. Nga buxheti APK-së janë pyllëzuar 111.04 ha sipërfaqe me pyje.

Shëndeti publik- Numri i sëmundjeve ambientale të regjistruara, gjatë vitit 2022 ka shënuar rritje. Sipas vlerësimeve të bërë nga të dhënat e analizuara, është konstatuar se ka pasur 105491 raste me shumë të sëmundjeve ambientale për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ose rreth 46.5% me shumë.
Sipas vlerësimeve ekspozimi ndaj koncentrimi të PM2.5 ishte i ndërlidhur me 359 vdekje të parakohshme. Ekspozimi ndaj koncentrimi të NO2 ishte i ndërlidhur me 264 vdekje të parakohshme, ndërsa ekspozimi ndaj koncentrimi të O3 ishte i ndërlidhur me 135 vdekje të parakohshme.
Bazuar në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit të realizuara nga KRU-të, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve gjatë vitit 2022, ka qenë ne përputhje me standardet e ujit të pijshëm me një përputhshmëri prej 98.5% për testet bakteriologjike dhe 94.7% për testet kimike. Krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, gjatë vitit 2022, ishte më e mirë për përshtatshmëri bakteriologjike dhe më e dobët për përputhshmëri fiziko-kimike.
KRU-të si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit për vitin 2021, kanë ofruar shërbime të ujësjellësit tek 79% e popullatës. Shprehur në terma të vendbanimeve, nga gjithsej 1,240 janë vetëm 672 vendbanime që kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU. Gjatë vitit 2022 janë shtuar 6 sisteme rurale të ujësjellësit nën menaxhimin e të gjitha KRU-ve krahasuar me vitin 2021.

Mjediset e rrezikuara- në mënyrë më specifike në raport është trajtuar gjendja mjedisore në zonat e veprimit të operatorëve të KEK, Feronikel dhe Sharrcem, ku janë trajtuar aspektet e përgjithshme të menaxhimit të mjedisit, duke përfshirë emetimet në ajër, shkarkimet në ujë, menaxhimi i mbeturinave industriale, si dhe aspekte tjera mjedisore. Në raport janë prezantuar edhe të dhëna të përgjithshme edhe për 17 lokacione të tjera të cilat konsiderohen si hotspote mjedisore, e që janë krijuar kryesisht si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide, herbicide etj.

Masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit - Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit nacional me direktivat e BE-së, megjithëse sfidë mbetet implementimi i tyre. Janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisor si në nivelin qendror dhe atë lokal, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Edhe pse gjatë vitit 2022 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisit janë ende në numër shqetësues. Përkundër mungesës së stafit dhe mungesës së zbatimit të rregulloreve për strukturën organizative institucionale, institucionet mjedisore po përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë të kënaqshme dhe ka raste kur arrihen edhe rezultate mbresëlënëse. Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë.

3. Gjendja e mjedisit dhe trendi

3.1. Ajri

3.1.1. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit përshkruhet sipas Indeksit të Cilësisë së Ajrit (AQI), i cili bazohet në përqendrimin e ndotësve të pranishëm në ajër në një vend të caktuar. Në këtë raport janë paraqitur tabelat me të dhëna për mesatare vjetore dhe numri i ditëve me tejkalime. Matjet qe janë realizuar nga stacionet për monitorim në kohë reale të cilësisë së ajrit (figura 1).




Figura 1:*Vendndodhja e statcioneve për monitorim të cilësisë së ajrit*

Monitorimi i cilësisë së ajrit - Monitorimi i cilësisë së ajrit është vlerësim sistematik dhe afatgjatë i niveleve të ndotësve, duke matur cilësinë e ajrit në një rrethinë të caktuar. Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet për grimcat e pluhurit (PM10 dhe PM2.5) si dhe katër lloje të gazrave (NO2, SO2, O3 dhe CO). Tabela me të dhëna për stacionet monitoruese dhe parametrat e monitoruar është prezantuar në shtojcën 1 të raportit.

Normat e cilësisë së ajrit të zbatueshme për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit, të cilat janë prezantuar në shtojcën 2 të këtij raporti, ndërsa Indeksi i Cilësisë së Ajrit është prezantuar në shtojcën 3. Sistemi online ofron mundësinë e informimit për gjendjen reale dhe parashikimin e cilësisë ajrit në territorin e Republikës së Kosovës. Raportimi për cilësi të ajrit nga rrjeti i monitorimit, administrohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë është i ndarë në dy zona: Aglomerati -AKS1, me stacionet IHMK, Rilindja, Obiliqi, Dardhishtë dhe Palaj dhe Zona ZKS1, me stacionet në Gjilan, Pejë, Prizren, Drenas, Brezovicë, Mitrovicë dhe Hani i Elezit (figura 2).




Figura 2: *Aglomeracionet për monitorim të cilësisë së ajrit*

Në zonën AKS1, të dhënat tregojnë se nuk ka pasur tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore sipas standardit 40 µg/m3 parametrin PM10, po ashtu edhe në

parametrat e tjerë të monitoruar, nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore në asnjë nga stacionet monitoruese. Ndërsa numri i ditëve me tejkalime për 24 orë për parametrin PM10, tregon se ka pasur tejkalime të vlerave limite ditore të standardit 50 µg/m3 për këtë parametër në stacionin Rilindja-Prishtinë (59 ditë) dhe në stacionin në Obiliq (40 ditë).

Tabela 1.Të dhënat për cilësnë e ajrit sipas parametrave dhe statcioneve monitoruese në aglomeracionin KS1 për vitin 2022

Stacionet	PM 10 µg/m^3	PM 2.5 µg/m^3	O3 µg/m^3	SO2 µg/m^3	NO2 µg/m^3	CO mg/m^3	Nr. Ditëve me tejkalime për PM10
Prishtinë/IHMK	22.46	15.88	36.2	10.48	26.91	1.48	25
Prishtinë/Rilindje	32.52	21.18	46.03	9.88	16.83	0.83	59
Palaj	18.41	12.05	48.02	11.3	9.78	0.09	6
Obiliq	23.68	17.73	15.22	9.38	16.03	0.83	40
Dardhishtë	22.17	15.44	32.09	8.82	11.27	1.3	22




Figura 3. *Koncentrimi i parametrave të monitoruar të cilësisë së ajrit në AKS 1*

Të dhënat e cilësisë së ajrit për shtatë stacionet monitoruese të ZKS1, tregojnë se nuk ka pasur tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore sipas standardit 40 µg/m3 parametrin PM10, po ashtu edhe në parametrat e tjerë të monitoruar, nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave limite të mesatares vjetore në asnjë nga stacionet monitoruese.

Ndërsa numri i ditëve me tejkalime për 24 orë për parametrin PM10, tregon se ka pasur tejkalime të vlerave limite ditore të standardit 50 µg/m3 për këtë parametër në stacionin e Gjilanit ku janë regjistruar 52 ditë me tejkalime (tabela 2 dhe figura 4).

Tabela 2.Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe statcioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2022

Stacionet	PM 10 µg/m^3	PM 2.5 µg/m^3	O3 µg/m^3	SO2 µg/m^3	NO2 µg/m^3	CO mg/m^3	Nr. Ditëve me tejkalime për PM10
Drenas	18.49	14.61	51.1	8.86	14.13	0.63	7
Mitrovicë	25.46	18.48	29.01	20.57	11.65	0.41	30
Pejë	23.56	17.25	58.22	9.33	15.48	0.63	27
Prizren	19.44	14.12	59.16	9.58	17.08	0.63	22
Brezovicë	10.51	7.32	78.4	5.52	5.68	0.66	2
Hani Elezit	19.62	14.46	59.2	5.41	15.4	0.33	7
Gjilan	30.25	24.17	51.97	3.72	21.21	0.65	52




Figura 4. *Koncentrimi vjetor i parametrave të cilësisë së ajrit në ZKS 1*

Trendi i cilësisë së ajrit - Sa i përket trendit të koncentrimit vjetor të parametrave të monitoruar, bazuar në të dhënat vjetore për periudhën 2013-2022, në vitin e fundit vërehet një rënie e ndjeshme e koncentrimit të ndotësve, e që mund të ndërlidhet edhe me masat që janë ndërmarrë për reduktimin e ndotjes.

Trendi i rënies së koncentrimit është evident sidomos në rastin e parametrave PM10, PM2.5 dhe NO_2 (figurat 5, 6 dhe 9) dhe për tri vitet e fundit, ndërsa për parametrat tjerë O_3, SO_2 dhe CO (figurat 7, 8 dhe 10), në tri vitet e fundit vërehet një trend më linear.




Figura 5.*Trendi i mesatareve vjetore të PM_{10} për vitet 2013-2022*




Figura 6. *Trendi i mesatareve vjetore të $PM_{2.5}$ për vitet 2013-2022*




Figura 7. *Trendi i mesatareve të O3 për vitet 2013-2022*




Figura 8. *Trendi i mesatareve vjetore të SO_2 për vitet 2013-2022*




Figura 9. *Trendi i mesatareve vjetore të NO_2 për vitet 2013-2022*




Figura 10. *Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2022*

3.1.2. Emisionet në ajër

Inventari i emisioneve, ofron një vlerësim të sasisë së ndotësve që lirohen në ajër nga burime të ndryshme. Inventari është një nga mjetet kryesore të përdorura në menaxhimin e cilësisë së ajrit, meqë ofron informata përmes të cilave kuptojmë se cilët janë kontribuuesit e ndotjes së ajrit sipas aktiviteteve dhe burimeve, duke mundësuar kështu ndërmarrjen e veprimeve efektive për të zvogëluar emetimet, si dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit ambiental.

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në baza vjetore bënë vlerësimin e emisioneve në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse. Gjatë vitit 2023 është bërë vlerësimi për emetimet në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse për vitin 2021. Në tabelën 3 janë prezantuar të dhënat për ndotësit kryesore sipas burimeve ndotëse.

Tabela 3. Emisionet në ajër për ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vitë) [2]

Burimet e emetimeve	**NO_2**	**SO2**	**PM2.5**	**PM10**	**PT[3]**	**NMVOC**	**CO**
Industria energjetike (Prodhimi i energjisë dhe ngrohjes)	16,046	107,735	210	507	751	90	564
Industria prodhuese dhe e ndërtimit	3,702	775	476	492	334	833	2,072
Transport (Aviacioni, automjetet dhe hekurudhat)	9,776	895	381	381	381	476	1,257
Djegiet e vogla (Komerciale, rezidenciale dhe nga bujqësia)	2,315	686	10,726	11,018	11,598	8,840	58,237
Gjithsej (ton/vit)	**31,839**	**110,091**	**11,793**	**12,398**	**13,064**	**10,239**	**62,130**

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e prezantuara në tabelë, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO_2 dhe SO_2 është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, Pluhurit total dhe Monoksidit të Karbonit (CO) burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO2 pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla.

Krahasuar me emetimet e vitit 2020, gjatë vitit 2021 është shënuar një ngritje e lehtë e emetimeve për të shumicën e ndotësve. Ndërsa gjatë periudhës 2014-2021, viti 2016 është viti me emetimet më të larta (figura 11).

[2] *Raporti vjetor i AMMK per emisionet në ajër sipas kërkesave të CLRTAP raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës (https://cdr.eionet.europa.eu/xk/un/clrtap/inventories/envyfo8xa/)*
[3] *Pluhuri Total*




Figura 11. *Trendi i emetimeve në ajër 2014-2021 (ton/vitë)*

Për të reduktuar ndotjen dhe për të zvogëluar emetimet nga burimet e ndryshme, kërkohet që të hartohen politika favorizuese për shfrytëzimin e lëndëve djegëse që kanë shkarkime më të ulëta në mjedis, si dhe për zbatimin e teknologjive të pastra në proceset e prodhimit. Po ashtu rekomandohet të favorizohet shfrytëzimi i transportit alternativ që ka shkarkime më të ulëta në ajër dhe të aplikohet kufizimi kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe atyre pa katalizatorë.

Ndër masat tjera që duhet te zbatohen janë: Rritja e efiçiencës së energjisë së ndërtesave dhe shtimi i hapësirave të gjelbra dhe promovimi, si dhe zbatimi teknologjive të pastra në proceset industriale në funksion të zvogëlimit të emetimeve në ajër, etj.

3.1.3. Emisionet e gazrave serrë (GHG)

Në kuadër të aktiviteteve për vitin 2023, AMMK ka bërë edhe vlerësimin e emetimeve të gazrave serrë për vitin 2021.
Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2021 janë vlerësuar rreth 10617 Gg (Giga gram) CO2 eq, (equivalent) ose rreth 10.6 milion ton CO2 eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë, me pjesëmarrje prej 87% të totalit te emetimeve.
Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 7%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 4% të totalit të emisioneve, kurse sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve me rreth 2% (tabela 4).

Tabela 4.Emetimet e përgjithëshme të gazrave serrë në Kosovë, sipas sektorëve për vitin 2021

Kategoria (sektori)	**Gg CO_2 eq.**	**%**
Energjia	9223	87
Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve	178	2
Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokave	746	7
Mbeturinat	470	4
Totali i emetimeve	**10617**	**100%**

Viti 2021 me 10617 CO_2 Gg eq., ka shënuar një trend të rritjes së emetimeve në krahasim me vitin 2020, ku janë kalkuluar 10266 CO_2 Gg eq., dhe me vitin 2019 ku janë kalkuluar 9995 Gg CO_2 eq.

Totali i emetimeve te gazrave serrë në Kosovë është i varur shumë nga sasia e energjisë së prodhuar nga thëngjilli që është burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë në vendin tonë.

Kategoritë kyçe të emetimeve të gazrave të serrës sipas IPCC janë: industria e energjisë, transporti rrugor, industria prodhuese dhe ndërtimit, fermentimi enterik, deponimi i mbeturinave të ngurta, prodhimi i çimentos, ujërat urbane, emetimet e drejtpërdrejta nga menaxhimi i tokës, menaxhimi i plehut etj. Për më shumë detaje tabela 5.

Tabela 5. Kategoritë kyçe të emetimeve për vitin 2021 sipas IPCC

Kodi i kategorisë sipas IPCC	**Kategoria sipas IPCC**	**Gazi serrë i emetuar**
1.A.1	Industritë e Energjisë	CO_2
1.A.3	Transporti Rrugor	CO_2
1.A.2	Industria Prodhuese dhe e Ndërtimit	CO_2
3.A.1	Fermentimi Enterik	CH_4
1.A.4	Sektorët e tjerë të Energjisë	CO_2
4.A	Deponimi i Mbeturinave të Ngurta	CH_4
2.A.1	Prodhimi i Çimentos	CO_2
4.D	Ujërat Urbane dhe Shkarkimet në Ujëra	CH_4, N_2O
3.C.4	Emetimet Direkte të N2O nga Menaxhimi i Tokës	N_2O
3.A.2	Menaxhimi i Plehut	CH_4
1.B.1	Lëndët djegëse të ngurta	CH_4
3.C.5	Emetimet Indirekte të N2O nga Menaxhimi i Tokës	N_2O

Gazi kryesor i emetuar është CO_2 me 88%, Metani (CH_4) merr pjesë me rreth 10% të emetimeve totale, ndërsa N_2O dhe HFC marrin pjesë me rreth 1% të emetimeve (figura 12).




Figura 12. *Gazrat e emetuara (%)*

3.2. Uji

3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në shtojacat 4 dhe 5 të raportit, janë prezantuar stacionet monitoruese të lumenjve, parametrat që monitorohen dhe frekuenca e matjeve.

Në këtë raport gjendjen e ujërave është pasqyruar përmes treguesve (parametrave): Oksigjeni i tretur (mg/l O_2); Shpenzimi biokimik i oksigjenit- $SHBO_5$ (mg/l O_2), Shpenzimi kimik i oksigjenit- SHKO (mg/l O_2); Karboni organik total-C (mg/l); Fosfori total – P (mg/l), Materiet totale të suspenduara-MTS (mg/L). Vlerat e prezentuara në grafikon janë si vlera mesatare për vitin 2022.

Parametrat si: oksigjeni i tretur (O2), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për dy lumenjtë: lumi Drini i Bardhë dhe lumi Ereniku (figura 13), ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten materiet totale të suspenduara /mg/l (MTS) dhe atë në stacionet monitoruese përgjatë rrjedhjes së lumenjëve duke përjashtuar stacionet referente (vendburimet).




Figura 13. ***Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëvë- IHMK 2022 (Pellgu i Drinit të Bardhë)***

Pellgu i Ibrit – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për këta lumenjë: Ibri, Sitnica, Prishtevka, Graqanka dhe Drenica (figura 14), nga ku vërehet se lumi Prishtevka/Bresje, pothuajse me të gjithë parametrat e paraqitur tregon vlera më të ngritura, ngase vetë shtrirja e lumit është përgjatë zonës më të populluar dhe që përfshinë edhe zona industriale.




Figura 14. *Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve- IHMK 2022*

(Pellgu i Ibrit)

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - Në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithsej katër stacione monitoruese (figura 15), ku ngritje e theksuar është parametri Shpenzimi Kimik i Oksigjenit. Ndërsa në Pellgun e Lepencit, janë përzgjedhur dy lumenj, ai i Lepencit dhe Nerodimja, ku edhe këtu shpenzimi kimik i oksigjenit tregon ngritje përgjatë rrjedhjes së lumit.




Figura 15. *Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve- IHMK 2022 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)*

Bazuar në këto tri grafikone (shtrirjen territoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve nuk paraqet ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet për vitin 2022 gjendet në mes 0.19 mg/l P (Ibër/Kushtovë) dhe 3.88 mg/l P (Prishtevka/Bresje).

Po ashtu, edhe treguesi Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit ($SHBO_5$), gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2022, tregon se vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 0.15 mg O_2/l Drini i Bardhë / Radavc dhe 43.65 mg O_2/l, në lumin Prishtevka / Bresje. Ku edhe për këtë vit, lumi Prishtevka / Bresje tregon për ndotje me vlerën më të lartë mesatare vjetore.

Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të $SHBO_5$, kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore i ekspozohen shkarkimeve të ujërave të ndotura përmes të cilave krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së $SHBO_5$.

Zhvillimi industrial, urbanizimi dhe bujqësia intensive, janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në cilësinë e ujërave sipërfaqësore. Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat

fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse, me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide, etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Trendi i ndryshimit të gjendjes së ujërave për vitet 2021 dhe 2022, për stacionet përktëse monitoruse për treguesit e përfshirë në këtë vlerësim është prezantuar në tabelën 6.

Tabela 6. Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjëve 2021-2022

Stacionet monitoruese	Oksigjeni i tretur/ mg/l O_2	Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O_2 ($SHBO_5$	Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHKO)	Karboni organik total/ mg/l C	Fosfori total/ mg/l P	Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS)
RV01_011	↓	↔	↔	↓	↑	↔
RV01_012	↑	↓	↓	↓	↓	↑
RV01_013	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV01_071	↑	↑	↑	↑	↑	↔
RV01_072	↑	↓	↓	↓	↓	↑
RV02_011	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV02_012	↑	↓	↑	↓	↑	↑
RV02_013	↓	↓	↓	↓	↑	↑
RV02_023	↔	↔	↔	↔	S'ka matje	↔
RV02_024	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV02_026	↑	↓	↑	↓	↑	↓
RV02_041	↓	↓	↓	↓	↑	↑
RV02_051	↓	↓	↓	↓	↔	↓
RV02_061	↑	↑	↑	↔	↑	↓
RV02_062	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV03_011	↑	↓	↓	↓	↑	↓
RV03_012	↔	↓	↓	↓	↔	↑
RV03_013	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV03_014	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_011	↓	↑	↑	↑	↑	↔
RV04_012	↓	↓	↓	↓	↔	↑
RV04_013	↑	↓	↓	↓	↓	↑
RV04_021	↓	↑	↑	↑	↑	↓
RV04_023	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_024	↑	↓	↓	↓	↑	↑

Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore

Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik, i cili përbëhet nga disa stacione matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Niveli (H) dhe Prurja (Q). Në tabelën 7 janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm) dhe prurja (Q) në stacionet hidrometrike të realizuara për vitin 2022.

Tabela 7. Vlerat mesatare vjetore të nivelit të ujit H (cm) sipas statcioneve matëse për vitin 2022 dhe trendi në raport me vitin 2021

Stacioni matës	Mes. (cm) 2021	Mes. (cm) 2022
Gjonaj	241	213
Këpuz	132	114
Deqan	S'ka matje	49
Grykë	76	72
Drelaj	60	67
Prizren	44	S'ka matje
Mirushë	62	58
Klinë	49	39
Leposaviç	180	164
Vragoli	89	S'ka matje
Nedakovc	186	174
Drenas	78	S'ka matje
Lluzhan	105	88
Lipjan	40	46
Mitrovicë	63	72
Orllan	S'ka matje	22
Mramorë	S'ka matje	13
Lupç i Epërm	S'ka matje	27
Konçul	217	231
Viti	37	35
Domorovc	107	102
Hani i Elezit	78	71
Brod	41	37
Kaçanik	41	43
Mlikë	S'ka matje	68

Në figurën 16 është prezantuar trendi i vlerave mesatare vjetore të nivelit te ujit H (cm) sipas stacioneve matëse për periudhën kohore 2021-2022. Nga figura vërehet se në vitin 2022 ka pasur një trend negativ sa i përket mesatareve vjetorë të nivelit të ujit në shumicën e stacioneve matëse. Trend pozitiv ose rritje e nivelit të ujit është shënuar në stacionet matëse në Drelaj, Mitrovicë dhe Konçul.




Figura 16. *Trendi i vlerave mesatare të nivelit të ujit H (cm) 2021- 2022 sipas statcioneve matëse.*

Në tabelën 8 është prezantuar trendi i vlerave mesatare vjetore të prurjeve Q (m^3/sec) sipas stacioneve matëse për periudhën kohore 2021-2022. Nga tabela vërehet se në vitin 2022 ka pasur një trend negativ sa i përket mesatareve vjetorë të prurjeve në stacionet: Gjonaj, Grykë, Lluzhan dhe Brod, ndërsa trend pozitiv për në stacionet matëse në Kaçanik.

Tabela 8: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m^3/sec) sipas stacioneve matëse **2021-2022**

Statcioni	**Mes.(m^3/sec) 2021**	**Mes.(m3/sec) 2022**
Gjonaj	89.649	61.209
Deqan	S'ka matje	1.74
Grykë	4.842	4.221
Prizren	1.943	S'ka matje
Lluzhan	3.819	2.088
Brod	1.394	1.282
Kaçanik	0.975	1.045
Mlikë	S'ka matje	1.367

3.2.3. Trajtimi i ujërave të ndotura

Kosova ende nuk e ka të zhvilluar sistemin e trajtimit të ujerave të ndotura, meqenëse ndodhet në fazën e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Sipas të dhënave nga ARRU shërbimi për grumbullimin e ujërave të ndotura brenda zonës së shërbimit të KRU-së gjatë vitit 2022, është ofruar për 65% të popullsisë[4].

[4] *Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar- Përputhshmëria me kushtet e licencës, ARRU 2022*

Ujërat e ndotura të grumbulluara shkarkohen në rreth 25 trupa ujore në gjendje kryesisht të pa-trajtuar edhe pse legjislacioni në Kosovë për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale që rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 30/2014, kërkon që të gjithë ndotësit të aplikojnë një trajtim paraprak të ujërave të ndotura para se t'i shkarkojnë ato në trupa ujore.

Trajtimi i ujërave të ndotura nga KRU mbetet ende i ulët me vetëm 25% nga tërë sasia e ujërave të ndotura të faturuara konsumatorëve nga të gjitha KRU. Kjo përqindje pritet të rritet, si rezultat i investimeve në impiantet e ujërave të ndotura. Deri më tani, janë në funksion 8 impiante për trajtimin e ujërave të ndotura. Këto shtatë impiante/sisteme trajtojnë ujërat e ndotura të vend-banimeve: Skënderaj, Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm, Tërnavc (i menaxhuar nga KRU Mitrovica), Mramor dhe Harilaç (i menaxhuara nga KRU Prishtina), një pjesë e zonës urbane të qytetit të Prizrenit (i menaxhuar nga KRU Hidroregjioni Juogor), zona urbane e qytetit të Pejës, vend-banimi Qyshk (i menaxhuar nga KRU Hidrodrini) dhe një pjesë e zonës urbane të qytetit të Gjakovës (i menaxhuar nga KRU Gjakova).

Sipas të dhënave të raportuara, në të gjitha këto sisteme trajtuese, testet e performuara kanë treguar se uji i trajtuar ka qenë 100% në përputhshmëri me standardet e nevojës biokimike për oksigjen dhe me nevojën kimike për oksigjen.

Në fazën e realizimit të punimeve dhe të funksionalizimit janë edhe impiantet për trajtimin e ujërave në Gjilan, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, dhe Mitrovicë. Në procesin e planifikimit janë edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Podujevë dhe Ferizaj.

Në zonat rurale janë edhe disa impiante tjera për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet të vogël, në lokalitetet: Skivjan (Gjakovë), Kuk/Kosavë (Dragash), Vrellë/Medvec (Lipjan), Hallaq i Madh (Lipjan), Kramovik (Rahovec), Volljak (Klinë), Marmull (Gjakovë), Banja e Pejës (Istog) dhe Orllan (Podujevë).

3.3. Toka/dheu

Toka (dheu) është një nga komponentët thelbësorë të tokës, e cila luan rol të pazëvendësueshëm në ciklet e natyrës, veçanërisht në ciklet e ujit dhe lëndëve ushqyese. Toka është burimi i 90% të të gjithë prodhimit të ushqimit, fibrave dhe lëndëve djegëse dhe gjithashtu ofron lëndë të parë të vlefshme për sektorët e hortikulturës dhe ndërtimit.[5]

[5] *https://www.eea.europa.eu/en/topics/in-depth/soil*

Strategjia e BE-së për tokën për vitin 2030 përcakton një kornizë dhe masa konkrete për të mbrojtur dhe rivendosur tokat dhe për të siguruar që ato të përdoren në mënyrë të qëndrueshme. Ajo përcakton një vizion dhe objektiva për të arritur toka të shëndetshme deri në vitin 2050, me veprime konkrete deri në vitin 2030.[6]

Zbatimi i politikave për mbrojtjen e tokave dhe që ato të përdoren në mënyrë të qëndrueshëm duhet të zbatohen edhe nga Qeveria e Republikës se Kosovës, meqë jemi pjesë e Marrëveshjes se Stabilizim Asocimit me BE dhe që pretendojmë te jemi pjesë e integruar e këtij unioni.

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028 e hartuar nga MBPZHR, është e orientuar në zhvillimin e bujqësisë dhe zonat rurale të Kosovës, në transformimin e ekonominës agro-rurale, e me pak në zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës në përgjithësi.

3.3.1. Përdorimi i tokës në bujqësi

Përdorimi i tokës bujqësore për qëllime ekonomike dhe infrastrukturore në Kosovë nuk është në përputhje me konceptet e zhvillimit të qëndrueshme. Zënia e tokave bujqësore me infrastrukturë te fortë të betonimit qoftë për vendbanime apo afariste, hapja e rrugëve të reja, veçanërisht zgjerimi apo hapje e vijave të reja të autostradave, po ndikon në vazhdimësi në zvogëlimin e tokave bujqësore. Procesi i ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore po i paraprinë në mënyrë të lirshëm shfrytëzimi i këtyre tokave për ndërtim. Në anën tjetër fragmentimi i shumëfishtë i tokave bujqësore në parcela të vogla është një formë tjetër e zvogëlimit të shfrytëzimit të tokave bujqësore për kultivimin e bimëve agro-ekonomike.

Në përgjithësi shfrytëzimi i tokave bujqësore, si dhe kullotat kanë ndryshuar gradualisht, me faktin se migrimi nga viset rurale në drejtim të zonave urbane dhe migrimi i përhershëm në vendet perëndimore, ka qenë i vazhdueshëm.

Sipas Raportit të Gjelbër të publikuar nga MBPZHR sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 420,326,60 ha. Sipërfaqe më të madhe të tokës zënë livadhet dhe kullosat (që përbën 51% të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore). Kategoria e tokës së punueshme–ara, ka pjesëmarrje prej 44%, në totalin e tokave bujqësore. Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve përbën 2% të totalit, ajo e vreshtave 1%, kurse e kopshteve 1.8 % (tabela 9).

[6] *https://environment.ec.europa.eu/topics/soil-and-land/soil-strategy_en*

Tabela 8. Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive[7]

Shfrytëzimi i tokës bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja (%)
Tokë e punueshme – ara	188.375	44%
Kopsht	8.491	1.8%
Plantacione të pemëve	10.144	2.4%
Plantacione të vreshtave	3.471	0.8%
Fidanishte	140	0.2%
Livadhe dhe kullosa	217.107	51%
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	**427.728**	**100%**

Privatizimi i tokave bujqësore nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka vazhduar edhe në vitet e fundit. Shitja e tokave bujqësore dhe privatizimi i tyre në vitin 2021 ka patur një rritje prej 0.4% në krahasim me vitin paraprak. Gjithsejtë sipërfaqja e shitur e tokave bujqësore deri në vitin 2021 ishte 30,823 ha. Sipërfaqja me e madhe e tokave të shitura ishte ne regjionet; Peja-11,687 ha, Prizreni me 667,159 ha, Mitrovica me 634,911 ha, Gjilani me 326,317 ha dhe Regjioni i Prishtinës me 285,159 ha.[8]

3.3.2. Monitorimi i tokave

Monitorimi i tokës duhet të jetë pjesë e programit të monitorimit të mjedisit. Monitorimi i tokës aktualisht nuk është futur në sistemin e integruar të monitorimit të përgjithshëm të mjedisit.

Dy institucione kryesorë përgjegjëse për monitorimin e tokës siç janë: MBPZHR përmes Institutit Bujqësore dhe MMPHI përmes Institutit Hidrometeorologjik. Instituti Bujqësorë i Kosovës (IBK), është përgjegjës për monitorimin e tokave bujqësore, ndërsa Instituti Hidrometeorologjik (IHMK) është përgjegjës për monitorimin e tokavë të ndotura industriale dhe faktor të tjerë ndotës në zonat publike. Aktualisht, IHMK ka mungesë të stafit për monitorim të tokave dhe mungesën e mjeteve laboratorikë për këtë qëllim edhe pse janë disa pajisje teknike për analizim te tipit XRF (me rreze radioaktive) për metale te renda, mullirin për bluarjen e dheut, mjete këto nga donacioni i Projektit te BE.

Me rëndësi specifike është monitorimi i ndotjes së tokave në zonat industriale, minerare, dhe zonave tjera me potencil ndotës, me qëllim të evdientimit dhe përcaktimit të nivelit të ndotjes. Ky monitorim do të ndihmonte në identifikimin e indikatorëve ndotës të tokës, sigurimin e informacionit për zonat me tokat e ndotura, informacionit për ndryshueshmërinë në ekosistemin e tokës, mundësin e rrezikut nga ndotja e tokave, dhe sigurimin e informacionit relavtne për të përgatitur

[7] *Raporti i Gjelbër 2022, MBPZHR*
[8] *Raporti i Gjelbër 2022, MBPZHR*

politika rreth rehabilitimit të tokave, shfrytëzimit të tokave dhe zgjidhjen e problemeve me menaxhimin e tokës.

3.3.3. Ndotja e tokave

Në mungesë të monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së tokave (dheut), është e vështirë të mblidhen të dhëna dhe bëhet vlerësimi i gjendjes së tokave. Megjithëkëtë, duke u bazuar në të dhënat nga projektet e ndryshme, raporteve dhe vlerësimeve për ndikimet sektoriale në gjendjen e tokave, mundë të konstatohet se janë disa burime të ndryshme të ndotjes së tokave (tabela 10).

Ndotja e tokave shkaktohet kryesisht nga operatoret ndotës ekonomik dhe industria minerare, preparatet kimike që shfrytëzohen në bujqësi, transporti, mbeturinat, ujërat e ndotura urbane dhe industriale të pa trajtuara etj.

Ndotja industriale e ne veçanti nga gjenerimi i substancave te rrezikshme është një nga format me të shpeshta që haset gjithandej vendit. Aktualisht, si burime te ndotjes së tokës vlerësohen 17 lokacione me mbeturina dhe kemikate të rrezikshme e që gjinden në zonat e ndryshme industriale.[9] Në këndin tjetër, format e degradimit fizikë të tokës e sidomos tokat përreth lumenjve janë nën presionin e vazhdueshëm të degradimit dhe ndotjes nga shfrytëzimi i inerteve. Në tërë territorin e Kosovës sipërfaqja e degraduar e tokës përreth lumenjve vlerësohet të jetë mbi 1762 ha.[10] Se në çfarë shkalle të ndotjes janë tokat përreth këtyre lokacioneve industriale me mbeturina të rrezikshme dhe kemikate akoma nuk është e ditur. Po ashtu, nuk kemi një informacion për shkallën e ndotjes për zona të caktuara bujqësore si pasoj e përdorimit të preparateve kimike për mbrojtën e bimëve nga dëmtuesit. Sipas MBPZHR gjatë viteve 2019- 2022 janë importuar preparate kimike dhe plehra rreth 220,785,538.02 kg. Se sa është shfrytëzuar kjo sasi e preparateve kimike apo plehrave kimike nuk kemi një informat të sakt nga MBPZHR.

Tabela 9. Burimet e ndotjes së tokave në Kosovë

Bujqësia	**Mbeturinat komunale**	**Deponitë sanitare**	**Kimikatet dhe mbeturinat e rrezikshme**	**Industria**	**Minierat**	**Burimet tjera**
Praktikat e këqija bujqësore. Përdorimi pa kriter i pesticideve dhe plehrave	Menaxhimi jo efikas i mbeturinave të ngurta. Hedhja e tyre në tokë pa kritere dhe standarde	Rrjedhjet e ujërave të ndotura dhe shpërndarja e mbeturinave nga deponitë e menaxhuara	Ruajtja e pasigurt e kemikateve dhe mbeturinave të rrezikshme	Menaxhimi i keq i mbetjeve industriale dhe hedhja e tyre në sipërfaqet tokësore pa kritere dhe	Rrjedhjet e materieve të dëmshme nga minierat dhe nga deponite e mbetjeve	Deponite e makinave te vjetra dhe auto serviset

[9] *Raporti për mbeturinat e rrezikshme industrial në Kosovë 2019, MMPH/AMMK*

[10] *Raportit për gjendjen mjedisore të lumenjeve e shkaktuar nga shfrytwzimi i rërës dhe zhavorrit, 2022, AMMK*

		keq		standarde	minerare	
Janë përdorur 78.976.185 kg fertilizues të llojeve të ndryshme, ndërsa me pesticide janë trajtuar 122.138 ha tokë	Janë evidentuar 763 deponi ilegale që nuk menaxhohen	Janë 8 deponi sanitare të cilat nuk menaxhohen sipas standardeve dhe kritereve	Janë evidentuar rreth 17 lokacione të kemikateve dhe mbeturinave të rrezikshme	Operojnë disa operatorë të mëdhenj industrial, që gjenerojnë mbetje industriale	Janë dhjetëra miniera dhe deponi te mbetjeve minerare, që nuk janë rehabilituar	Vajrat e përdorura dhe mbetjet tjera te makinave

Sipas vlerësimeve të gjendjes mjedisore, faktorët të cilët kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së tokave janë;

- Zbatimi jo efikas i infrastrukturës ligjore për tokat dhe mungesa e një strategjie për mbrojtjen e tokave nga ndotja;
- Ndërrimi i destinimit të tokave dhe shfrytëzimi për infrastrukturë të ndërtimit, transporti, aktivitete ekonomike, fragmentimi i tokave dhe mungesa e komasacionit të tokave;
- Shkarkimet e emisioneve ndotëse nga industritë e renda dhe minierat, operatoret ekonomik, ujërat urbane dhe industriale të pa trajtuara, mbetjet bujqësore dhe urbane etj.
- Mungesa e sistemit të monitorimit të tokave dhe përcaktimi i shkallës së ndotjes,
- Mungesa e një program për rehabilitimin dhe trajtimin e tokave të kontaminuara industriale dhe minerare.

3.4. Menaxhimi i Mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave komunale vazhdon të mbetet një rrugë me shumë sfida, si për nivelin lokal ashtu edhe për nivelin qendror. Ekziston një bazë solide e legjislacionit që e rregullon menaxhimin e mbeturinave, e gjithashtu dokumente si "Strategjia dhe Plani i Veprimit" për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë, ndërkaq në nivelin lokal, të gjitha komunat i kanë draftuar planet komunale 5 vjeqare të menaxhimit të mbeturinave, dhe poashtu rregulloret për menaxhimin e mbeturinave. Në këto dokumente planifikuese janë paraparë një mori objektivash dhe aktivitete. Mirëpo, edhe përkundër faktit se në rrugën e angazhimeve për përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të mbeturinave, megjithatë janë duke u hasur vështirësi të natyrave të ndryshme.

AMMK, vazhdimisht bënë monitorimin e gjendjes në këtë sektorë, dhe mbi bazën e të gjeturave vlerëson se ka një përmirësim të gjendjes së menaxhimit të mbeturinave pothuajse në të gjitha komunat. Kështu, bazuar në të në të dhënat raportimeve nga komunat, monitorimeve në teren kemi vlerësuar se ka ngritje të nivelit të mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, rritje të arkëtimit, largimin dhen pastrimin e deponive ilegale, dhe po ashtu përmirësim në fushën e plotësimit të obligimeve ligjore nga niveli lokal.

Nga niveli qendrorë ka iniciativa për zbatim të projekteve të parapara me strategji dhe plan të veprimit, siç janë studimet e fizibilitetit për deponitë sanitare, mospërdorimi ose aplikimi i një takse për qeset e plastikes, hulumtimi i gjendjes sa i përket fillimit të zbatimit të sistemit të rikthimit të depozitave për shishet dhe kanaqet dhe fillimi i zbatimit të këtij objektivi, ekonomia qarkore, etj. Gjithashtu bashkëpunimi me donatorë të jashtëm që janë duke na mbështetur në ngritjen e kapaciteteve, investimeve direkte në pajisje teknike dhe softuerike për implementimin e projekteve dhe aktiviteteve tjera në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

AMMK, vlerëson se është koha që akterët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave komunale të nisin iniciativa që qojnë drejtë menaxhimit të integruar të mbeturinave, në radhë të parë aplikimin e modelit **3R** (reduktimit të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimit të tyre, si dhe riciklimit), pasi vetëm kjo formë e menaxhimit të mbeturinave konsiston në qëndrueshmëri dhe në përfitime tjera qofshin ato mjedisore, por edhe ekonomike dhe sociale.

Nje spektër tjetër i mbeturinave që për të cilat ende nuk ka menaxhim të mirëfilltë janë mbeturinat e rreikshme, një pjesë e mbeturinave spitalore, mbeturinat shtazore, mbeturinat e ndërtim - demolimit, gomat mbeturinë, vajrat mbeturinë, etj., gjendja e të cilave vazhdon të paraqet një sfidë të madhe për mirëqenien e mjedisit.

Natyrisht se për këto lloje mbeturinash kërkohen analiza dhe hulumtime konkrete në radhë të parë për të pasur një pasqyrë më të qartë të gjendjes së tyre, dhe po ashtu investime specifike në mënyrë që që të futet nën kontrollë të plotë menaxhimi i tyre, ashtu që të përmirësohet gjendja e tyre dhe rrjedhimisht të eliminohet edhe ndikimi negativ në shëndet dhe në mjedis.

Gjendja e deponive sanitare për deponimin e mbeturinave komunale nga viti në vit, vazhdon duke u rënduar si pasojë e shumë faktorëve, me theks të veçantë nga menaxhimi joadekuat i tyre, mungesa e investimeve, tejkalimi i kapaciteteve planifikuese për deponimin e mbeturinave, etj.

Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe i deponive industriale aktive, por edhe atyre të trashëguara nga aktivitetet minerare dhe industriale, paraqesin një

problematikë specifike për mjedisin. Gjendja e tyre nuk është plotësisht e njohur, andaj është e domosdoshme që në të ardhmen të bëhet një vlerësim dhe të hartohen plane dhe projekte për menaxhimin dhe rehabilitimin e tyre.

Duhet theksuar se sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave, dhe kjo paraqet një sfidë edhe për vlerësimin e gjendjes në këtë sektor. Andaj, kërkohet që akterët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, të ndërtojnë sisteme të mbajtjes së të dhënave, dhe të raportojnë mbi gjendjen e menahimit të mbeturinave.

Raportimi i rregullt dhe i verifikuar mbi menaxhimin e mbeturinave, është rruga më e sigurtë për ta njohur dhe vlerësuar drejtë gjendjen në këtë sektorë, dhe mbi bazën e gjetjeve të mundohemi të ndërmarrim masa dhe veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale

Të dhënat për sasinë e mbeturinave të gjeneruara në nivel të komunave janë marrë nga raportimi i komunave në AMMK. Me qëllim të lehtësimit të raportimit, AMMK me mbështetjen e GIZ-së e ka zhvilluar sistemin elektronik të raportimit. Për vitin 2022 raportimi është bërë për herë të parë përmes uebaplikacionit, ku kanë raportuar 33 komuna. Meqenëse ky format i raportimit është bërë për herë të parë, natyrisht ka pasur edhe sfida në të kuptuarit e funksionimit të ëebaplikacionit, dhe rrjedhimisht edhe të dhënat e raportuara janë ende nëproces të verifikimit, kurse të dhënat e prezantuara në këtë raport janë të dhëna preliminare.

Në tabelën 11 janë paraqitur të dhënat e gjenerimit të mbeturinave komunale për komunat për vitin 2021 dhe 2022.

Duhet cekur se ky rezultat për gjenerimin e mbeturinave bazohet vetëm në sasinë e mbeturinave të grumbulluara nga operatorët për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave, pra nuk përfshihet e tërë sasia e mbeturinave që realisht gjenerohen në komuna.

Tabela 10. Gjenerimi i mbeturinave komunale kg \banor\vitë (2021 & 2022)

Komuna	Grumbullimi i mbeturinave ton/vit	Gjenerimi kg/banorë/vit	Grumbullim i mbeturinave ton/vit	Gjenerimi kg/banorë/vit[11]
	2021	2021	2022	2022
Prishtine	76,339.00	212.13	71,515.00	197.06
Drenas	7,458.10	150.33	7,209.77	143.61

[11] *Te dhënat për vitin 2022, janë të dhëna preliminare, pasi ende jemi në roces të vlerësimit të raporteve të pranuara.*

Fushe-Kosove	17,626.83	253.81	17,972.20	241.75
Graçanicë	4,503.26	252.80	5,453.49	0.00
Lipjan	13,053.12	243.47	13,279.00	239.47
Obiliq	7,152.62	390.52	7,138.20	381.58
Podujeve	18,139.50	300.22	17,090.00	284.15
Mitrovice	21,967.00	306.06	25,995.00	364.82
Skenderaj	7,464.06	208.55	7,098.00	179.50
Vushtri	19,596.85	209.53	19,456.00	278.46
Mitrovica V.	0.00	0.00	0.00	0.00
Zveçan	2,430.00	363.15	0.00	0.00
Zubin-Potok	0.00	0.00	0.00	0.00
Leposaviq	0.00	0.00	0.00	0.00
Peje	36,063.00	391.97	36,164.00	376.12
Istog	16,256.30	459.88	11,892.00	374.20
Kline	9,758.70	258.90	9,173.00	242.81
Prizren	49,839.86	235.31	49,409.00	259.41
Suhareke	15,181.54	265.98	13,776.00	230.67
Malisheve	10,596.00	180.38	10,243.70	169.15
Rahovec	14,426.90	200.35	14,611.00	199.78
Dragash	7,952.00	313.77	7,490.00	246.00
Mamushe	1,080.00	243.96	1,080.00	229.81
Ferizaj	23,476.48	283.74	27,995.50	281.13
Kaçanik	3,942.74	170.70	5,859.00	181.39
Shtime	4,486.51	224.51	4,621.00	225.31
Hani i Elezit	2,313.31	257.36	2,300.00	241.77
Shterpca	1,827.34	289.26	0.00	0.00
Gjilan	25,124.14	298.79	25,398.00	328.11
Kamenice	5,493.55	225.01	5,297.50	205.75
Viti	6,351.20	209.63	6,366.00	192.31
Novoberde	2,181.15	444.77	2,149.00	406.64
Partesh	563.36	138.42	0.00	0.00
Kllokot	925.48	232.28	0.00	0.00
Ranillug	1,118.33	301.58	0.00	0.00
Gjakove	25,585.22	322.61	24,801.00	305.02
Deçan	8,298.40	176.69	8,316.00	160.88
Junik	818.09	107.41	920.00	126.84
Nivel vendi	**469,389.94**	**240.10**	**460,068.36**	**248.72**

3.4.2. Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale

Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale eshtë e një rëndësie të veçantë, kjo pasi për nivelin qendrorë e po ashtu edh epër nivelin lokal, kjo analizë ofron një njohje më të mirë të gjendjes së mbeturinave dhe lehtëson hartimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare, hartimin e planeve afatgjatë për menaxhimin e

mbeturinave, si dhe ofron qasje me të lehtë në implementimin e programeve si të riciklimit, kompostimit, duke synuar në minimizimin e gjenerimit të mbeturinave.

Kjo analizë është mjaft e rëndësishme, sepse paqyron një bazë të të dhënave së çfarë lloje të mbeturinave gjenerohen gjatë një viti në aspektin sasior dhe cilësor, duke u bazuar në sasinë e përgjithshme të mbeturinave që gjenerohen brenda vitit.

Anliza e përbërjes së mbeturinave komunale është realizuar përgjatë 1 viti, Tetor 2021 deri në Nëntor 2022 është realizuar në 7 regjionet e Kosovës, në komunat: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovica e Jugut, Gjilan dhe Pejë. Mostrat janë marrë në 4 zona të qyteteve, duke përfshirë banimet kolektive, individuale, kategoritë biznesore dhe ato të përziera (me banim kolektiv, individual e biznesor).

Operatorët e grumbullimit të mbeturinave në këto 7 regjione janë: KRM "Pastrimi", KRM "Çabrati", KRM "Uniteti", KRM "Ambienti", KRM "Ecohigjiena", KRM "Pastertia", KRM "EkoRegjioni". Aktualisht, pothuajse të gjitha mbeturinat që gjenerohen në këto regjione-komuna deponohen në deponitë e kontrolluara regjionale dhe komunale.

Hulumtimi dhe analiza e përbërjes së mbeturinave komunale, është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në kuadër të projektit "Shërbime të Qëndrueshme Komunale-SMS" përmes Environmental Sustainable Solution "ESS L.L.C", drejtorive të Shërbimeve Publike të Komunave përkatëse dhe 6 kompanive regjionale që bëjnë mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale.

Tabela 11. Përbërja e mbeturinave[12]

Përbërja e mbeturinave	Faza I	Faza II	Faza III	Totali
Mbeturina organike	29.2%	32.9%	29.3%	30.4%
Mbeturina të gjelbëra	5.0%	4.4%	4.2%	4.5%
Tetrapak	2.1%	2.5%	3.2%	2.6%
Plastikë	18.7%	19.7%	20.3%	19.6%
Letër / karton	16.3%	15.4%	13.6%	15.1%
Tekstil	4.9%	4.4%	5.0%	4.8%
Metale	1.3%	1.5%	2.7%	1.8%
Qelq	4.5%	5.8%	6.2%	5.5%
Dru	0.9%	1.0%	2.5%	1.5%
MKD	2.0%	2.9%	4.3%	3.1%
Mbeturina të rrezikshme	0.2%	0.2%	0.3%	0.2%
Pampersa	4.6%	3.5%	3.7%	4.0%
Mbeturina të imëta	10.3%	5.7%	4.7%	6.9%

[12] *Raporti i analizës së përbërjes së mbeturinave në 7 regjionet e Kosovës, ESS L.L.C, 2022*




Figura 17. *Përbërja e mbeturinave në Kosovë*

3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare

Sasia e mbeturinave komunale që gjenerohen në nivel vendi, siq shihet në grafikonet në vijim ka një trend të rritjes së vazhdueshme. Mbi 90% e sasisë së mbeturinave të gjeneruara përfundojnë në deponitë e kontrolluara, kurse pjesa tjetër përfundon në vendhudhje ilegale si dhe një pjesë mblidhet nga sektori informal për qëllime të tregtimit. Në vitin 2022 shënohet një rritje e deponimit të mbeturinave në sasi prej 43,623 ton, apo 9.77% më shumë krahasuar me vitin paraprak 2021 (figurat 18 dhe 19).




Figura 18. *Deponimi i mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë, 2017-2021*




Figura 19. *Trendi i deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë, 2017-2021*

Sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2022 është deponuar në deponinë sanitare në Mirash (Prishtinë) 182,701.42 ton, kurse sasia më e vogël në deponinë sanitare në Dragash 7,490.00 ton.

Në deponit sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Mirashi (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), deponimi i mbeturinave në vitin 2022 ka shënuar një rritje prej 10,550.3 ton, apo 2.8% më shumë krahasuar me vitin 2021.

Ndërkaq në deponin sanitare rajonale në Mitrovicë (Gërmovë) në vitin 2022 janë deponuar 52,857.9 tonë apo 7.8% më shumë mbeturina se në vitin 2021, kurse në deponin sanitare në Pejë në vitin 2022 janë deponuar 5,6007.4 ton, apo 3.02% më pak mbeturina të deponuara krahasuar me vitin 2021.

Në deponitë sanitare të Dragashit dhe të Podujevës, deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në komunat gjegjëse.
Kështu, në deponinë e Podujevës, në vitin 2022 kemi një renie të sasisë mbeturinave të deponuara prej 341 ton krahasuar me vitin 2021, pra janë deponuar gjithsej 17,451 ton, kurse në deponinë sanitare të Dragashit kemi një rritje të deponimit prej 297 ton më shum mbeturina të deponuara krahasuar me vitin 2021, pra janë deponuar gjithsej 7,490 ton mbeturina.

3.4.4. Mbeturinat spitalore

Një spektër i mbeturinave spitalore që gjenerohen nëpër qendrat spitalore dhe në institucionet tjera të kujdesit shëndetësorë në Kosovë, i nënshtrohet trajtimit përmes procesit të sterilizimit nëpër sterilizator, të cilët janë të vendosur në kuadër të 8 qendrave spitalore.

Prej të dhënave të raportuara dhe të vlerësuara nga këto qendra të trajtimit të mbeturinave spitalore, në vitin 2022 shohim një rritje prej 157, 970 kg më shumë mbeturina që janë trajtuar-sterilizuar, respektivisht 920,780.25 kg mbeturina, apo 20% më shumë krahasuar me vitin 2021.

Sasia më e madhe e këtyre mbeturinave edhe gjatë vitit 2022 sikurse edhe në vitet paraprake është trajtuar në impiantin i cili operon në QKUK në sasi prej 610,564.2 kg, pasuar nga impianti në Prizren me një sasi prej 106,782.7 kg, kurse sasia më e vogël është trajtuar në impiantin e vendosur në Qendrën Spitalore në Gjakovë me vetëm 1,288.0 kg mbeturina të trajtuara (tabela 13).

Një spektër tjetër i mbeturinave spitalore siç janë mbeturinat patologjike dhe barnat me afat të skaduar, i nënshtrohen procesit të asgjësimit të tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Tabela 12. Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

Impianti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Njësia	kg	kg	kg	Kg	kg	kg
Prishtinë	246,587	360,819	487,169	766,34740	465,335	610,564
Prizren	110,541	100,175	97,195	96,227	96,290	106,782
Pejë	49,351	49,215	45,720	50,4800	47,560	44,678
Ferizaj	8,901	35,465	39,215	37,664	39,934	38,914
Gjilan	36,791	26,460	29,859	40,748	42,046	39,689
Gjakovë	2,171	2,951	3,357	3,159	3,284	1,288
Mitrovicë	79,359	72,323	85,149	68,214	67,174	76,250
Vushtrri	1,6475	2,504	2,580	632.61	1,185	2,613
Gjithsej	**535,349**	**649,914**	**790,245**	**1,063,472**	**762,809**	**920,780**

3.4.5. Trajtimi i mbeturinave

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në anketimet e rregullta që kryen lidhur me trajtimin e mbeturinave komunale[13], ku janë përfshirë akterët të cilët merren me trajtim të mbeturinave, për vitin 2021, në grafikonin në vijim është pasqyruar në përqindje sasia e secilës kategori të mbeturinave që është trajtuar.

Siç shihet pra në grafikon, sasia më e madhe e mbeturinave të trajtuara i takon mbeturinave të gjeneruara nga ekonomitë familjare, e të cilat janë trajtuar përmes deponimit klasik, të pasuar nga mbeturinat e letrës dhe kartoni, plastikës etj. Format e trajtimit kanë qenë deponimi, sterilizimi, riciklimi, respektivisht ndarja dhe klasifikimi i tyre.




Figura 20.*Trajtimi i mbeturinave në Kosovë, 2021*

3.4.6. Mbeturinat industriale

Rezultatet nga anketa e mbeturinave industriale[14], tregojnë për trendin e rritjes progresive të gjenerimit të mbeturinave industriale që nga viti 2019 (shif grafikonin në vijim). Kështu në vitin 2021 është shënuar një rritje prej 3.6 % krahasuar me vitin 2020 kur janë gjeneruar 2,137,928.00 ton mbeturina industriale, respektivisht 5.6% më shumë krahasuar me vitin 2019.

Gjatë vitit 2021 janë përpunuara gjithsej 2,212,927.00 ton mbeturina industriale. Format e përpunimit kanë qenë: deponimi, djegia dhe riciklimi.

[13]*ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2021*
[14]*ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, për vitin 2021*

Konkretisht 1,220,962.00 ton mbeturina industriale janë deponuar, janë djegur 1,446.00 ton, si dhe janë ricikluar 159,602.00 ton, kurse 830,917.00 ton janë dërguar diku tjetër (figura 21).

Të dhënat e vitit 2021 tregojnë se sasia më madhe e mbeturinave të gjeneruara, sipas sektorëve të industrisë, ishte te: Sektori D (Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar) me 1 267 879 ton dhe Sektori B (Xehetari dhe Guroret) me 562 343 ton (figura 22).




***Figura 21**. Gjenerimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë, 2021*




***Figura 22.** Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2017-2021*

3.4.7. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës

Ndotja e mjedisit me mbetje të plastikës është një dukuri mjaftë shqetësuese me të cilën po ballafaqohet vazhdimisht vendi. Ndotjes së mjedisit me mbetje të plastikës i kontribuon shumë edhe përdorimi i madhë sidomos i qeseve njëpërdorimëshe të qeseve të plastikës.

Prania e qeseve gjithandej në mjedisin tonë rrethues është një fenomen shumë shqetësues dhe padyshim se në këtë dukuri negative kontribuon edhe importi dhe përdorimi i madh i qeseve dhe thasëve të plastikës.

Prej sasisë së përgjithshme të mbeturinave komunale të gjeneruara nga amvisëritë, dhe po ashtu nga aktivitetet ekonomike dhe industriale, një sasi të madhe e përbejnë edhe thasët dhe qeset e plastikës.

Prej të dhënave të marra nga Doganat e Kosovës, sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të importuara në vitin 2022 është 959,254 kg, duke shënuar një rënie prej 5% krahasuar me vitin 2021. Në anën tjetër, në vitin 2022 janë eksportuar 140,736 kg të ëthasëve dhe qeseve të plastikës, duke shënuar kështu një rënië të madhe në eksport prej 95% krahasuar me vitin 2021 kur eksporti ishte në 2,724,243 kg (figura 23 dhe figura 24).

Vlenë të theksohet se MMPHI, është në draftim e sipër të Udhëzimit Administrativ për ambalazhet, dhe paketimet nga ambalazhi, përmes së cilit është duke u rregulluar edhe qështja e përdorimit të qeseve të plastikës, duke i vendosur një taksë për përdorimin e tyre.




Figura 23. *Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës së importuar, 2017-2022 dhe* ***Figura 24.*** *Sasia e thasëve dhe qeseve të plastikës të eksportuara, 2017-2022*

3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

3.5.1. Zonat e mbrojtura

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës mund të veçohen katër periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë. Pas luftës së vitit 1999 janë shënuar rezultate të konsiderueshme në rritjen e numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura si dhe në zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura të natyrës të të gjitha kategorive (figura 25).




Figura 25. *Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950-2022*

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën fillestare të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë, e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950. Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura kishte arritur në 19 (nëntëmbdhjetë).

Periudha në mes viteve 1970-1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të mbrojtura, që ndërlidhet me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974. Në këtë periudhë, janë vënë nën mbrojtje gjithsej 32 zona.

Periudha 1989-1999, kishte stagnim të plotë edhe sa i përket shpalljës së zonave të mbrojtura.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutit të

Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe janë marrë nën mbrojtje ligjore rreth 200 zona të ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 30 zona tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"(2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës, Ligatina e Hencit - Radevës etj. Shumicën zonave e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik etj.

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2022) është 260, të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126,115.8 ha, ose 11.6% e sipërfaqes së Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj), 2 Parqe Kombëtare (PK "Sharri", PK "Bjeshkët e Nemuna"), 230 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpella e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj), një (1) Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), shtatë (7) Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza" dhe "Pishat e Deçanit", etj) dhe një (1) Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radeves").

Tabela 13. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2022)

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ha	Pjesë. ne siper. e pergjith. te ZM	Pjesë. e ZM në sip. e Kosovës
I	Rezervatet Strikte të	19	10,882.96	7.7	0.99
II	Parqet Kombëtar	2	115,957	82.1	10.6
III	Monumentet Natyror	230	6,173.90	4.4	0.5
V	Park Natyre	1	5,934	4.2	0.5
V	Peizazh i Mbrojtur	7	2,319.85	1.6	0.3
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.5	0.08	0.01
	Totali	**260**	**126115.75**[15]	**100**[16]	**11.56 %**

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia" dhe "Ushton lumi" etj, MNRV "Ujëvarat e Mirushës" dhe MN "Lokaliteti i Boshtres në zonën e Goleshit", etj.

[15] *Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave te mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"*

[16] *Sqarim: perqindja është nxjerr nga siperfaqja e pergjithshme duke perfshir edhe siperfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.*

Gjat vitit 2022 nën mbrojtje ligjore janë marrë 12 vlera të reja natyrore prej te cilave 11 monumente të natyrës dhe 1 peizazh i mbrojtur (në territorin e komunave: Lipjanit 9 monumente të natyrës, Podujevës 1 monument natyre dhe një peizazh I mbrojtur dhe Ferizaj 1 monument natyre).

3.5.2. Flora dhe vegjetacioni

Pozita gjeografike, klima dhe kushtet ekologjike kanë mundësuar që vendi ynë të jetë një regjion shumë i pasur në aspektin e biodiversitetit. Kjo bazohet në faktin e prezencës së llojeve të ndryshme të vegjetacionit, florës dhe faunës në mesin e tyre edhe lloje endemike lokale. Gjithashtu shquhet për një diversitet të lartë të burimeve gjenetike, llojeve dhe ekosistemeve. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet së në Kosovë janë prezent afro 2800 - 3000 lloje të florës vaskulare[17].

Në numrin e taksoneve të përfshira në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës sipas Raunkierit dominojnë Hemikriptofitet me 155 taksone, pastaj Gjeofitet me 32 dhe Kamefitet me 27. Në numër më të vogël janë Fanerofitet me 19 taksone dhe më së paku Terofitet me vetëm 4 taksone. Ndërsa numri i llojeve sipas rrezikushmërisë së tyre bazuar në katëgoritë e IUCN-së është: 1 lloj i zhdukur në gjendje të egër, 62 lloje të rreikuara në mënyrë kritike, 86 llojë të rrezikuara, 19 lloje të përkeqësuara, 34 lloje gati të rrezikuara dhe 35 lloje më pak të rrezikuara



Figura 26. *Tulipani shqiptar (Tulipa albanica) (Foto:Xh.Mala)*

[17] *Libri i kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës*

Myshqet- Sipas hulumtimeve në tërritorin e Kosovës janë evidentuar 359 lloje të myshqeve, kryesisht në Parqet Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna". Në kuadër të këtij numri 21 lloje bëjnë pjesë në listën e llojeve të kërcënuara për Evropë ndërsa 164 të kërcënuara për Evropën Juglindore (tabela 15).

Tabela 14. Numri i llojeve të myshqeve në Kosovë dhe statusi i kërcënimit[18]

	Gjithsej Kosova	PK 'Sharri'	PK 'Bjeshkët e Nemuna'	PM Gërmia	Regjioni i Mitrovicës
Numri i llojeve të identifikuara	359	255	239	76	25
Lloje ne 1000 km	33	654	379	1226	76
Të kërcënuara për Evropën	21	9	11	1	1
Të kërcënuara për Evropën JL	164	123	127	25	3

Kërpudhat- Sipas hulumtimeve në tërritorin e Kosovës janë evidentuar 223 lloje të kërpudhave, që përfaqësohen me 143 gjini dhe 43 familje (tabela 16). Sipas statusit të rrezikushmërisë 57 % e llojeve i takojnë llojeve me status të rrallë, 40 % i takojnë llojeve me status shumë të rrallë ndërsa që 3% llojeve me status ekstemisht të rrallë, Sipas të dhënave në dispozicion në Kosovë (Mali Sharr) ekziston edhe një lloj ekstrem i rrallë i kërpudhës (Zeus Olympius) që përveç Kosovës, ka përhapje edhe në Malin Olimp në Greqi dhe në Malin Pirin në Bullgari.

Tabela 15. Numri i llojeve të kërpurdhave në Kosovë[19]

Tipet e kërpudhave	Numri i familjeve	Numri i gjinive	Numri i llojeve
Ascomycota	10	13	16
Basidiomycota	46	126	202
Mixomycota	2	4	5
Gjithësejt	**43**	**143**	**223**

Vegjetacioni - Vegjetacioni i vendit tonë klasifikohet në: 139 asociacione apo firocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa, të cilat paraqesin ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në: 4 asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Ndërsa vegjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në: 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa.

Indeksi i pyjeve- Indeksi i Paprekshmërisë së Peisazhit të Pyjeve (The Forest Lanscape Integrity Index FLII), është një vlerësim vjetor global i indeksit të gjendjes së pyjeve që mat modifikimin e pyjeve si rezultat i ndikimeve antropogjene.

[18] *Studimi i myshqeve brenda territorit të Kosovës, vështrim taksonomik dhe ekologjik, Zenel Krasniqi, Punim i Doktoratës, Universiteti i Tiranës, 2021*

[19] *Fungi in Kosovo – the Preliminary Data of their Diversity and Ecology, Mitko Karadelev, Ss. Cyril and Methodius University Faculty of Natural Science and Mathematics, Skopje, Macedoni*

Në kuadër të këtij indeksi të realizuar, është përfshirë edhe Kosova. Sipas këtij vlerësimi Indeksi i pyjeve të Kosovës është 5.19, krahasuar me vlerën më të lartë të indeksit që është 10. Vetëm 1% e pyjeve të Kosovës janë kategorizuar me paprekshmëri të lartë ndërsa që 59% me paprekshmëris të ulët dhe 41% me paprekshmëri mesatare.

Tabela 16. Indeksi i paprekshmërisë së pyjeve të Kosovës[20]

Sipërfaqja me paprekshmëri të ulët (km²)	2,628	59 %
Sipërfaqja me paprekshmëria mesatare (km²)	1,775	41 %
Sipërfaqja me paprekshmëri e lartë (km²)	47	1%
Sipërfaqja totale e pyjeve (km²)	4,450	100%
Vlera e indeksit të pyjeve për Kosovë	5.19	10




Figura 27. *Harta e Indeksit të Paprekshmërisë së Pyjeve të Kosovës*

3.5.3. Fauna

Kosova hynë në radhën e vendeve me faunë më të pasur dhe me heterogjene të Gadishullit Ballkanik. Kjo pasuri faunistike është rezultat i ndikimeve të shumta të regjionit mesdhetar, euro-siberian dhe atij nordiko-alpin, si dhe i ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike nga e kaluara.

[20] *https://www.forestintegrity.com/*

Në vendin tonë gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve e që janë mjaftë të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjërë. Disa prej tyre janë relikte e të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat e konventave ndërkombëtare.

Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe shënimeve të literaturës në Kosovë jetojnë mbi 300 lloje të egra të kurrizorëve, prej të cilave mbi 30 lloje të peshqve, mbi 20 lloje ujë tokësorë, mbi 25 lloje zvarranikësh, mbi 200 lloje shpendësh dhe mbi 100 lloje gjitarësh (tabela 17).

Tabela 17. Vlerësimi i numrit të llojeve të faunës sipas grupeve në Kosovë dhe numri i tre në listën e kuqe të IUCN

Grupi	Vlerësimi i numrit të llojeve	Numri i llojeve në listën e kuqe të IUCN
Pakurrizorë	>600	65
Insekte	>130	140
Peshq	>30	15
Ujëtokësorë	>20	13
Zvarranikë	>25	20
Shpende	>200	24
Gjitarë	>100	39

Në tabelën nr. 18 janë prezantuar të dhënat për dendësinë mesatare të disa popullatave të gjitarëve të egër në Kosovë.

Tabela 18. Dendësia mesatare e popullatave për disa lloje të gjitarëve të egër[21]

Llojet	Densiteti /dendësia (individ / km)		Madhësia e popullatave pyjore	
	Mesatar	Shtrirja	Mesatar	Vargu
Dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*)	1.03	0.58-1.55	4935	2778-7433
Ujku i hirtë (*Canis lupus*)	0.08	0.04-0.12	374	202-584
Derri egër (*Sus scrofa*)	1.34	0.78-1.97	6469	3754-9460
Kaprolli (*Capreolus capreolus*)	3.19	1.90-5.00	15334	9126-24059
Vjedulla (*Meles meles*)	0.08	0.03-0.14	364	146-656
Lepuri i egër (*Lepus europeus*)	1.81	0.94-2.82	8728	4524-13572
Sqarthi (*Martes foina*)	0.36	0.16-0.59	1720	789-2831
Macja e egër (*Felis sylvestris*)	0.08	0.03-0.13	381	152-648
Ariu i murrëm (*Ursus arctos*)	0.25	0.12-0.41	1190	596-1966

[21] *Developing methods for measuring national distributions and densities of wild mammals using camera traps: A Kosovo study; Sarah E. Beatham et al,.*

4. Shfrytëzimi i resurseve natyrore

4.1. Shfrytëzimi i resurseve minerare

Formë tjetër e shpeshtë e shfrytëzimit të resurseve natyrore, është shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare që realizohet përmes gurëthyesve (seperacioneve), ku sipas të dhënave të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë janë lëshuar 232 licenca për shfrytëzim të gurit, 170 licenca për hulumtime të rezervave të gurit.

Të dhënat për sasinë e shfrytëzuar të rezervave minerare për vitin të 2022 janë prezantuar në tabelën 19.

Tabela 19. Sasia e rezervave të shfrytëzuara minerare për vitin 2022[22]

Lëndët minerale	Nr. i licencave	Rezervat e shfrytëzuara	Njësia
Linjit	2	8,535,435.00	T
Andezite	7	150,191.05	m3
Argjillë	15	495,161.20	T
Gëlqeror	190	6,730,525.97	m3
Bazalt	1	40,322.69	m3
Rërë dhe zhavorr	47	136,000.93	m3
Rërë kuarcore	5	17,594.00	m3
Mërgel	5	182,020.32	m3
Rreshpe	2	0	m3
Mermer	8	2,925.00	m3
Gabro	2	0	m3
Tuf (t)	1	351	t
Dunit	1	0	m3

Komunat në rajonet e të cilave ka pasur më së shumti kërkesa për licencim në aktivitetet për gurëthyes dhe krahas kësaj janë pajisur me këto licenca, janë: komuna e Malishevës, Klinës, Kaçanikut dhe Lipjanit. Ndërsa, ato me më së shumti kërkesa dhe licencim për rërë dhe zhavorr janë: Peja, Gjakova dhe Kamenica.

Operatorët Ekonomikë të cilët kanë licenca, nuk respektojnë kriteret mjedisore të përcaktuara në licencë, duke mos rikultivuar apo rivitalizuar zonën pas shfrytëzimit të mineraleve ndërtimore dhe industriale. Për më tepër, edhe zhvillimi i aktiviteteve ilegale nga shumë operatorë rrit ndotjen e mjedisit dhe degradimin e tij dhe njëkohësisht shton rrezikshmërinë për qytetarët dhe kafshët.

[22] *Komisioni i Pavaruar për Miniera dhe Minerale*

4.2. Shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve

Degradimin fizik të shtretërve, shkarkimit të ujërave të përdorura urbane dhe industriale, erozionit dhe shfrytëzimit të tokave pa kriter përgjatë shtretërve të tyre ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes mjedisore të tyre.

Në çdo pellg lumor të Kosovës kemi degradim të shtretërve të lumenjve, e me theks të veçantë në Pellgun e Drinit të Bardhë. Lumenjtë tanë, pa përjashtuar të kaluarën e mëparshme, i janë nënshtruar një presioni të pamëshirshëm të eksploatimit dhe shfrytëzimit nga personat fizikë dhe juridik(operatoret ekonomik). Shumë lumenjë të vendit janë shndërruar jo vetëm si kolektor të ujërave të përdorura urbane, industriale por edhe shfrytëzimit të pamëshirshëm të inerteve.
Sipërfaqet e degraduar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit deri në vitin 2018 është vlerësuar se është 1762.71 ha (tabela 21).

Që nga vitit 2009 e deri në vitin 2018, sipërfaqja degraduese e lumenjve është rritur për 757.94 ha. Mënyra dhe metoda e vlerësimit të pjesëve të degraduara është bërë mbi bazën e modeleve krahasuese të imazheve satelitore të ortofotove 2009/2012/2018, si dhe imazheve nga terreni. Pritet që gjatë fundit të vitit 2023, të bëhen ajro fotografimet, dhe pas rivlerësimit të imazheve të reja do të ketë ndryshim të sipërfaqes së degradimit të lumenjve.

Tabela 20. Sipërfaqet e degraduara të disa lumenjëve në Kosovë[23]

Lumi	2009 ha	2012 ha	2018 ha
Drini i Bardh	861.1	1011.75	1393.04
Ibri	2.64	4.5	8.48
Morava e Binqës	4.29	4.79	8.29
Lumbardhi i Pejës	93.36	136.34	257.12
Ereniku	16.28	19.48	39.78
Kremenadë (Krivareka)	19.37	25.26	25.68
Desivojcë	7.76	18.95	18.91
Shipashnica	-	-	11.41
Gjithsej	**1004.77**	**1221.07**	**1762.71**

Zgjerimi i shtretërve të lumenjve nga këto aktivitete, i ka paraprirë edhe zgjerimi i mëtutjeshëm nga procesi natyror i erozionit, si rezultat i gërryerjes dhe heqjes së bimëve drunore dhe shkurreve. Me këtë aktivitet qoftë nga njeriu, apo edhe atij natyror, është bërë rritja e gjerësisë së brigjeve dhe shtretërve në disa pjesë të lumenjve të vendit.
Erozioni shfaqet në forma të ndryshme, si gërryerje sipërfaqësore e tokës, e brigjeve të lumenjve, e përrenjve, transporti i depozitimeve të ngurta të rërës, zhavorreve, lymit, etj. Erozioni në Kosovë me fuqinë e vetë gërryese, brenda një viti krijon produkte për bartje ~12mil/m^3/vit. Nga ky material i eroduar për bartje, arrihet të bartet rreth 5 mil/m^3 në vit, ose rreth 460m^3/km^2, ose rreth 5m^3/ha.

[23] *Gjendja mjedisore e lumenjve e shkaktuar nga shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, 2022, MMPHI/AMMK*

4.3. Shfrytëzimi i resurseve ujore

Një kategori tjetër dhe njëherit më e madhja e shfrytëzimit të resurseve ujore, është përdorimi për nevoja industriale. Shpenzuesit më të mëdhenj janë ndërmarrjet e mëdha industriale si `KEK-u`, `NewCoFERRONIKEL-i`, `Sharrcem-i`, etj. Pjesa më e madhe e tyre furnizohen me ujë nga liqenet akumuluese sipërfaqësore (tabela 21).

Tabela 21. Shfrytëzimi i ujit 2021-2022 nga ndërrmarrjet e mëdha industriale[24]

Shfrytëzuesit	**Sasia e shpenzuar e ujit (m^3/vit) 2021**	**Sasia e shpenzuar e ujit (m^3/vit) 2022**
Korporata Energjetike e Kosovës – KEK	17047390	18389642
New Co FERRONIKEL	1430948	882986
SHARRCEM	70415	139061
Gjithsej	**18548753**	**19411689**

Sa i përket shfrytëzimit të ujërave për pije dhe amvisëri, operojnë shtatë kompani regjionale të ujit (KRU) të licencuara nga Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit (ARRU) që ofrojnë këto shërbime, si dhe janë 32 komuna që përfitojnë nga shërbimet e këtyre kompanive. Prodhimi total i ujit të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2022 ka qenë 156,835,378 milion m^3, që krahasuar me vitin 2021 është për 434,437 m3 më e lartë (tabela 22).

Tabela 22. Prodhimi i ujit (mil.m^3/vitë) 2019-2022[25]

Vitet	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**
Gjithsej	**155.8**	**152.3**	**156.4**	**156.8**

Sa i përket pjesëmarrjes së llojeve të burimeve të ujit në të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2022, 58% e tyre janë marrë nga liqenet akumuluese, 28% nga lumenjët, 5% nga burimet dhe 10% nga puset.

Tabela 24 prezanton të dhënat për sasinë e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi, për periudhën 2019-2022. Sasia e ujit të shfrytëzuar për ujitje në bujqësi në vitit 2022 ishte 93.34 milion m^3 ujë, që në pjesën më të madhe është ofruar përmes sistemeve të ujitjes. Krahasuar me vitin 2021, ka pasur një ritje të ujit të shfrytëzuar për ujitje.

[24] *Raportet vjetor per gjendjen e mjedisit, New Co Feronikeli*
[25] *Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar- Përputhshmëria me kushtet e licencës, ARRU 2022*

Tabela 23. Ujitjet në bujqësi 2019 -2022 mil.m/vitë[26]

Vitet	2019	2020	2021	2022
Ujitje formale – nga Ndërmarrjet Publike të Ujitjes	52.6	55	56.89	44.04
Ujitje joformale – nga lumenjt, puset, përrockat, etj..	18.44	27.5	20.8	49.31
Gjithsej	**71.04**	**82.5**	**77.69**	**93.34**

4.4. Shfrytëzimi i resurseve pyjore

Sipas vlerësimeve, raporteve dhe analizave të përgatitura nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe organet kompetente, konstatohet se gjendja në Zonat Pyjore është e qëndrueshme. Sipas të dhënave nga APK pyjet mbulojnë rreth 481.000 hektarë apo 44.7% e sipërfaqes totale të Kosovës. Nga kjo sipërfaqe e përgjithshme e pyjeve dhe tokave pyjore, 62% është në pronësi shtetërore, kurse 38% pyje në pronësi private. Pyjet e Kosovës janë burim i ofrimit të lëndës drunore që përdoret si dru zjarri, dhe produkte të ndryshme pyjore që përdoren për industri dhe veprimtari tjera.

Gjatë vitit 2022 nga zjarret pyjore janë përfshirë 1,596.98 ha pyje dhe toka pyjore, nga të cilat 976.12 ha në pyje publike dhe 620.86 ha në pyje private.

Gjatë vitit 2022 me buxhet të APK-së janë pyllëzuar 111.04 ha sipërfaqe me pyje. Rreth 145,705 m^3 dru janë shfrytëzuar nga pyjet publike dhe private gjatë vitit 2022. Regjioni i Gjilanit ka shfrytëzuar sasinë më të madhe të sasisë drunore. Prerjet ilegale mbeten një nga sfidat kryesore të sektorit të pylltarisë. Gjatë vitit 2022, nga Njësitë Komunale të Pylltarisë janë konfiskuar 1,789.86 m^3 masë drunore, nga e cila 151.92 m^3 dru teknik dhe 1,637.94 m^3 dru zjarri. Kurse nga Inspeksioni Qendror i Pylltarisë dhe Gjuetisë të APK-së janë konfiskuar gjithsejtë 225.64 m^3 masë drunore, (prej tyre 194.67 m^3 dru zjarri dhe 30.97 m^3 dru teknik).

Tabela 24. Sasia e masës drunore (m^3) e shfrytëzuar sipas regjioneve dhe sektorëve për vitin 2022[27]

Nr.	Drejtoria Koordinuese Regjionale	Pyje shtetërore (m^3)	Pyje private (m^3)
1	Prishtinë	1,329.06	20,945.40
2	Mitrovicë	63.80	31,864.51
3	Pejë	3,860.30	4,594.50
4	Prizren	3,482.63	3,990.95
5	Ferizaj	7,229.73	2,298.04
6	Gjilan	4,193.10	59,435.35
7	DMKE	2,037.02	384.26
Nën total		**22,192.64**	**123,513.01**
Gjithsej		**145,705.65**	

[26] *Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*
[27] *Agjencia e Pyjeve të Kosovës*

5. Ndikimet mjedisore në shëndetin publik

5.1. Shëndeti publik

Ajri që thithim përmban emetime nga mjetet motorike, industria, ngrohja dhe burimet komerciale, tymi i duhanit dhe djegiet nga ekonomit shtëpiake. Ndotja e ajrit dëmton shëndetin e njeriut, veçanërisht ata tashmë të cenueshëm për shkak të moshës ose edhe problemeve ekzistuese shëndetësore. Të dhënat tregojnë se ndotja e ajrit në nivelet aktuale në qytetet evropiane është përgjegjëse për një barrë të konsiderueshme të vdekjeve, shtrimeve në spital dhe përkeqësimit të simptomave, veçanërisht për sëmundjet kardio-respiratore.[28]

OBSH vlerëson se në nivelin global në vitin 2019 kanë qenë 4.2 milionë vdekje të parakohshme për shkak të ndotjes së ajrit në mjedis, dhe me vdekjet e parakohshme që i atribuohen më së shumti në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Ngarkesa e sëmundjes që i atribuohet ndotjes së ajrit të ambientit vetëm në Rajonin Evropian të OBSH-së sugjeron se qindra mijëra vite të shëndetshme jete janë humbur.[29]

Gjatë vitit 2022, Agjencia e Mjedisit të Evropës (EEA) ka publikuar raportin "Cilësia e ajrit në Evropë 2022, Ndikimi në shëndet i ndotjes së ajrit". Raporti i referohet edhe të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit nga rrjeti nacional që menaxhohet nga IHMK, dhe ka bërë po ashtu edhe një vlerësim mbi ndikimin në shëndet nga ndotja e ajrit edhe për Kosovë. Sipas raportit ekspozimi ndaj koncentrimi të PM2.5 ishte i ndërlidhur me 359 vdekje të parakohshme. Ekspozimi ndaj koncentrimi të NO2 ishte i ndërlidhur me 264 vdekje të parakohshme, ndërsa ekspozimi ndaj koncentrimi të O3 ishte i ndërlidhur me 135 vdekje të parakohshme.

Tabela 25. Ndërlidhja e vdekjeve të parakohshme me nivelin e koncentrimit të ndotjes së ajrit[30]

Treguesi	Kosova	BE 27	Evropa Gjithsejt
Popullsia (x1000)	1.782	442.650	530.892
Mesatarja vjetore µg/m3 (PM2.5)	19.40	11.20	11.40
Vdekje të parakohshme (PM2.5)	3,059	237,810	274,673
Mesatarja vjetore µg/m3 (NO2)	14.40	14.10	15.70
Vdekje të parakohshme (NO2)	264	48,555	64,312
Mesatarja vjetore µg/m3 (O3)	3,901	4,182	4,229
Vdekje të parakohshme (O3)	135	24,109	28,337

[28] *https://www.who.int/europe/health-topics/air-pollution#tab=tab_1*
[29] *https://www.who.int/europe/publications/i/item/WHO-EURO-2023-6898-46664-67857*
[30] *"Cilësia e ajrit në Evropë 2022, Ndikimi në shëndet i ndotjes së ajrit", EEA 2022 (https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2022/health-impacts-of-air-pollution*

Gjithashtu, ambientet e brendshme shpesh herë mund të jenë një faktor me ndikim në shëndetin e njerëzve. Fëmijët, te moshuarit, te sëmurit apo edhe gratë shtatzëna e kalojnë pjesën më të madhe të kohës brenda objekteve te banueshme apo rehabilituese. Kimikatet e rrezikshme në materialet e ndërtimit dhe të ndërtesave, mobiljet, pirja e duhanit, pastrimi i shtëpisë dhe produkte të tjera mund të ndotin ajrin që ata thithin dhe të jenë nën presionin e këtij ndikimi. Edhe kur përqendrimet e kimikateve të rrezikshme janë nën vlerat udhëzuese, ekspozimi i kombinuar ndaj tyre mund të jap ndikim negativ për shëndetin[31]. Këto ndikime janë më të larta për fëmijët, gratë shtatzëna dhe të sëmurit dhe duhet të adresohen si masa për kujdes.

Ndikimet në shëndet vijnë edhe nga konsumimi i ujit të ndotur, niveli i lartë i zhurmës, konsumimi i ushqimit jo të shëndetshëm, stresi, mos aktiviteti fizik, mungesa e pushimeve të nivelit të duhur, etj.

IKSHPK, çdo vit përgatitë raport nga monitorimi i pacienteve të sëmur dhe të cilët kanë origjinë nga ndikimet mjedisore. Në tabelën 27 janë prezantuar rastet e sëmundjeve për vitin 2021 dhe 2022, sëmundjet që janë të ndërlidhura me ndotjen e mjedisit, qoftë si ndikim direkt apo indirekt.

Tabela 26. Sëmundjet të ndërlidhura nga ndikimet mjedisore[32]

Sëmundjet	2021		2022	
	Raste	Mbi 100,000/b	Raste	Mbi 100,000/b
ITPR-Pneumonia/ARI	8897	499.24	16179	907.85
SARI (Formë e rënd e pneumonisë)	108	6.06	280	15.71
Semundje e ngjashme me gripin (ILI)	55720	3126.62	100478	5638.13
Influenca A	367	20.59	58	3.25
RSV	-	-	68	3.82
Diarreja akute	47621	2672.16	91247	5120.15
COVID-19	110029	6174.07	110755	6214.81
Varicela	2494	139.95	10972	615.67
Sindromi i diarresë me gjak	4	0.22	0	0
Sindroni meningjeal	61	3.42	112	6.28
Helmimet me ushqim	189	10.61	504	28.28
EHSV	2	0.11	1	0.06
Petusis	-	-	1	0.6
Sëmundja lyme	0	0	16	0.90
Leishmaniazë	0	0	1	0.06
Malaria Importuar	0	0	1	0.060
Pertussis	-	-	0	0
Parotiti epidemik	16	0.90	25	1.40
Verdhëza akute A	8	0.45	23	1.29
Verdhëza B	19	1.07	25	1.40

[31] *https://www.who.int/europe/news/item/13-06-2023-who-europe-releases-a-toolbox-to-protect-children-s-health-from-chemical-pollution-of-indoor-air-in-schools-and-day-care-centres*
[32] *Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës*

Verdhëza C	-	-	4	0.22
Campylobacter	-	-	1	0.06
Adenovirosis			32	1.80
Sallmonella eneteritidis	14	0.79	31	1.74
Shigelloza	-	-	1	0.6
Rota virus	-	-	162	9.09
Tularemia	2	0.11	2	0.11
Lymphadenitis	-	-	-	-
Leptospirosis	2	0.11	8	0.45
Morbili	-	-	1	0.6
E.coli (O 157)	-	-	1	0.6
Brucellosis	6	0.34	22	1.23
Toxoplasmosis	2	0.11	3	0.17
Gastroenterokolitet	22	1.23	253	14.20
Lymphadenitis ac coli	2	0.11	-	-
IST	419	23.51	178	9.99
Parazitozat	6	0.34	16	0.90
HIV	-	-	21	1.18
Status post ictus ixodes	3	0.17	0	0
Status post morsum viperi	1	0.06	0	0
Sëmundjet tjera ngjitëse	42	2.36	63	3.54
Total	226054	12684.71	331545	18604.02

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, në Kosovë numër i konsiderueshëm i sëmundjeve ngjitëse pra përfshirë edhe COVID-19 janë raportuar në numër më të lartë krahasuar me periudhën e njejtë të vitit 2021. Numër më i lartë i rasteve të raportuara shihet te sëmundjet e formës së agreguar si: *Pneumonitë, Influenca sezonale, diaretë akute dhe Variçella*. *Zoonozat* (brucelloza humane, tularemia, leptospiroza, toxoplazmoza): përveç *Tularemisë* e cila raportohet në numër të njejtë për periudhën 2021, zoonozat tjera në vitin 2022 raportohen me numër më të lartë krahasuar me vitin paraprak. Nga grupi i sëmundjeve transmisive, përveç *ËNV (Virusi i Nilit),* i cili nuk raportohet në asnjë rast, sëmundjet tjera si *Lyme, Leishmania, Malaria*, gjatë viti 2022 raportohen me numër më të lartë krahasuar me periudhën e njejtë të vitit 2021. Gjithashtu, sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim: *helmimet me ushqim, Hepatiti A, Rota* dhe *adenovirozat*, gjatë viti 2022 raportohen në numër më të lartë krahasuar me periudhën e njejtë të vitit paraprak. Sëmundjet vaksinë preventabile (*Parotiti epidemik, Pertusisi, Fruthi*), përveç *Parotitit* i cili raportohet në numër më të ulët këtë vit, është raportuar nga një rast me *Fruth (Morbili)* dhe *Petusis*. Rastet me *IST* këtë vit tregojnë rënie të numrit të rasteve të raportuara, përderisa *HIV* infeksioni tregon rritje eksponenciale gjatë vitit 2022. Sipas vlerësimeve të bërë nga të dhënat e analizuara, është konstatuar se ka pasur 105491 raste me shumë të sëmundjeve ambientale për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ose rreth 46.5% me shumë.

5.2. Cilësia e ujit të pijes

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Kosova ka një legjislacion të mirë për mbrojtjen e ujërave për pije. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, të cilat janë ndër udhëzimet me rëndësi për mbrojtën e ujërave të pijshëm dhe të cilat janë në përputhje me standardet e BE- së për ujin e pijshëm.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHPK, është institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK siguron se uji i distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendor, për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik. Në këtë raport vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit të realizuara nga KRU-të, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve gjatë vitit 2022, ka qenë ne përputhje me standardet e ujit të pijshëm me një përputhshmëri prej 98.5% për testet bakteriologjike dhe 94.7% për testet kimike. Sikur është prezantuar edhe në tabelën 26, gjatë vitit 2022 përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave të parametrave mikrobiologjikë, ka qenë në Hidrogjenin Jugor dhe tek Hidrodrini me 99.6%, përkatësishtë 99.4%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në Gjakova me 95.6% dhe Bifurkacioni me 97.5%. Ndërsa sa i përket parametrave fiziko-kimike, përputhshmëria më e lartë ka qenë në Hidromorave me 100%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në Hidrodrini me me 87.1%.

Tabela 27. Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-ve 2022[33]

Kompanitë Regjionale	Bakteriologjike	Fiziko-Kimike	Mesatarja për KRU
Prishtina	98.7%	100%	99.3%
Hidroregjioni Jugor	99.6%	99.1%	99.3%
Hidrodrini	99.4%	87.1%	93.3%
Mitrovica	98.8%	98.2%	98.4%
Gjakova	95.6%	95.6%	95.6%
Bifurkacioni	97.5%	97.8%	97.6%
Hidromorava	99.3%	100%	99.6%
Mesatarja e pergjithshme	98.5%	94.7%	96.6%

Krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, gjatë vitit 2022, ishte më e mirë për përshtatshmëri bakteriologjike dhe më e dobët për përputhshmëri

[33] *Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar- Përputhshmëria me kushtet e licencës, ARRU 2022*

fiziko-kimike. Mesatarja e përgjithshme e përputhshmërisë mikrobiologjike në vitin 2021 ishte 98.3%, krahasuar me 98.5 % të vitit 2022, ndërsa mesatarja e përputhshmërisë fiziko-kimike në vitin 2021 ishte 98.6% krahasuar me 94.7% të vitit 2022.

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës - KRU-të si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit për vitin 2022, kanë ofruar shërbime të ujësjellësit tek 79% e popullatës. Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen nga sistemet e menaxhuara nga KRU, në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit. Shprehur në terma të vendbanimeve, nga gjithsej 1,240 janë vetëm 672 vendbanime që kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU. Gjatë vitit 2022 janë shtuar 6 sisteme rurale të ujësjellësit nën menaxhimin e të gjitha KRU-ve krahasuar me vitin 2021. Ndërsa, sipas informacioneve të cilat ARRU janë edhe 87 sisteme të furnizimit me ujë tashmë të ndërtuara në zonat rurale, e që plotësojnë kushtet infrastrukturore që të merren në menaxhim nga KRU-të respektive.

Me hyrjen në funksion të këtyre sistemeve, me ujë do të furnizohen edhe rreth 89,274 banorë, ndërsa përqindja e popullatës me qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU do të rritej në 84%[34]. Në 2022 numri i lidhjeve të reja në shërbimet e ujësjellësit, në tërë territorin e shërbyer nga 7 KRU është rritur për 1,464 karahasuar me vitin 2021.

[34] *Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar- Përputhshmëria me kushtet e licencës, ARRU 2022*

6. Gjendja e mjediseve të rrezikuara

Zonat e rrezikuar mjedisore në Kosovë gjindën në të gjitha regjionet e Kosovës. Zonat e rrezikuara mjedisore do të duhej të rregullohej me ligj të veçant dhe në përgjithësi për gjithë vendin varësisht nga shkalla e rrezikshmerisë mjedisore**.** Me ligj do te duhej të rregullohen kushtet e përgjithshme për përcaktimin e zonës së rrezikuar mjedisore dhe rreth saj, mënyra e financimit, si dhe mekanizmat institucionalë për zgjidhjen e këtyre zonave të rrezikuara mjedisore. Një Lidh të till e ka vetëm Komuna e Obiliqit, si një komunë që është me e rrezikuar nga ndotja e termocentraleve energjetike.

6.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut

Korporata Energjetike e Kosovës është ndërmarrja kryesore për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë. Asetet e KEK-ut janë pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Funksionet e Korporatës rregullohen përmes politikave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.
Sipas legjislacionit mjedisor të gjitha subjektet të cilat shkaktojnë ndotje janë të obliguar të organizojnë sistem të monitorimit me qëllim të përcjelljes së nivelit të ndotjes dhe të raportojnë rregullisht në institucionet qendrore. KEK-u gjatë vitit 2022 nuk ka respektuar standardet në nivelin e përcaktuara në legjislacionin përkatës mjedisor.
Krahas kesaj gjatë vitit 2022 nuk ka patur monitorim të ndikimeve mjedisore në DPQ (Divizionin e Prodhimit të Qymyrit); monitorimi i ujit, ajrit, tokës, zhurmës, vibrimeve, florës, faunës dhe mbeturinave (vajrat). Monitorimi i këtyre ndikimeve mjedisore nuk është realizuar në mungesë të përzgjedhjes se operatorit për shërbimet e monitorimit të mjedisit në KEK, dhe tejzgjatjes së proceduarve për përzgjedhjen e operatorit për monitorimin e cilësisë së ujit të ajrit, tokës dhe zhurmës. Disa tregues kryesor të operimit të KEK janë prezantuar në tabelën 28.

Tabela 28. Disa nga treguesit kryesor të operimit të KEK-ut gjatë vitit 2022

Treguesit	**2022**
Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga `TC Kosova A`	2295488 (MËh)
Prodhimi i energjisë elektrike nga `TC Kosova B`	4050908 (MËh)
Harxhimi i përgjithshëm i linjitit	8, 404,120 (t)
Sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar	1216333 (t)
Konsumi i ujit të dekarbonizuar dhe të demineralizuar `TCA` dhe `TCB`	19.373.762 (m3)

Mbeturinat e gjeneruara në KEK, përveq hirit si mbetje pas djegies së qymyrit në procesin teknologji, janë edhe forma tjera te mbeturinave të gjeneruar të cilat janë paraqitura në tabelen 29.

Tabela 29. Mbeturinat metalike, vajra, shirit transportues

TC	Mbeturina të hekurit (kg)	Mbeturina të bakrit (kg)	Vajra (lit.)	Shirit transportues. (kg)
TC A	350000-400000	2 500	0	7 000
TC B	2 327 000	4 000	20 000	0
Total	**2 677000-2 727000**	**6 500**	**20 000**	**7 000**

Në KEK si mbetje ndodhen edhe transformatorët që përmbajnë vaj me PCB. Aktualisht, janë 21 transformatorë me përbërje vaji me PCB të cilat gjenden në Hangarin A2 pranë TC ''Kosova B'', ndërsa 5 transformator në lokalitetet e TC "Kosova-A".

Mbeturinat radiaoaktive janë të vendosura në magazinën e hapësirës se ish Gazifikimit i ndërtuar në fund të viteve të 60ta. Burimet e shpenzuara radioaktive të cilat janë vendosur në depo janë të regjistruara në listën e burimeve radioaktive të Republikës së Kosovës. Këto mbeturina monitorohen në vazhdimësi dhe për ndryshimet eventuale raportohen të autoritetet përgjegjëse.

Në tabelën 31 janë prezantuar emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO_2, NOx dhe pluhurin total në të dy Termocentralet e `Kosova A` dhe `B`. Gjatë vitit 2022, ka pasur zvogelim të emetimeve të pluhurit total, emetimeve te SO_2 dhe NOx në krahasim me vitin 2021. Emetime më të larta janë matur në Termocentralet e `Kosova B` (bllokun B1 dhe B2) krahasuar me Termocentralet e `Kosova A` (bllokun A3, A4 dhe A5).

Tabela 30. Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO2, NOx dhe pluhurin total nga TCA dhe TCB 2021-2022

TC	SO2 (t)		NOx (t)		Pluhuri total (t)	
	2021	**2022**	**2021**	**2022**	**2021**	**2022**
TC A3	2366	1823	2867	2318	235	2271
TC A4	1147	2610	1180	3060	96	2713
TC A5	2764	1185	3097	1491	222	1380
TC B1	4956	4329	5378	5347	2801	2606
TC B2	3398	3344	4925	4347	2639	2158
Totali	**14631**	**13292**	**17447**	**16564**	**5993**	**5401**

6.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit

Gjatë vitit 2022 ka rifilluar prodhimin e pjesshëm (me ndërprerje) nga gjysma e majit deri ne gjysmën e korrikut, dhe me pas nuk ka operuar. Shumica e matjeve të parapara sipas obligimeve që dalin nga Leja Mjedisore e Integruar, kryesisht matje që realizohen nga jashtë, nuk janë realizuar, pasi qe kriza ekonomike e ka ndikuar në ndërprerjen e prodhimit, ngritja enorme e energjisë në tregun evropian (prej nga kompania e Ferronikelit furnizohet me energji), ka detyruar kompaninë ta ndal prodhimin për një kohë të pacaktuar që nga Tetori i vitit 2021.

Në mungesë të të dhënave raportuese vlerësimi i gjendjes mjedisore për operatorin Neë Co Feronikel është si rezultat i punës sa ishte fabrika në prodhim Maj-Korrik 2022. Në gjysmën e Korrikut fabrika ka ndërprerë prodhimin për kohë të pacaktuar dhe më nuk ka pasur prodhim gjatë vitit 2022.

Monitorimi i pluhurit të depozituar (Aerosendimenti) nga rezultatet e paraqitura përgjatë muajve sa ka operuar kompania gjatë vitit 2022 shihet se nuk ka tejkalime bazuar në standardin për aerosendiment (sipas OBSH-së) 300 mg/m²/ ditë në asnjë rast. Bazuar në matjet e realizuara, emetimet e pluhurit gjatë punës sa ka operuar fabrika gjatë vitit 2022, janë regjistruar me vlera me të ulëta sesa limiti i lejuar në të tri pikat monitoruese (furra elektrike, furra rrotulluese dhe konvertori).

Në tabelën 32 është paraqitur sasia totale emisioneve të pluhurit të emetuara në ajër për vitet 2021 dhe 2022, të shprehura në ton. Sasia totale e pluhurit të emetuar gjatë vitit 2022 ishte rreth 11.51 ton, ndërsa gjatë vitit 2021 rreth 70 ton. Shkarkimi më i madh është matur tek furra rrotulluese.

Tabela 31. Sasia totale vjetore e pluhurit të emetuar nga Feronikeli për vitin 2022

Viti	Furra elektrike	Konvertori	Furra rrotulluese	Totali
2021	0.6t	9.8t	59.6t	70.12t
2022	0.09t	1.67t	9.75t	11.51t

Gazrat e monitoruara (CO, NOx, SO_2) gjatë muajve në operim, janë regjistruar me vlera më të ulëta sesa limiti i lejuar në të dy pikat monitoruese (furra rrotulluese dhe konvertori). Në tabelën 32 janë paraqitur të dhënat për sasinë totale të emisioneve të CO, NOx dhe SO_2, të shkarkuar në ajër për vitet 2021 dhe 2022, të shprehura në ton.

Për sasinë totale të CO të emetuar gjatë vitit 2022 nuk ka të dhëna, ndërsa gjatë vitit 2021 ishte rreth 1667 ton, sasia totale e NOx të emetuar gjatë vitit 2022 reth 17.91t ton ndërsa gjatë vitit 2021 ishte rreth 166 ton, kurse sasia totale e SO2 të emetuar gjatë vitit 2022 ishte rreth 39.77 ton, ndërsa gjatë vitit 2021 ishte rreth 1097 ton.

Tabela 32. Sasia totale vjetore e ndotësve CO, NOx dhe SO2 për vitin 2022 nga Feronikeli

Gazrat	Konvertori A2.2		Furra rrotulluese A2.1		Totali	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022
CO	46.3t	/	1,621.1t	/	1,667.4t	/
NOx	35.2t	7,38	130.9t	10.53t	166.2t	17.91t
SO_2	10.1t	3,24	1,087.3t	36,53	1,097.4t	39.77t

Cilësia e ujërave - Bazuar në raportet mujore dhe raportit vjetor të dërguar në MMPHI nga operatori industrial "Neë Co Feronikel", gjatë vitit 2022 ka operuar pjesërisht. Janë raportuar vetëm mesataret e disa parametrave të matur për ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësore gjatë muajve maj, qershor dhe korrik. Të gjithë parametrat e matur në pikat monitoruese për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore janë brenda vlerave të lejuara sipas Udhëzimit Administrativ UA/MMPHI 02/2022, në përjashtim të fosforit total i cili ka pasur tejkalime në vendmostrimet M1 dhe M6.

Menaxhimi i mbeturinave – Gjatë aktivitetit të fabrikës prodhohen mbeturina të ndryshme. Disa nga këto mbeturina deponohen në deponi të caktuara, si: mbeturina industriale (skoria e FE) që është deponuar në deponinë e skories Dushkaja 1, zona e minierës së Çikatovës (46195 ton), ndërsa skoria e konvertorit riciklohet në proces. Mbeturinat e rrezikshme ruhen në deponinë e përkohshme për këtë qëllim e destinuar vetëm për këto lloj mbeturinash. Mbeturinat jo të rrezikshme deponohen përkohësisht në deponinë e përkohshme për këto lloj mbeturinash, ato metalike shiten si skrap metali, ndërsa për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale të rëndomta Ferronikeli ka angazhuar një kompani private "MSS". Në tabelën 33 janë paraqite llojet e këtyre mbeturinave dhe sasia vjetore gjatë vitit 2022.

Tabela 33. Gjenerimi i mbeturinave industriale nga Feronikeli për vitin 2022

Treguesit	2022
Skoria e gjeneruar nga furra elektrike, të deponuarë në deponinë e skories `Dushkaja 1`.	46195 ton
Skorie e gjeneruar nga konvertori e deponuar brenda objektit	3316 ton
Materialet zjarrduruese të përdorura	0 t/vit.
Llumi nga sistemet e pastrimit	1493 t/vit.

6.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem

Operatori i Sharrcem bënë monitorim të vazhdueshem të emisioneve nga burimet kryesore.

Emetimet në ajër - Bazuar në matjet e realizuara, emisionet e pluhurit gjatë vitit 2022 janë regjistruar me vlera më të ulëta krahasuar me limitin e lejuar. Emisionet e SOx janë shumë të ulëta, për shkak të përqendrimit të ulët të squfurit në lëndën djegëse dhe lëndët e para. Në bazë të rezultateve të matjeve nga sistemi i monitorimit të vazhdueshëm, është paraqitur përqendrim mesatar vjetor i SOx dhe NOx nga furra rotulluese për gjatë viteve të fundit. Emisionet e NOx janë nën pragun e kufirit

(VKE) të përcaktuara nga legjislacioni vendor dhe të kërkesave të IPPC. Për shkak të lëndës së parë të kufizuar (Mergele) në minieren e Dimces, cilësia aktuale e këtij materiali ka një modul më të lartë silikat i cili kërkon temperatura më të larta për krijimin e fazës së lëngshme në furrën rrotulluese, përkatësisht sasi më të larta të lendës djegëse, duke rezultuar në rritjen e emisioneve të NOx (figura 28).




Figura 28. *Trendi i emsioneve te NOx dhe SOx për vitet 2020-2022*[35]

Cilësia e ajrit në zonën e fabrikës - Vlerat e monitoruara nga sistemi vetanat i fabrikës tregojnë se koncentrimet vjetore për parametrat e cilësisë së ajrit në zonën e fabrikës janë dukshëm nën vlerat kufitare dhe nuk ka pasur tejkalime të parametrave kryesor të cilesisë së ajrit (tabela 34).

Table 34. Koncentrimi vjetor i parametrave të cilësisë së ajrit në zonën e fabrikës 2021-2022

Parametri	**2021**	**2022**	**Vlerat e lejuara**
PM_{10} (mg/m³)	0.043	0.040	0.05
$PM_{2.5}$ (mg/m³)	0.021	0.020	0.025
NO_2 (mg/m³)	0.020	0.019	0.04
SO_2 (mg/m³)	0.011	0.010	0.125
O_3 (mg/m³)	0.027	0.024	0.12
Zhurma (dB)	63	63.5	70

Menaxhimi i ujërave - Investimet e menaxhimit të ujit në sistemin e riciklimit të ujit dhe përmirësimin e rrjeteve ekzistuese të ujit kanë çuar në përdorimin më efikas të ujit, ndërsa zhvillimi dhe implementimi i sistemeve të menaxhimit të ujit ka përmirësuar monitorimin e përgjithshëm dhe mundëson raportimin mbi përdorimin dhe shfrytëzimin e ujit në baza të qëndrueshme.

Cilësia e ujërave të përdorura dhe të shkarkuara - Impianti për trajtimin e ujërave të zeza ka qenë në funksion për gjatë gjithë vitit 2022 dhe nuk ka pasur ndonjë problem në funksionimin e tije. Parametrat monitorues të shkarkimit të ujërave të

[35] *Raporti vjetor për mjedis në Sharrcem për vitin 2022*

trajtuar kanë qenë nën vlerat e lejuara në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trup ujor.

Menaxhimi i mbeturinave- Mbetjet e ngurta ruhen përkohësisht në vende të veçanta të përcaktuara në afërsi të vendeve ku gjenerohet brenda Fabrikës. Magazinimi i tillë kryhet në kuti të posaçme në kontejnerë ose vende të destinuara dhe të shënuara / etiketuara në mënyrë specifike për secilën mbetje. Varësisht nga lloji i mbetjeve te ngurta ne hapësira të vecanta të cilat janë të kufizuara me qellim të mbrojtjes nga rrjedhjet që mund të shkaktonin në ujë dhe tokë. Mbeturinat barten dhe largohen nga Fabrika nga nënkontraktorët/pala e tretë e licensuar. Këta nënkontraktorë ofrojnë shërbime lidhur me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Në tabelën 35 është prezantuar sasia vjetore e kategorive të ndryshme të mbeturinave të gjeneruara nga fabrika Sharcem.

Tabela 35. Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2022

Mbetje të përziera komunale (t/v)	Scrap (t/v)	Tulla për murim te furres (t/v)	Thasë të shkyer të cem. (t/v)	Letër dhe karton (t/v)	Mbetje nga demolimet (t/v)	Paleta të drurit (m3/v)	Vajra të përdorur (t/v)
47.79	211.82	233.2	15.4	2.5	466.4	3.86	0.5

6.4. Zonat tjera të rrezikuara (Hotspotet mjedisore)

Zona të rrezikuara mjedisore në Kosovë klasifikohën në dy kategori: Zona të rrezikuar mjedisore të trasheguara nga e kaluara të njohura si venddeponime të mbetjeve industrial dhe minerare, bujqësore dhe mbeturinave urbane dhe Zona të rrezikuara mjedisore nga mbetjet dhe shkarkimet e operatoreve ekonomik në operim. Zonat e rrezikuara mjedisore i gjëjmë në të gjitha regjionet e Kosovës. Me theks te veçant janë deponit e hirit në Obiliq, deponit industrial dhe minerare me metale të renda në Mitrovicë, Zveçani, Graçanicë, Novo Bërdo, Stantërgu, Leposaviqi, mbetjet nga mbeturinat e rrezikshme në 17 vende të ndryshme të vendit etj.[36] Forma e mbetjeve që paraqesin rrezik mjedisore janë deponit për deponim të mbeturinave urbane (7 deponi, 3 transfere) dhe deponit ilegale.

Mbeturinat e rrezikshme dhe kemikatet si mbeturinë akoma nuk kanë gjetur zgjidhje që nga viti 1999. Procesi dhe tentativat për grumbullim dhe magazinim në një pikë te vetme deri me sot nuk ka patur sukses. Një projekt i financuar nga Zyra e BE në Prishtinë dhe në bashkëpunim me MMPHI, Komuna e Obiliqit dhe KEK, janë në rrugë të mbarë që problem i mbledhjes së përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme të jetësohet. Ky projekt si mbështetje për procesin e dekomisionimit të Kosovës A, një zonë e shfrytezuar e tokës në këtë zonë është në proces të mbarë të përgatitjes

[36] *Raporti, Mbeturinat e rrezikshme industrial në Kosovë, AMMK 2019*

dhe jetësimit të magazinimit te përkohshëm të mbetjeve të rrezikshme. Aktualisht janë në proces të përcaktimit të dy zonave: hangarit ekzistues dhe ndertimit te një objekti të ri, që kjo e fundit do jetë si zgjidhje me e mire dhe afatgjate.




Figura 29. *Opsionet e depozitave të mbeturinave të rrezikshme në zonën e Termocentralit A*[37]

Gjendja ekzistuese e mbeturinave të rrezikshme është jashtë standardeve mjedisore të ruajtjës dhe magazinimit të tyre. Janë të ruajtura dhe magazinuara pa ndonjë trajtim paraprak, pa respektuar standardet dhe legjislacionin për magazinim, dhe aspak miqësor me mjedisin. Mbeturinat e rrezikshme monitorohen dhe inspektohen nga Inspektorati Mjedisore i MMPHI-së, KFOR dhe FSK.

[37] *Report on Task 02: Concept of Hazardous Waste Storage and Disposal Infrastructure. Contract No 397-715 Add. 08Identification number EuropeAid/136614/DH/SER/XK- 23 February, 2023 , SWECO*

7. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit

7.1. Përafrimi i legjislacionit mjedisor kombëtar me Direktivat e BE-së

Politika e përgjithshme Kombëtare e Kosovës përfshinë edhe procesin e integrimeve evropiane. Ndër sfidat kryesore në këtë proces është edhe mjedisi, plotësimi i standardeve mjedisore evropiane dhe përafrimi i legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane.

Komisioni Evropian ka monitoruar progresin e harmonizimit të legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë të BE-së dhe zbatimin e saj. Në tabelën vijuese është prezantuar një përmbledhje e direktivave kryesore të BE-së për mjedisit dhe niveli i transpozimit të tyre në legjislacionin nacional mjedisorë (tabela 36).

Tabela 36. Niveli i transpozimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian për mjedis në legjislacionit nacional mjedisor

Fusha	Direktiva e BE	Niveli i transpozimit
Legjislacioni horizontal	Direktiva për VNM (85/337/EEC)	90%
	Direktiva për VSM (2001/42/EC)	100%
	Direktiva për informimin mjedisor (2003/4/EC)	65%
	Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC)	100%
	Direktiva INSPIRE (2007/2/EC)	18%
	Direktiva për krimin mjedisor (2008/99/EC)	71%
	Direktiva për përgjegjësinë ndaj mjedisit (2004/35/EC)	80%
Kualiteti i Ajrit	Direktiva për kualitetin e ajrit ne ambient (2008/50/EC)	98%
	Direktiva për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin, dhe hidrokarburet aromatike poli ciklikë në ajër (2004/107/EC 4)	98%
	Direktiva NEC, Pragjet e emisioneve nacionale ne ajër (2001/81/EC)	0%
	Direktiva për përmbajtjen e sulfurit të derivate te lëngshme (1999/32/EC)	40%
	Direktiva për pikat e karburantëve për Substancat Organike të Avullueshme/VOC (94/63/EC)	98%
	Direktiva për fazën II për pikat e karburantëve Substancat Organike të Avullueshme/VOC (2009/126/EU)	30%
Menaxhimi i mbeturinave	Direktiva kornizë për mbeturina (2008/98/EC)	61%
	Direktiva për bateritë mbeturinë (2006/66/EC)	77%
	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	99%
	Direktiva për Poliklorur Bifenili dhe Poliklorur Trifenili (96/59/EC PCB/PCT)	83%
	Direktiva për automjetet mbeturinë (2000/53/EC)	100%

	Direktiva për deponitë sanitare të mbeturinave (99/31/EC)	89%
	Direktiva për kufizimin e përdorimit të disa substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike (2011/65/EU RoHS)	92%
	Direktiva për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (2012/19/EU ËEEE)	89%
	Direktiva për menaxhimin e mbetjeve minerare (2006/21/EC)	100%
	Direktiva për Llumin e Ujërave të Zeza (86/278/EEC)	75%
	Direktiva e plastikës për një përdorim (EU 2019/904)	0%
Kimikatet	Direktiva për Asbestin (87/217/EEC)	88%
	Rregullorja për Biocide (528/2012/EU)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm/POPs (EU 2019/1021)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme (EU/649/2012)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve/REACH (EC/1907/2006)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave kimike/CLP (EC/1272/2008)	Nuk ka vlerësim
Kualiteti i ujit	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)	76%
	Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC)	76%
	Direktiva për ujërat nëntokësorë (2006/118/EC)	64%
	Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)	94%
	Direktiva për nitratet (91/676/EEC)	37%
	Direktiva për ujërat larëse (2006/7/EC)	92%
	Direktiva për standardet e kualitetit të ujit (2008/105/EC)	31%
	Direktiva për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime (2007/60/EC)	100%
	Direktiva për specifikacionin teknik për analiza kimike te monitorimit te statusit të ujërave (2009/90/EC)	0%
Mbrojtja e Natyrës	Direktiva për zogjtë e egër (79/409/EEC)	97%
	Direktiva për habitatet natyrore (92/43/EC)	100%
	Direktiva për rregullat e mbajtjes së shtazëve të egra në kopshte zoologjike (1999/22/EC)	92%
	Rregullorja CITIES për tregtimin ndërkombëtarë të llojeve të rrezikuara të Florës dhe Faunës (EC/338/97)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja për llojet e huaja invazive (EU, 1143/2014)	Nuk ka vlerësim
	Direktiva për Eksperimentim me Kafshë (2010/63/EU)	Nuk ka vlerësim
Kontrolli i ndotjes industriale	Direktiva për emisionet industriale (2010/75/EU)	69%
	Direktiva Seveso III për Kontrollin e aksidenteve te mëdha industriale (2012/18/EU)	98%

	Direktiva për Kontrollin e Komponimeve të Avullueshme Organike nga Bojrat, Verniqet dhe Produktet e Rifiniturës së Automjeteve (2004/42/EC - VOCs)	88%
	Rregullorja për Eko-Etiketimin (EC/66/2010)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja EMAS/Eko Menaxhimin dhe Skemën e Auditimit (EC/1221/2009)	Nuk ka vlerësim
	Rregullorja për Merkurin (EU, 2017/852)	Nuk ka vlerësim
Zhurma	Direktiva për zhurmën mjedisore (2002/49/EC)	59%

7.2. Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore

Kosova në masë të kënaqshme e ka të zhvilluar kornizën strategjike dhe programore për mjedisin dhe sektorët e tij, mirëpo niveli i zbatimit është ende në shkallë të ulët. Në tabelën 38, janë prezantuar dokumentet kryesore strategjike dhe programore të sektorit të mjedisit dhe niveli i zbatimit të tyre.

Tabela 37. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (drafti i parë) Pjesë e Strategjisë janë edhe Strategjia për Cilësinë e Ajrit dhe Strategjia për Biodiversitetin.	2023-2033	Në proces të hartimit	Në proces të hartimit
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave	2021-2030	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet ne kontinuitet
Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2021-2023	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet ne kontinuitet
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2018-2027	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi, Nr. 05/90, datë 19.02.2019	Zbatimi në kontinuitet
Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosoves	2017-2036	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës Vendimi Nr.16/20 dt. 20.12.2017	Zbatimi në kontinuitet

Plani Nacional Për Energji dhe Klimë i Republikës së Kosovës (Drafti i parë)	2025-2023	Në proces të hartimit	Në proces të hartimit
Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës (Rishikimi i planit 2010-2020+)	2023-2028	Në proces të rishikimit	Në proces të rishikimit
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri"	2013-2022 (në proces të rishikimit)	Në proces të rishikimit	Pjesërisht
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	2023-2033	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 05.07.2023	Në fazën fillestare
Plani Hapësinor për Monumentin e natyrës me rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Nuk ka filluar zbatimi në mungesë të organit menaxhues
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri"	2015-2024 (në proces të rishikimit)	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Pjesërisht

Në shtojcat 6, 7 dhe 8, janë prezantuar të dhëna më të detajuara nga vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave, vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodversitetin dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Stetërore të Ujërave.

Në tabelën 38 janë prezantuar të dhënat për procesin e kompletimit të planeve të nivelit lokal për sektorin e mjedisit. Sikurse shihet nga tabela shumica e komunave kanë të hartuara plane lokale për menaxhimin e mbeturinave, disa prej komunave kanë edhe plane lokale të veprimit në mjedis, ndërsa që planet tjera janë në proces të hartimit ose mungojnë.

Tabela 38. Planet mjedisore në nivel lokal 2022

Komuna	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis	Plani Lokal i Veprimit për Mbeturina	Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet	Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit	Plani Lokal i Mobilitetit	Plani Lokal për Energji dhe Klimë
Prishtinë	-	+	-	*Draft*	+	*Draft*
Obiliq	+	+	-	+	-	-
Drenas	+	+	+	+	-	*Draft*
Shtime	+	+	*Draft*	-	+	-
Hani i Elezit	-	+	-	-	-	-
Prizren	-	+	-	-	-	*Draft*
Mitrovica e Jugut	+	+	-	-	+	-
Deçan	+	+	-	-	-	+
Gjakovë	+	+	+	+	*Draft*	-
Rahovec	+	+	*Draft*	*Draft*	+	*Draft*
Skënderaj	-	+	-	-	-	-
Kaçanik	*Daft*	+	-	-	-	-
Dragash	-	+	+	-	-	-
Klinë	-	+	-	*Draft*	-	-
Gjilan	+	-	-	+	-	-
Fushë Kosove	-	+	-	-	-	-
Vushtrri	-	+	-	-	-	-
Pejë	*Rishikim*	+	-	+	*Draft*	-
Podujevë	-	+	-	-	-	-
Junik	+	-	-	-	+	-
Kamenicë						-
Istog	-	+	-	*Draft*	-	*Draft*
Malishevë	-	-	-	-	-	
Lipjan	-	+	-	-	+	
Suharekë	-	+	-	-	+	-
Ferizaj	-	+	-	-	-	
Viti	+	+	+	-	+	
Mamushë	+	+	-	-	-	
Zveçan	-	+	-	-	-	-
Leposavic	-	+	-	-	-	-
Gracanicë	-	+	-	-	+	
Ranillug	-	+	-	-	-	-
Partesh	-	+	-	-	-	-
Kllokot	-	+	-	-	-	
Zubin Potok	-	+	-	-	-	-
Shterpcë	-	+	-	-	-	-
Mitrovicë e Veriut	-	+	-	-	+	

7.3. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit mjedisor në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinorë dhe ndërtimit, në nivel qendror Inspektorati i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit / Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, sipas detyrës zyrtare në vitin 2022 ka realizuar: 628 mbikëqyrje inspektive me procesverbal, 257 vendime, 198 gjoba kundërvajtës.

Krahasuar me vitet 2020-2021 vërehet se Inspektorati qendror në vitin 2022 ka qenë qenë më aktiv në mbikqyrej inspektive dhe në lëshimin e vendimeve dhe më pak aktiv në shqiptimin e gkobave kundërvajtëse. Detajet specifike janë prezantuar në tabelën 39.

Tabela 39. Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore 2020-2022

Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e mbrojtjes së mjedisit	**Numri i aktiviteteve 2020**	**Numri i aktiviteteve 2021**	**Numri i aktiviteteve 2022**
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	81	291	317
Vendime	39	95	124
Gjoba kundërvajtëse	9	104	95
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e mbrojtjes së ujërave			
Mbikëqyrje inspektive me procesverbal	95	172	176
Vendime	10	88	89
Gjoba a kundërvajtëse	66	118	99
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e mbrojtjes së natyrës			
Mbikqyrje inspektive me procesverbal	25	17	23
Vendime	7	7	11
Gjiba kundërvajtëse	-	6	4
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit			
Mbikëqyrje inspektive me procesverbal	74	98	112
Vendime	15	28	33
Gjoba kundërvajtëse	2	8	-
Gjithsejt			
Mbikëqyrje inspektive me procesverbal	275	578	628
Vendime	71	218	257
Gjoba kundërvajtëse	77	236	198

Gjatë vitit 2022, për dëmet e shkaktuara në resurset natyrore, Drejtoritë e Parqeve Kombëtare Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna, kanë ngritur në prokuroritë themelore 66 kallëzime penale (21 në Prokurorinë Themelore në Feriza, 33 në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe 11 në Prokurorinë Themelore në Pejë). Më shumë detaje në tabelën 40.

Tabela 40. Kallëzimet penale në prokurorotë themelore për dëmet në resurset natyrore në PK 2022

Lloji i aktivitetetit	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj	21	€ 28.844.50
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren	33	€ 41.951.50
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Pejë	11	€ 9.798,00

Kurse në nivel lokal nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, për sa i përket zbatimit të legjislacionit mjedisor në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, kanë raportuar vetëm 12 komuna.

Gjatë vitit 2022 në nivel lokal janë realizuar 1089 mbikëqyrje inspektive me procesverbal, 407 asistime në inspektime, 134 vendime, 79 gjoba mandatore, 83 gjoba administrative, 667 rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje, si dhe 22 inicime në Gjykata (tabela 41).

Table 41. Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2022

Aktivitetet inspektuese për vitin 2022	Inspektime me procesverbal	Asistime në inspektime	Vendime	Gjoba mandatore	Gjoba administrative	Rekomandime urdhëresa dhe vërejtje	Inicime në Gjykata
Mamushë	16	12	3	/	/	28	/
Istogë	20	19	12	/	/	19	/
Skenderaj	240	57	20	10	0	300	11
Gracanicë	58	/	/	14	/	58	/
Rahovec	108	185	34	15	0	10	7
Hani i Elezit	12	7	8	1	0	2	0
Gjilan	67	92	0	14	0	92	0
Junikë	46	17	1	1	0	5	0
Gjakovë	235	/	9	/		77	/
Shtime	50	/	10	10	/	/	/
Obiliq	38	18	7	7	22	45	/
Pejë	199	-	30	7	61	31	4
Gjithsejt	**1089**	**407**	**134**	**79**	**83**	**667**	**22**

7.4. Leje- dhënia

Sipas të dhënave nga MMPHI, gjatë vitit 2022 janë realizuar aktivitete në të gjitha fushat përkatëse. Bazuar në autorizimet e legjislacionin mjedisor gjatë vitit 2022, janë lëshuar 73 pëlqime mjedisore për VNM, 80 leje mjedisore, 5 leje të integruara mjedisore, 5 autorizime mjedisore, 11 licenca, 19 pëlqime ujore, 66 leje ujore për shkarkim dhe 74 leje ujore për shfrytëzim. Të dhëna më të detajuara për aktivitetet e leje -dhënies në sektorin e mjedisit, mbeturinave, dhe të ujërave, janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 42. Aktivitetet për leje -dhënie gjatë vitit 2022

Aktivitetet për Pëlqime Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Pëlqime Mjedisore VNM	78
Kërkesa të aprovuara për Pëlqime Mjedisore VNM	73
Kërkesa të refuzuara për Pëlqime Mjedisore VNM	5
Kërkesa të pranuara dhe aprovuara për Pëlqime Mjedisore VSM	3
Aktivitetet për Leje Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Leje Mjedisore	149
Kërkesa të aprovuara për Leje Mjedisore	80
Kërkesa të refuzuara për Leje Mjedisore	49
Përfundim të procedurave administrative	16
Ne procedurë te LM	4
Aktivitetet për Leje të Integruara Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Leje të Integruara Mjedisore	11
Kërkesa të aprovuara për Leje të Integruara Mjedisore	5
Kërkesa të refuzuara për Leje të Integruara Mjedisore	9
Në procedurë	15
Aktivitetet për Autorizime Mjedisore	
Kërkesa të pranuara për Autorizime Mjedisore	6
Të lejuara	5
Lëndë të refuzuara	1
Aktivitetet e leje- dhënieve në fushën e mbeturinave	
Kërkesa për Licenca për menaxhimin e mbeturinave	12
Dhënie e Licencës për menaxhimin e mbeturinave	11
Refuzim i Kërkesës për Licenca për menaxhimin e mbeturinave	1
Kërkesa për Leje për import të qeseve të plastikes	16
Dhënia e Lejes për import të qeseve të plastikes	14
Kërkesa për Leje për për tregëtarë dhe ndërmjetës për mbeturina të parrezikshme	9
Dhënia e Lejes për tregëtarë dhe ndërmjetës për mbeturina të parrezikshme	9
Aktivitetet për Leje -dhënie në fushën e ujërave	
Kushte Ujore	3
Pëlqime Ujore	19
Leje Ujore për shfrytëzim	74
Leje Ujore për shkarkim	66
Vazhdime të Lejeve Ujore	7

7.5. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale

Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur ndonjë zhvillim më rëndësi në kuadër të procesit për forcimin, afirmimin dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve mjedisore.

Nga aktivitet tjera që ndërlidhen me zhvillimin institucional duhet veçuar:

- Vazhdimi i implementimin e disa projekteve të rëndësishme me donatorë në kuadër të institucioneve mjedisore. Shembulli i projektit për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore i mbështetur nga Qeveria Zvicerrane, që kanë përfshirë edhe aspektet e ngritjeve të kapaciteteve profesionale dhe atyre organizative, fillimi i fazës së dytë të projektit për ngritjen e kapacitetetev institucionale për menaxhimin e cilësisë së ajrit të mbështetur nga JICA, si dhe vazhdimi i projektit për pjesëmarrjen e AMMK në punën e Agjencisë së Mjedisit të Evropës edhe për një periudhë 3 vjecare.
- Rritja e përfaqësimit dhe anëtarësimit të institucioneve mjedisore të Kosovës në organizata, iniciativa dhe projekte rajonale. Shembulli i përformacës së `Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës` në rrjedhën e të dhënave në `Rrjetin Evropian për Monitorim dhe Vëzhgim EIONET`, ku edhe gjatë vitit 2022 janë përmbushur 100% e obligimeve për raportim;
- Zbatimi i projekteve të rëndësishme infrastrukturore në sektorin e mjedisit sikurse ishte funksionalizimi i 3 impinateve të reja për trajnimin e ujërave të ndotura (Prizre, Gjakovë dhe Pejë).
- Avancimi i procesit të vlerësimit të gjendjes së mbeturinave komunale përmes zhvillimit të treguesve, për raportimin dhe monitorimin e përformancës së komunave të Kosovës për sektorin e mbeturinave. Funksionalizimi dhe vënia në përdorim e ueb aplikacioni që mundëson raportimin online, si dhe trajnimi i komunave dhe kompanive të mbëturinave për raportim.
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve mjedisore përmes trajnimeve dhe programeve në nivelin nacional, regjional dhe ndërkombëtarë.
- `Këshillit Kombëtarë` për ndryshime klimatike, i cili është rithemeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë shumë aktiv dhe ka zhvilluar disa aktivitete, në mesin e teë cilave dhe hartimi i Ligjit për ndryshime klimatike.
- Fillimi i procesit për riorganizimin e institucioneve mjedisore dhe definimin e përgjegjësive institucionale, ku janë themelu grupet punuese dhe janë hartuar draftet e rregulloreve përkatëse;

Ndërsa, në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Mungesa e rrjetit për monitorimi e ujërave nëntokësoreë si dhe mungesa e monitorimit të aspekteve biologjike/ekologjike të ujërave sipërfaqësore;
- Mungesa e një sektori të veçantë për ndryshime klimatike në MMPH;
- Mungesa e një institucioni të veçantë në nivel qendror për monitorimin e kimikateve;
- Largimi i stafit të trajnuar dhe më përvojë nga institucionet përgjegjëse të sektorit

të mjedisit.

- Kapacitetet e limituara të komunave në sektorin e mjedisit, me theks të veçantë numri i vogël i inspektorëve;
- Numri i vogël i inspektorëve të mjedisit në nivel qendror, mungesa e koordinimit të inspektorëve të mjedisit në nivel qendror dhe lokal dhe mungesa e koordinimit të inspektorëve të mjedisit me inspektoratin e KPMM-së;
- Numri i vogël i zyrtarëve në disa drejtori dhe sektore të AMMK si në: `Institutin e Mbrojtjes së Natyrës`, në `Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtarë` "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna", në `Drejtorinë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë` dhe në sektorin e raportimit dhe informimit;.
- Mos certifikimi i zyrtarëve (rojeve të natyrës) dhe numri i kufizuar i stafit profesional (zyrtarëve mbikëqyrës të natyrës) në `Drejtoritë për Administrimin e Parqeve Kombëtarë` si dhe numri i kufizuar i stafit të rregullt;
- Mos funksionalizimi i `Bordit Këshillëdhënës për Mjedisin`. Bordi ende është jashtë funksionit dhe nuk ka iniciativa për themelimin e tij edhe pse është i paraparë sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Mos funksionalizimi i `Ekofondit` apo një programi të veçantë për mjedisin. Të hyrat e inkasuara në emër të mbrojtjes së mjedisit derdhen në buxhetin e Kosovës, por nuk shfrytëzohen për projekte mjedisore;

7.6. Investimet në mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit është faktor me rëndësi që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien tonë. Së këndejmi edhe rritja e buxhetit nga Qeveria e Kosovës për sektorin e mbrojtjes së mjedisitë është një faktor që tregon përkushtimin për të përmirësuar gjendjen mjedisore. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin 2022 ka shpenzuar 163,524,148 € në krahasim me 124,975,779.01€ investime në projekte të reja dhe ekzistuese, bazuar ne `Kornizën Afatmesme për Shpenzimeve` me burim financimi nga Buxheti i Kosovës. Totali i buxhetit për vitin 2022 ka qenë 191,281,296 €, krahasuar me 145,043,995 € në vitin 2021. Në vitin 2022 ka pasur rritje të buxhetit në të gjitha linjat buxhetore të MMPHI, me përjashtim të linjës paga dhe mëditje.

Tabela 43. Buxheti i MMPHI për 2021-2022

Linjat buxhetore	**2021**	**2022**
Paga dhe meditje	4,110,561	4,002,423
Mallra dhe shërbime	15,603,628	21,930,855
Subvencione dhe tranfere	1,793,813	1,643,814
Shpenzime kapitale	123,521,738	163,524,148
Shpenzime komunale	314,620	481,490
Buxheti total	**145,043,995**	**191,281,296**

Projektet mjedisore të mbështetura nga buxheti i MMPHI, janë kryesisht projekte që kanë për qëllim rregullimin dhe pastrimin e shtretërve te lumenjve, krijimin e

hapësirave te gjelbra dhe parqeve rekreative, ndërtimin urave, mbikalimeve e nënkalimeve, ndërtimin e sistemeve te ujësjellësit, ndërtimin dhe zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve, ndërtimin e impianteve, deponive sanitare, etj. Të gjitha këto projekte kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe shëndetit publik. Shumica e këtyre projekteve janë projekte kapitale me prioritet dhe që janë përfshirë edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH).

Pjesë e projekteve mjedisore janë edhe ato projekte të cilat janë financuar nga Buxheti i Kosovës nëpërmjet MMPHI-së dhe implementohen nga Komunat përmes memorandumeve përkatëse. Shumica prej tyre janë projekte në vazhdimësi nga vitet paraprake. Në kuadër të këtyre projekteve veçohen ato që janë të fokusuara në përmirësimin e gjendjes së lumenjve, furnizimin me ujë të pijes, si dhe rregullimin e hapësirave të gjelbra. Një listë e disa prej këtyre projekteve kapitale me rëndësi në fushën e mjedisit dhe ujërave është prezantuar në tabelën 44.

Tabela 44. Disa nga projektet kapitale mjedisore të mbështetura nga buxheti i MMPHI 2022

Nr.	Emri i Projektit	Shpenzimi 2022/ €
1.	Ndertimi i deponise komunale ne regjionin e Pejës	1,100,000
2.	Skema mbështetëse për mbeturina në Kosovë	3,000,000
3.	Regullimi i shtratit te lumit Sitnica Vushtrri	250,000
4.	Rregullimi i shtratit te lumit Drenica ne Drenas	150,000
5.	Studimi, riparimi dhe pajisjet monitoruese te digave ekzistuese te Kosoves	221,400
6.	Renovimi dhe ndertimi i infrastruktures mbrojtese pergjate lumit Drini i Bardhe dhe Sitnice	172,853
7.	Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë - Klinë	100,000
8.	Rregullimi i shtratit të Lumbardhit në Deçan	718,374
9.	Rregullimi i shtreterve te lumenjeve ne fshatrat, Hoqe e madhe, Brestoc, Hoqe e Madhe, Nagavc, Krushe e Madhe-Rahovec	60,000
10.	Rregullimi i shtratit te lumit Iber - Mitrovice	500,000
11.	Rregullimi i shtratit te lumit Sitnica - Mitrovice	568,048
12.	Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica në Lipjan	290,515
13.	Rregullimi i shtratit te Përrockes ne Hajvali	79,871
14.	Rregullimi i shtratit te lumit Krivareka	300,000
15.	Rregullimi i shtratit dhe zonave te degraduara te lumit Desivojce	279,277
16.	Rregullimi i shtratit te lumit Sazli ne Ferizaj	321,735
17.	Menaxhimi i integruar i resurseve ujore në Kosovë (kontributi I MMPHI)	650,000

Mbështetja nga donatorët nuk ka munguar as gjatë vitit 2022, ku kanë filluar së implementuari (zbatuari) disa projekte të reja dhe njëkohësisht kanë vazhduar së

implementuari edhe projektet nga vitet paraprake. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për disa nga projektet më të mëdha të mbështetura nga donatorët për sektorin e ujërave dhe mjedisit.

Tabela 45. Disa nga projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2022

Emri i projektit	Donatori	Vlera e projektit	Periudha e implementimit
Përmirësimi i performancës mjedisore të termocentralit "Kosova B"	BE-IPA	76.400.000.00 €	2019-2022
Programi Mjedisor për Kosovën	SIDA-Qeveria Suedeze	6.810.000.00 €	2016 – 2022
Projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit" Faza 2	JICA-Qeveria Japoneze	Rreth 3.000.000.00 €	2021– 2026
Granti i ndihmës japoneze për zhvillim ekonomik dhe social – Faza 2	JICA-Qeveria Japoneze	357.000.000.00 JPY (Jena Japoneze)	2020-2023
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Kosovës Jugperëndimore-Gjakova	SDC, KFË, BK	SDC- 7.600.000.00 € KFË- 8.000.000.00 € Komuna e Gjakovës- 6.800.000.00 €	2019-2022
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Kosovën Jugperëndimore-Peja	KFË, BK	KFË- 8.000.000.00 € BK- 3.800.000.00 €	2019-2022
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Kosovën Jugperëndimore-Prizreni	KFË, BK	KFW- 12.000.000.00 € Komuna e Prizrenit – 3.500.000.00 € BK- 5.000.000.00 €	2017-2022
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane për Prishtinën	Qeveria Franceze BK	Qeveria Franceze (kredi) 66.000.000.00 € BK- 20.000.000.00 €	2018-2022
Zhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave - Deponia e Pejës	Komisioni Evropian -IPA	BE 10.900.000.00 € BK 1.100.000.00 €	2019-2022
Granti i përfomancës për Mjedis të pastër	BE, GIZ &BK	3.500.000.00 € 3.500.000.00 € BK	2020-2023
Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë (IWRM-K)	SDC-Qeveria Zvicerane	24.000.000 €	2020-2024
Dialogu i Drinit-Mundësimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore në pellgun e zgjatur të lumit Drin	GEF, GWP-Med	1.000.000.00 $	2016-2022
Ngritja e kapaciteteve për përdorimin e të dhënave mjedisore. Projekt i bashkëpunimit në mes të AMMK dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Suedisë	SIDA	3.000.000.00 SEK (Krona Suedeze)	2022-2025
Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit (FLOWS)	WBIF, IDA	1,000,000 € 25,100,000 € (Kredi)	2021-2025

Hartat e Rrezikshmërisë dhe Hartat e Rrezikut nga Përmbytjet	WBIF, EIB & CEB	25,100,000 € Donacion dhe kredi	2022-2024
Mbrojtja e kanalit të Ibrit	WBIF Banka Botërore Buxheti Kosovës	500.000.00 € grant 25.000.000.00 € kredi 1.5000.000.00 €	2016-2023
Plani për Menaxhimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Demontimit për Kosovën	WBIF EBRD & EIB	312.00.00 € grant 200,000.00 € kredi	2020-2023
Pjesëmarrja në punën dhe programin e Agjencisë Evropiane të Mjedisit (Projekt regjional)	EU-IPA	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues 2.480.202.00 €	2019-2022
Zgjidhje të bazuara në natyrë për komunitetet e qëndrueshme të Ballkanit Perëndimor	SIDA/IUCN	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues	2019-2022
Programi i Partneritetit Mjedisor për Anëtarësim EPPA	EU-IPA	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues	2020-2022
Tranzicioni drejt emetimit të ulët dhe ekonomisë së qëndrueshme ndaj klimës në Ballkanin Perëndimor (TRATOLOË)	EU-IPA	BE IPA – Fondi IPA me shumë përfitues	2021-2022
Fuqizimi i regjistrit të ndotësve të mjedisit PRTR në vendet e Ballkanit dhe në Moldavi.	Qeveria Gjermane	355.301.00 €	2021-2023
EU4Green	BE dhe ADA	BE 10.000.000.00 € ADA 1.000.000.00 €	2022-2025
Kosova e shëndetshmë II	Ambasada e Luksemburgut, implementuar nga UNDP dhe OBSH	1,064,750 $	2021-2023

8. Rekomandimet

Cilësia e ajrit dhe emetimet në ajër

- Të hartohet dhe miratohet Strategjia dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e ajrit;
- Të rritet efikasiteti i zbatimit të legjislacionit mjedisor, përmes mekanizmave dhe instrumenteve plotësuese;
- Të hartohen politika favorizuese për shfrytëzimin e lëndëve djegëse, që kanë shkarkime më të ulëta në mjedis dhe për zbatimin e teknologjive të pastra në proceset e prodhimit;
- Të favorizohet shfrytëzimi i transportit alternativ që ka shkarkime më të ulëta në ajër dhe të aplikohet kufizimi kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe atyre pa katalizatorë;
- Të zbatohen aktet nënligjore mbi normat e lejuara të shkarkimit në ajër nga burimet e lëvizshme dhe nga burimet e palëvizshme;
- Promovimi dhe zbatimi teknologjive të pastra në proceset industriale, në funksion të zvogëlimit të emetimeve në ajër;
- Rritja e efiçiencës së energjisë së ndërtesave dhe shtimi i hapësirave të gjelbra.

Emetimet e GHG

- Rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë, reduktimin e përdorimit të thëngjillit për prodhim të energjisë dhe rritja e eficencës së energjisë.
- Largimin e veturave të vjetra nga qarkullimi dhe zbatimi i standardeve të kontrollit të automjeteve dhe promovimi i transportit të qëndrueshëm me më pak trafik motorik;
- Përmirësimi i menaxhimit të plehut të kafshëve dhe përdorimi i kontrolluar i fertilizerëve në toka bujqësore.
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, përmes zvogëlimit të deponimit të mbeturina në deponi dhe zbatimi i sistemeve të riciklimit, ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave;
- Përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza përmes trajtimit të ujërve në impiante të trajtimit të ujërave dhe menaxhimit të llumit;
- Zvogëlimin e prerjeve ilegale të pyjeve dhe ruajtja e destinimit të shfrytëzimit të tokave sipas kategorive si dhe zvogëlimin e sipërfaqeve të djegura sipas kategorive të tokave.

Uji

- Të bëhet monitorimi i parametrave biologjik të ujërave sipërfaqësore për të përcaktuar indeksin e kualitetit të ujërave sipërfaqësore;
- Të vazhdohen investimet në ngritjen e infrastrukturës ujore me theks të veçantë në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Të trajtohen me prioritet çështjet që ndërlidhen me adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave;
- Të ndërtohen mekanizma dhe instrumente që ndihmojnë në zbatimin e objektivave strategjike dhe projekteve të planifikuara në Strategjinë Kombëtare

për Ujëra;
- Të hartohen dhe miratohen Plane Menaxhuese për basenet ujore dhe të bëhet monitorimi i zbatimit të tyre.

Toka/dheu
- Të hartohet programi për monitorimin e përhershëm të tokave bujqësore dhe atyre industriale;
- Të hartohen politikat më të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e tokave;
- Të fuqizohet zbatimi i kornizës ligjore dhe programore për sektorin e mbrojtjes së tokave nga ndotja dhe nga ndërrimi i destinimit të saj;.
- Të hartohen programe dhe projekte për rehabilitimin e tokave të identifikuara si hot-spote mjedisore;
- Të monitorohet përdorimi i pesticideve dhe fertilizerëve në toka bujqësore.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti
- Të realizohen projekte per hulumtime për evidentimin dhe monitorimin e zonave të natyrës dhe inventarizimin e llojeve bimore e shtazore dhe habitateve natyrore;
- Të themelohen dhe të funksionalizohen organet menaxhuese për zonat e mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi
- Të forcohet monitorimi i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara shtazore dhe të ndërmerren masa për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara të faunës sipas rekomandimeve dhe të gjeturave nga `Libri i faunës së Kosovës`
- Të rrishikohet statusi i rrezikushmërisë së llojeve bimore përmes rishikimit të Librit të Kuq të Florës së Kosovës;
- Të fillojë procesi për hartimin e studimit për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitatit sipas rrjetit ekologjik `Natyra 2000`;
- Të fuqizohet ispektimi dhe kontrolli i zbatimit te ligjit për mbrojtjen e natyrës;
- Të rritet numri i stafit në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.
- Të pergaditen dhe të aprovohet Planet Menaxhues dhe Planet Rregullues për zonat e mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi
- Të bëhet hulumtime për inventarizimin e gjeotrashëgimisë dhe marrjen në mbrojtje të këtyre vlerave;

Mbeturinat
- Të përmirësohet menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës, dhe të zbatohet monitorimi i shkarkimeve në mjedis nga deponitë;
- Të rritet shërbimi për grumbullimin e mbeturinave komunale në tërë territorin e Kosovës;
- Komunat e Kosovës, të angazhohen në vazhdimësi për eliminimin e deponive ilegale në territorin e tyre;
- Komunat të caktojnë lokacionet për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolomi;
- Të hartohen programe dhe sisteme në nivelin nacional për ndarjen e mbeturinave në burim dhe riciklimin e tyre.

Shëndeti Publik

- Të kryhen studime mbi ndikimin në shëndet nga ekspozimi afatshkurtër ndaj ndotjes së ajrit, duke u fokusuar në ekspozimin ndaj PM2.5, SO_2 dhe NO_2 gjatë periudhës së dimrit;
- Të monitorohet cilësia e ajrit të brendshëm në shkolla dhe institucione publike;
- Të investohet në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijes dhe monitorimin e rregullt të tij;
- Të rritet përqindja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbimin e ujësjellësit dhe me shërbimin e shkarkimit të ujërave të ndotura (kanalizimit) ;
- Të përmirësohet sistemi i informacionit shëndetësor me të dhëna të validuara;
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet studiuesve që punojnë në studimet e Vlerësimit të Ndikimit në Shëndet, për shkak të ndotjes së ajrit në nivel kombëtar dhe të paktën në atë lokal.

Zonat e rrezikuara

- Të zhvillohen politika dhe strategji specifike për administrimin e hotspoteve mjedisore;
- Të zhvillohen plane, programe dhe projekte, të cilat kanë synim parësor rehabilitimin e hotspoteve, e veçenërisht deponitë me metale të rënda, të cilat lirojnë toksicitet të lartë në mjedis dhe ndikojnë negativisht në baraspeshën ekologjike dhe rrezikojnë ekzistencën e botës së gjallë;
- Ngritja e vetëdijes qytetare për hotspotet mjedisore dhe rrezikun që vjen prej tyre;
- Të thellohet bashkëpunimi në mes të institucioneve qeveritare, joqeveritare, universiteteve vendore dhe ndërkombëtare, ekspertëve mjedisor vendor dhe ndërkombëtar, për zgjidhjen e problemit të hotspoteve mjedisore.

Të përgjithshme

- Të procedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës, `Strategjia dhe `Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.
- Të rritet buxheti i Qeverisë së Kosovës për sektorin e mjedisit dhe në veçanti për projektet kapitale mjedisore;
- Të themelohet ekofondi (fondi mjedisor) dhe mjetet e tij të përdoren për subvencione dhe programe për përmirësimin e gjendjes së mjedisit;
- Të fuqizohet zbatimi i parimeve mjedisore, e në veçanti i parimeve "ndotësi paguan" , "shfrytëzuesi paguan" dhe "parimi i masave inkurajuese" për personat juridik e fizik, të cilët zgjedhin teknikat më të mira të mundshme dhe prodhimtari të pastër;
- Të fuqizohet zbatimi i legjislacionit horizontal dhe me theks të veçantë i kërkesave ligjore nga Ligji për `Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis` dhe Ligjit për `Vlerësimin Strategjik Mjedisor`.

9. Referencat

1. *AMMK, Raporti `Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë 2021`;*
2. *AMMK, Raporti i treguesve mjedisor 2020.*
3. *AMMK, Raporti për gjendjen e ajrit për vitin 2022;*
4. *AMMK, Raporti për gjendjen e mjedisit 2021;*
5. *AMMK 2022, Raporti për Gjendjen e Natyrës 2018-2021,*
6. *ARRU 2022, Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar për vitin 2022;*
7. *ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, 2021;*
8. *ASK, Anketa e mbeturinave komunale 2022;*
9. *ASK, Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2021;.*
10. *Cilësia e ajrit në Evropë 2022, Ndikimi në shëndet i ndotjes së ajrit", EEA 2022*
11. *Developing methods for measuring national distributions and densities of wild mammals using camera traps: A Kosovo study, Sarah E. Beatham et al, 2020;.*
12. *European Union, Soil Strategy 2030;*
13. *Fungi in Kosovo – the Preliminary Data of their Diversity and Ecology, Mitko Karadelev, Ss. Cyril and Methodius University Faculty of Natural Science and Mathematics, Skopje, Macedoni;*
14. *Gjendja mjedisore e lumenjve e shkaktuar nga shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, 2022, MMPHI/AMMK*
15. *Libri i Kuq i Faunës së Kosovës, PMK/MMPH 2020;*
16. *Ligji nr.03-L-025 për mbrojtjen e mjedisit;*
17. *Ligji nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022;*
18. *MBPZHR, Raporti i Gjelbër, 2022;*
19. *MMPH , Strategjia Kombëtare për Ujërat e Kosovës 2017-2034;*
20. *MMPH , Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022;*
21. *MMPH 2015, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024*
22. *MMPH, Libri i Kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës, MMPH;*
23. *MMPH, Strategjia dhe për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2030;*
24. *MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020;*
25. *MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e ajrit 2011-2021;*
26. *MMPHI/AMMK 2022; Raport për vlerësim të gjendjes së lumenjve të shkaktuar nga shfrytëzuesit e rërës dhe zhavorrit;*
27. *Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar - Përputhshmëria me kushtet e licencës, ARRU 2022*
28. *Progress monitoring report Kosovo, EPPA 2022*
29. *Raportet vjetor per gjendjen e mjedisit, Neë Co Feronikeli*
30. *Raporti i analizës së përbërjes së mbeturinave në 7 regjionet e Kosovës, ESS L.L.C, 2022*
31. *Raporti i Gjendjes Mjedisore në KEK për vitin 2022;*
32. *Raporti për mbeturinat e rrezikshme industrial në Kosovë 2019, MMPH/AMMK*
33. *Raporti vjetor për mjedis, Sharrcemi, 2022;*
34. *Raport për monitorimin e zbatimit të strategjisë së ujërave të Kosovës 2017-203, PUACW Project, LDIP 2023;*
35. *Raporti vjetor i AMMK per emisionet në ajër sipas kërkesave të CLRTAP raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës*
36. *Raporti vjetor i gjendjes se mjedisit në NewCoFeronikeli 2022;*
37. *Raporti vjetor për mjedis në Sharrcem për vitin 2022*
38. *Raporti; Mbeturinat e rrezikshme industrial në Kosovë*
39. *Raportit për gjendjen mjedisore të lumenjeve e shkaktuar nga shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, 2022, AMMK*
40. *Report on Task 02: Concept of Hazardous Waste Storage and Disposal Infrastructure. Contract No 397-715 Add. 08Identification number EuropeAid/136614/DH/SER/XK- 23 February, 2023 ,*

SWECO

41. *Studimi i myshqeve brenda territorit të Kosovës, vështrim taksonomik dhe ekologjik, Zenel Krasniqi, Punim i Doktoratës, Universiteti i Tiranës, 2021*
42. *Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit;*
43. *WHO, Europe releases a toolbox to protect children's health from chemical pollution of indoor air in schools and day-care centres, 2023.*
44. *WHO, Protecting health through ambient air quality management: a resource package for the WHO European Region, 2023*

10. Shtojcat

Shtojca 1: Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit-Aglomeracioni AKS 1 dhe Zona ZKS 1

Aglo-meracioni	Emërtimi i stacionit monitorues	Shenja e Stacionit (Kodi)	Lokacioni	Parametrat që maten	Lloji i stacionit	Data e funksionali-zimit
Aglomerati – AKS 1	IHMK	KS0101	Prishtinë	PM_{10}, $PM_{2.5}$, SO_2, NO_X, O_3, CO.	Sfondi urban	09.01.2009
	Rilindja	KS0102	Oborri i objektit Rilindja	PM_{10}, $PM_{2.5}$, O_3, SO_2, CO, NO_2.	Sfondi urban	06.05.2010
	Obiliq	KS0110	QKMF	PM_{10}, $PM_{2.5}$, SO_2, NO_X, O_3, CO.	Sfondi urban	01.03.2013
	Dardhishtë	KS0111	Sh.M.U "Abdurrahmon Gërguri"	PM_{10}, $PM_{2.5}$, O_3, SO_2, CO, NO_x.	Sfondi urban /industrial	01.03.2013
	Palaj	KS0112	Objeti Kosova Montim	PM_{10}, $PM_{2.5}$, SO_2, NO_X, O_3, CO.	Sfondi urban/ industrial	01.03.2013
ZONA – ZKS 1	Pejë	KS0305	Sh.M.U. "Lidhja e Prizrenit"	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O_3, SO_2, CO.	Sfondi urban	04.04.2012
	Prizren	KS0406	Sh.M.U. "Abdyl Frashëri"	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O3, SO_2, CO.	Sfondi urban	01.04.2012
	Hani i Elezit	KS0508	Sh.M.U."Ilaz Hallaqi"	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O_3, SO_2, CO.	Sfondi urban /industrial	05.04.2012
	Gjilan	KS0609	Sh.M.U. "Selami Hallaqi"	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O_3, SO_2, CO.	Sfondi urban	01.04.2012
	Drenas	KS0103	Adresa Rr. "Beqir Sinan"	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O_3, SO_2, CO.	Sfondi urban	05.04.2011
	Mitrovicë	KS0204	Sh.M.U. "Eqrem Qabej"	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O_3, SO_2, CO	Sfondi urban	06.2013
	Brezovicë	KS0507	Qendra e skijimit	$PM_{2.5}$, PM_{10}, NOx, O_3, SO_2, CO.	Rural	

Shtojca 2: Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare)µg/m³	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m³	30	Nuk parashihet
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m³	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	120	Nuk parashihet

Shtojca 3: Indeksi i Cilësisë së ajrit

Cilësia	E mirë	E pranueshme	Mesatare	E dobët	Shumë e dobët	Jashtëzakonisht e dobët
Grimcat e pluhurit më të vogla se 2.5 µm ($PM_{2.5}$)	0-10	10-20	20-25	25-50	50-75	75-800
Grimcat e pluhurit më të vogla se 10 µm (PM_{10})	0-20	20-40	40-50	50-100	100-150	150-1200
Dyoksidi i azotit (NO_2)	0-40	40-90	90-120	120-230	230-340	340-1000
Ozoni (O_3)	0-50	50-100	100-130	130-240	240-380	380-800
Dyoksidi i sulfurit (SO_2)	0-100	100-200	200-350	350-500	500-750	750-1250
Niveli i Indexit të Cilësisë së ajrit (bazuar në përqendrimin e ndotësve, shprehur në µg/m³)						

Shtojca 4: Parametrat fizik, kimik dhe metalet e rënda që monitorohen nga IHMK[38]

Treguesit	Simboli	Njësia	Shpeshtësia e matjeve/vit
PARAMETRAT FIZIK			
Ora	h	0:00	11
Moti	M	vrojtim	11
Temperatura e ujit	Tu	0C	11
Temperatura e ajrit	TA	0C	11
Aroma	Ar	nuhatje	11
Ngjyra	Ngj	Co/Pt	11
Turbullira	Tur	NTU	11
Përçueshmëria elektrike	χ	µScm-1	11
Materiet e tretshme në ujë	M.tert.	mg/l	11
Përqendrimi i jonit hidrogjen	pH	0-14	11
PARAMETRAT KIMIK			
Oksigjeni i tretur	OT	mg/l O2	11
Ngopja me oksigjen	NgO	%	11
Shpenzimi kimik i oksigjenit	SHKO	mg/l O2	11
Shpenzimi kimik i oksigjenit me dikromat	SHKO-Cr	mg/l O2	11
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO5	mg/l O2	11
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO7	mg/l O2	11
Karboni organik total	KOT	mg/l C	11
Materiet totale të suspenduara	MTS	mg/l	11
Detergjentet	DET	mg/l	11
Joni nitratet	NO3-	mg/l	11
Azoti i nitrateve	N-NO3-	mg/l N	11
Joni nitrik	NO2-	mg/l	11
Azoti i nitrateve	N-NO2-	mg/l N	11
Joni amonium	NH4+	mg/l	11
Azoti i amoniumit	N-NH4+	mg/l N	11
Azoti total inorganik	ATI	mg/l N	11
Amoniumi i pa jonizuar	NH3	mg/l	11
Azoti i amoniumit te pa jonizuar	N-NH3	mg/l N	11
Azoti total organik + inorganik	AT	mg/l N	11
Azoti total organik	ATO	mg/l N	11
Orto fosfatet	PO43-	mg/l	11
Fosfori i orto fosfateve	P - PO43-	mg/l P	11
Fosfori total (poli + orto)	Ptot.	mg/l	11
Joni sulfat	SO42-	mg/l	11
Fortësia e përgjithshme	Fp	0dH	11
Fortësia e Kalciumit	Fca	mg/l	11
Fortësia e Magnezit	FMg	mg/l	11
Jonet e Kalciumit	Ca+	mg/l	11
Jonet e Magnezit	Mg+	mg/l	11
P-Alkaliteti	Pa	ml 0.1 e HCl	11

[38] *Vetëm parametrat e hijëzuar me të kaltër janë vlerësuar dhe prezantuar në këtë raport.*

M-Alkaliteti	Ma	ml 0.1 e HCl	11
Alkaliteti total	AT	mmol/l HCl	11
Bikarbonatet	HCO3-	mg/l	11
Klori i lirë	Cl2	mg/l	11
Kloruret	Cl-	mg/l	11
Silikatet	SiO32-	mg/l	11
Silici në Silikate	Si - SiO32-	mg/l Si	11
Klorofil a	Chlorophyll a	µg/l	11
Fenolet	C6H5OH	mg/l	11
METALET E RËNDA			
Kromi	Cr3+	µg/l	2
Kadmiumi	Cd2+	µg/l	2
Nikeli	Ni2+	µg/l	2
Zinku	Zn2+	µg/l	2
Mangani	Mn2+	µg/l	2
Bakri	Cu2+	µg/l	2
Hekuri	Fe2+	µg/l	2
Plumbi	Pb2+	µg/l	2

Shtojca 5: Kodet e stacioneve të monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore - lumenjtë

Kodi	Lokacioni	Lumi	Venderdhja
RV01_011	Radavc	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_012	Klinë	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_013	Gjonaj	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_014	Vermicë	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_021	Istog	Istogu	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_022	Zllakuçan	Istogu	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_031	Stërnac i ulët	Klina	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_032	Klinë	Klina	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_041	Drelaj	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_042	Pejë dalje	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_043	Grabanicë	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_051	Banjë e Malishevës	Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_052	Volljakë	Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_061	Deçan Hyrje	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_062	Kralan	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_071	Jasiq	Ereniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_072	Ura e Terzive	Ereniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_081	Zhdrellë	Rimniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_082	Xërxë	Rimniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_091	Buqallë	Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_092	Piranë	Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik

RV01_101	Prevallë	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_102	Vllashnje	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_011	Kushtovë	Ibri	Deti i Zi
RV02_012	Mitrovicë	Ibri	Deti i Zi
RV02_013	Kelmend	Ibri	Deti i Zi
RV02_021	Bablak	Sitnica	Deti i Zi
RV02_022	Lipjan	Sitnica	Deti i Zi
RV02_023	Vragoli	Sitnica	Deti i Zi
RV02_024	Plemetin	Sitnica	Deti i Zi
RV02_025	Nedakovc	Sitnica	Deti i Zi
RV02_026	Mitrovicë	Sitnica	Deti i Zi
RV02_031	Marincë	Llapi	Deti i Zi
RV02_032	Podujevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_033	Milloshevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_041	Bresje	Prishtevka	Deti i Zi
RV02_051	Vragoli	Graqanka	Deti i Zi
RV02_061	Pjetërshticë	Drenica	Deti i Zi
RV02_062	Vragoli	Drenica	Deti i Zi
RV02_062B	Drenicë	Çikatovë e Vjetër	Deti i Zi
RV02_071	Devetak	Shtime	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_072	Vojnovc	Shtime	Deti i Zi
RV03_011	Korbuliq	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_012	Kllokot	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_013	Ranillugë	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_014	Domoroc	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_021	Marec	Kriva reka	Deti i Zi
RV03_022	Domoroc	Kriva reka	Deti i Zi
RV04_011	Prevallë Subain	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_012	Kaçanik	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_013	Hani i Elezit	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_021	Jezerc	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_022	Bifurkacioni	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_023	Gërlicë	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_024	Kaçanik	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje

Shtojca 6: Vlerësimi i zbatimit të Stretegjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave [39]

№	Objektivat	Indikatori i arritjeve	Baza në vitin 2020	Caku	Statusi në vitin 2022
I.	**Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i një gjenerate të re të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave**				
I.1.	Objektivi specifik: Ofrimi i shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të mbledhjes së mbeturinave të ngurta komunale për tërë popullatën	Indikatori: Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të mbledhjes së mbeturinave komunale	74%	80% në vitin 2023	95%
I.2.	Objektivi specifik: Zhvillimi i rrjetit të integruar të qendrave të menaxhimit të mbeturinave	Indikatori: Përqindja e gjithsej mbeturinave të ngurta komunale të prodhuara që menaxhohen në qendra të kontrolluara	40%	60% në vitin 2023	78%
I.3.	Objektivi specifik: Zhvillimi i sistemeve për kontrollimin dhe menaxhimin e mbeturinave të tjera.	Indikatori: Përqindja e MND-ve të deponuara në deponi të caktuara dhe të ricikluara	0	3 qendra të MNRr në vitin 2024	0
		Indikatori: Disponueshmëria e planeve të menaxhimit të mbeturinave të sektorit	Nuk ka PMM për sektor	2 plane në vitin 2023	0
II.	**Objektivi strategjik 2: Profesionalizimi i sektorit të menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave**				
II.1.	Objektivi specifik: Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve profesionale në sektorin publik dhe privat	Indikatori: Kapaciteti profesional në sektorin publik dhe privat	Ofrohet nga partnerët zhvillimorë	Raportet e monitorimit	Mbështetje e vazhdueshme për ndërtimin e kapaciteteve
II.2.	Objektivi specifik: Caktimi i një kodi industrial për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave në statistikat kombëtare	Indikatori: Përfshirja e profesioneve dhe bizneseve deri në vitin 2023	Nuk ka njohje	Përfshirja e profesioneve deri në vitin 2023	0
		Indikatori: Organi i industrisë themelohet deri në vitin 2023	Nuk ka organ të themeluar	Organi i industrisë themelohet deri në vitin 2023	0
II.3.	Objektivi specifik: Promovimi i hulumtimit dhe zhvillimit në universitete	Indikatori: Kursi ose moduli MIMN-së krijohet në universitet deri në vitin 2025	Nuk ka kurs specifik për MIMN në dispozicion	1 kurs i miratuar deri në vitin 2025	0
III.	**Objektivi strategjik 3: Forcimi i rregullimit dhe kontrollit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke i plotësuar boshllëqet dhe duke i qartësuar mekanizmat e zbatimit**				
III.1.	Objektivi specifik: Krijimi i një sistemi informativ funksional për menaxhimin e mbeturinave	Indikatori: SIM-i është funksional në vitin 2021 dhe i qasshëm për publikun në vitin 2023	AKMM-ja publikon një raport vjetor për MMN-në	SIM ekziston dhe është i qasshëm në vitin 2023	0
III.2.	Objektivi specifik: Zgjerimi i sistemit të dhënies së licencave dhe lejeve për menaxhimin e	Indikatori: Mbulimi i plotë i dhënies së licencave dhe lejeve deri në vitin 2027	Mbulimi i pjesshëm i licencimit dhe lejeve të	50% e qendrave janë të mbuluara në	0

[39] *Raporti i Grupit punues për Mbrikqyrjen e Zbatimit të Strategjisë së Integruar për Menaxhimin e Mbeturinave*

	mbeturinave për t'i mbuluar të gjitha mbeturinat, operatorët dhe qendrat e menaxhimit të mbeturinave.		MM	vitin 2023	
		Indikatori: Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Industriale publikohet deri në vitin 2022	Nuk ka plan	1 plan	0
III.3.	Objektivi specifik: Forcimi i mekanizmave zbatues, ndërlidhur komunat dhe inspektoratet.	Indikatori: Mekanizmat dhe procedurat e zbatimit rishikohen deri në vitin 2022, ndërsa për të paktën 75% të shkeljeve të raportuara ekzistojnë mekanizmat dhe procedurat përkatëse të zbatimit që përdoren nga autoritetet kompetente deri në vitin 2024	Mekanizmat e zbatimit dhe realizimit nuk janë në zbatim	1 raport i rishikimit në vitin 2023	0
IV.	**Objektivi strategjik 4: Promovimi i vlerave dhe praktikave të një ekonomie qarkore**				
IV.1.	Objektivi specifik: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.	Indikatori: Rezultatet e fushatave publikohen në vitet 2024, 2027 dhe 2030	Nuk realizohet ndonjë fushatë e veçantë e vetëdijesimit	1 vlerësim i ndikimit të fushatës	0
IV.2.	Objektivi specifik: Stimulimi i risive në parandalimin e mbeturinave	Indikatori: Raundi i parë i aplikimit për grante për ide inovative përfundon në vitin 2023	Asnjë sistem granti nuk është krijuar	Skema e granteve të inovacionit në vitin 2023	0
IV.3.	Objektivi specifik: Krijimi i sistemeve të ripërdorimit dhe riciklimit të bazuara në konceptin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.	Indikatori: Deri në vitin 2024–mekanizmat e PZP-së aplikohen për 4 kategori të produkteve/fraksione të mbeturinave (ambalazhi, pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë, automjetet e jashtëpërdorimit)	Nuk zbatohet asnjë mekanizëm i PZP-së	Ekziston 1 skemë e PZP-së	0

Shtojca 7: Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetit[40]

Nr.	Aktiviteti	Institucionet përgjegjëse	Gjendja e arritur në realizim
1.	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen Natyrës.	MMPH, QRKS	Ky aktivitet është realizuar plotësisht.
2.	Të vazhdohet me promovimin e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës tek komuniteti.	MMPH, Komunat	Ky aktivitet është realizuar pjesërisht.
3.	Miratimi i programeve për mbrojtjen e natyrës për secilën komunë.	Komunat, MMPH	Pjesërisht i arritur, vetëm tri komuna kanë aprovuar Programe për ruajtjen e Biodiversitetit.
4.	Lobimi për ratifikimin e Konventave dhe traktateve relevante.	MPJ, MMPH, Kuvendi i Kosovës	Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak të statusit të Kosovë është arritur vetëm pranimi në IUCN.
5.	Harmonizimi dhe fuqizimi i legjislacionit dhe qartësimi i kompetencave për menaxhimin e Parqeve Kombëtare.	MMPH, MBPZHR, Kuvendi i Kosovës	Nuk është arritur, Draft-ligji për Pyjet është në procedurë të miratimit.
6	Fuqizimi i institucioneve kompetente dhe organeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti zhvillohet në vazhdimësi dhe është realizuar pjesërisht.
7.	Ngritja e kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare.	IKAP, Donatorët	Aktiviteti zhvillohet në vazhdimësi dhe është realizuar pjesërisht.
8.	Shpallja e Pashtrikut zonë e mbrojtur ndërkufitare.	Qeveria, MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht sepse me Vendim te QRKS zona është shpallur Park Natyror, kurse Republika e Shqipërisë akoma nuk e ka shpallur si ZM.
9.	Identifikimi dhe shpallja e zonave të rëndësishme të zogjve.	MMPH, Qeveria	Pjesërisht i arritur, për shkak të mungesës së kapaciteteve institucionale.
10.	Inventarizimi dhe paraqitja në hartë e llojeve të rralla të florës dhe faunës në "Bjeshkët e Nemuna".	MMPH, Donatorët	Pjesërisht i arritur, ky aktivitet zhvillohet në vazhdimësi.
11.	Përditësimi i inventarizimit të zogjve në "Bjeshkët e Nemuna".	MMPH, Donatorët, OJQ	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
12.	Inventarizimi dhe paraqitja në hartë e llojeve të rralla të florës dhe faunës në "Sharri".	MMPH, Donatorët	Pjesërisht i arritur, ky aktivitet zhvillohet në vazhdimësi.
13.	Përditësimi i inventarizimit të zogjve në “Sharri”.	MMPH, Donatorët, OJQ	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
14.	Inventarizimi i llojeve bimore invazive dhe aliene.	MMPH, MBPZHR	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
15.	Përgatitja dhe publikimi i Librit të Kuq të Faunës.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar plotësisht, Libri për Faunën i publikuar.
16.	Sigurimi i pajisjeve për hulumtime dhe monitorimin e burimeve natyrore.	MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, janë siguruar pajisje për monitorim (trap kamera GPS, Kamera etj).

[40] *Raporti për Gjendjen e Natyrës 2018-2021, AMMK 2022*

17.	Fuqizimi i Bankës së Burimeve Gjenetike për bimët dhe Themelimi i Bankës së Burimeve Gjenetike për kafshët.	MASHT, UP, MMPH	Aktiviteti nuk është realizuar, ka disa veprime që janë realizuar nga Fakulteti i Veterines dhe Bujqësisë i UP posaçërisht tek bimët.
18.	Përgatitja e doracakut për interpretimin e llojeve të vendbanimeve në përputhje me Direktivën e Vendbanimeve.	MMPH, Donatorët, UP,	Aktiviteti nuk është realizuar, per shkake të mungesës së mjeteve finaciare dhe kapacitetet institucionale.
19.	Zhvillimi i Sistemit Qendror Informativ (SQI) për biodiversitetin.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti pjesërisht është realizuar SQI është organizuar në kuadër të Sistemit Informativ Mjedisor (SIM).
20.	Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për paraqitjen hartografike të vendbanimeve dhe inventarizimin e llojeve (trajnimet).	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar pjesërisht stafi është trajnuar për inventarizimin e llojeve
21.	Mbledhja e të dhënave për tipat e vendbanimeve dhe llojet (përfshirë shpërndarjen, përfaqësimin, etj.) duke përfshirë punën në terren.	MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht një hulumtim preliminar i vendbanimeve natyrore prezentë në Republikën e Kosovës është zbatuar, nevojitet të vazhdohet në të ardhmen.
22.	Prodhimi i hartave të shpërndarjes për të gjitha tipat e vendbanimeve dhe llojet, bazuar në të dhënat ekzistuese.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, disa harta preliminare janë realizuar (definimi i regjioneve biogjeografike) kurse në të ardhmen duhet vazhduar me pergatitja e hartave sipas kërkesave për Rrjetin ekologjik "Natura 2000".
23.	Vazhdimi i zbatimit efektiv të procedurave të VSM dhe VNM.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti zbatohet në vazhdimësi në pajtim me ligjin e VNM dhe VSM.
24.	Përgatitja dhe miratimi i planeve rregulluese dhe Planit menaxhues për PK. "Bjeshkët e Nemuna".	MMPH, Donatorët, Kuvendi i Kosovës	Me mbështetjen e Programit Mjedisor për Kosoven (SIDA) këto plane janë përgatitur por akoma nuk janë aprovuar.
25.	Përgatitja dhe miratimi i planeve të menaxhimit për zonat e tjera të mëdha të mbrojtura (mbi 500 ha).	MMPH, MBPZHR, Donatorët	Ky aktivitet nuk eshte realizuar.
26.	Përgatitja e Planeve të menaxhimit për llojet e gjitarëve të mëdhenj.	MMPH, MBPZHR, UP, OJQ, Donatorët	Nuk ka rezultate të prekshme, edhe pse janë zhvilluar konsultime me akterët përgjegjës, ky veprim pritet të bartet për realizim në dokumentet.
27.	Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Drini i Bardhë.	MMPH, Donatorët	Me mbështetjen e Programit Mjedisor për Kosovën (SIDA) Plani i Menaxhimit të Pellgut Drini i Bardhë është përgatitur por akoma nuk është aprovuar.
28.	Zhvillimi i masave nxitëse për promovimin e ruajtjes së biodiversitetit tek sektorët tjerë, të vazhdohet me zbatimin e masave në sektorin e pylltarisë - bujqësisë.	MMPH, MBPZHR	Ky aktivitet pjesërisht është realizuar me pjesëmarrjen në GP në hartimin e politikave tek sektorët tjerë me ndikim.
29.	Të vazhdohet me politikën e shqyrtimit të legjislacionit të sektorëve tjerë relevant në lidhje me objektivat, praktikat dhe rregulloret. që potencialisht kanë ndikim negativ në biodiversitet.	MMPH, MZHE, MTI, MBPZHR	Ky aktivitet zhvillohet në vazhdimësi me pjesëmarrjen në GP në hartimin e legjislacionit tek sektorët tjerë me ndikim në biodiversitet.

30.	Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e "Vlerësimit të Pranueshmerisë" (VP), në përputhje me Direktivën e Vendbanimeve.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti nuk është realizuar për shkak të mos mbështetjes nga donatorët, kurse MMPH nuk ka kapacitete që të ofrojë trajnime të tilla.
31.	Vazhdimi i përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës gjatë përgatitjes së legjislacionit, strategjive, programeve dhe planeve të sektorëve tjerë relevant.	MZHE, MTI, MI, MBPZHR	Aktiviteti zhvillohet në kontinuitet dhe aktualisht mundë të vlerësohet si pjesërisht i përmbushur.
32.	Zbatimin e programeve shtesë të trajnimit për mësuesit në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe zbatimin e kurrikulës në të gjitha nivelet.	MASHT, MMPH, Drejtoritë Komunale	Ky aktivitet është realizuar në vazhdimësi.
33.	Vazhdimi i Projektit Pako e Gjelbër Junior, trajnimi i mësimdhënësve të ciklit të ultë.	MASHT, MMPH, Drejtoritë Komunale	Aktiviteti është realizuar në disa prej komunave për temat e përzgjedhura.
34.	Rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve lokalë që jetojnë brenda ose në afërsi të zonave të mbrojtura.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, shembulli Projekti i Financuar nga JICA në Suharekë.
35.	Fuqizimi i bashkëpunimit në mes MMPH-së dhe OJQ-të për aktivitete të edukimit jo-formal.	MMPH, OJQ	Aktiviteti është realizuar përmes aktiviteteve me rastin e shënimit të festave mjedisore, javës së gjelbër për zhvillim të qëndrueshëm.
36.	Zhvillimi i Projektit të Eko shtegut në Parkun Regjional "Gërmia" si dhe planit të menaxhimit me fokus në edukim.	Komuna e Prishtinës, Donatorët	Aktiviteti është realizuar plotësisht, shtegu është funksional.
37.	Zhvillimi dhe Zbatimi i Projektit Kopshti Botanik.	MMPH, Donatorët	Aktiviteti nuk është realizuar për mungesë të fondeve.
38.	Zhvillimi dhe zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit në nivel kombëtar.	MMPH, MBPZHR, MZHE, MTI, MI, Mediat	Aktiviteti është realizuar pjesërisht dhe duhet të vazhdojë në të ardhmen.
39.	Shtimi i stafit universitar për taksonomi, hartografi, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit.	MAShT, UP	Aktiviteti është realizuar pjesërisht me angazhim të stafit për fushatë specifike.
40.	Mbështetja e hulumtimeve shkencore dhe projekteve në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit.	MAShT, UP, MMPH	Aktiviteti është realizuar pjesërisht, aktivitet të tilla zhvillohen në kontinuitet.
Legjenda sqaruese:			
I realizuar plotësisht		**Pjesërisht i realizuar**	**Nuk është realizuar**

Shtojca 8: Vlerësimi i zbatimit të Stretgjisë Kombëtare të Ujërave[41]

Masa	Veprimet e planifikuara	Zbatimi	Veprimet e ndërmarra	Progresi i vlerësuar
OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJËRAVE "Të shpërndajë dhe shfrytëzojë në mënyrë të qëndrueshme resurset ujore të Kosovës tek shfrytëzuesit e saj në mënyrë që të garantojë qasje në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin për të gjithë dhe të maksimizojë përfitimet ekonomike nga përdorimi i ujërave për qëllime tjera"				
Masa 1.1: Rritja e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e resurseve ujore.	• Hartimi i studimit të fizibilitetit për rritjen e kapaciteteve akumuluese të ujit: Të gjitha pellgjet. • Mbështetja në zbatim (hartimi i dokumentacionit projektues dhe tenderues për projektet prioritare) – rritja e kapacitetit të depozitimit të ujit: Të gjitha pellgjet. • Ndërtimi – rritja e kapacitetit për akumulimin e ujit: Të gjitha pellgjet.	Pjesërisht Pjesërisht JO	• Është hartuar studimi i fizibilitetit për hidrosistemin Lepenc (2020). • Janë planifikuar për vitin 2023 studimet e fizibilitetit për akumulimet: Dragaçinë, Pollatë dhe Drelaj. • Është në proces hartimi i projektit ideor ("preliminary design") dhe studimit të VNSM për sistemin Lepenc. • Në kuadër të projektit FLOËS është formuar NJZP për akumulimin e Desivojcës. • Nuk ka filluar ende ndërtimi i akumulimeve.	Progres i pjesshëm.
Masa 1.2: Rritja e efiçiencës në shfrytëzimin e ujit.	• Zvogëlimi i rrjedhjeve nga sistemet e furnizimit të ujit me shumicë. • Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e furnizimit me ujë. • Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e ujitjes. • Rritja e efiçencës në shfrytëzimin e ujit për ujitje.	Nuk ka informata PO JO JO	• Të gjitha KRU-të i kanë hartuar Strategjitë për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit: 2018-2022. • Humbjet e ujit në nivel të sektorit të shërbimeve të ujit, në periudhën 2017-2021, janë zvogëluar për 3 pikë të përqindjes (nga 58% në 55%). • Për Kompanitë e Ujitjes dhe për furnizuesit e ujit me shumicë nuk ka informacion nëse kanë hartuar strategji për zvogëlimin e humbjeve dhe sa është progresi në zvogëlimin e humbjeve të ujit.	Progres i pjesshëm nga KRU-të.
Masa 1.3: Sigurimi i ushtrimit të kontrollit mbi të gjitha burimet ujore.	• Fushata e zbatimit të lejeve për shfrytëzimin e ujërave. • Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të pijshëm. • Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit për ujitje.	PO Pjesërisht S`ka info	• Inspektorati i Ujërave ka hartuar: 806 procesverbale, 143 inicime për kundërvajtje, 287 vendime dhe 218 gjoba administrative. • ARPL ka ngritur efikasitetin e kontrollit mbi shfrytëzimin e ujit sidomos në vitin 2021 kur janë lëshuar 116 leje ujore (krahasuar me vitin 2020 kur janë lëshuar 68 leje ujore, dhe me vitin 2019 kur janë lëshuar 9 leje ujore). • KRU-të kanë zvogëluar UPF për 3 pikë të përqindjes.	Progres i pjesshëm.

[41] *Raport për monitorimin e zbatimit të strategjisë së ujërave të Kosovës 2017-203, PUACW Project, LDIP 2023*

Masa 1.4: Zvogëlimi i shkallës së mos pagesës për shfrytëzimin e ujit nën 5%.	• Rritja e nivelit të pagesave për shfrytëzimin e ujit. • Ngritja e shkallës së pagesave për furnizimin me ujë. • Ngritja e shkallës së pagesave për ujitje.	PO PO PO	• Arkëtimi për pagesat ujore është rritur substancialisht në vitin 2021 kur janë arkëtuar të hyra në lartësi 1.5 mil EUR, krahasuar me vitin 2020 kur janë arkëtuar 0.6 mil/ EUR dhe sidomos krahasuar me vitin 2019 kur janë arkëtuar 0.2 mil. EUR. • Shkalla e arkëtimit të faturave për shërbimet e ujit është rritur në 96% në vitin 2021. • Shkalla e arkëtimit të KU "Radnoqi-Dukagjini": 90-98%, KU "Drini i Bardhë": 79%.	Progres substancial
Masa 1.5: Të integrohen sistemet lokale dhe rurale të furnizimit me ujë në KRU.	• Zhvillimi i planit të veprimit për integrimin e sistemeve lokale dhe rurale. • Implementimi i Planit të veprimit për integrimin e sisteme lokale dhe rurale.	JO JO	• Nuk janë hartuar planet e veprimit nga KRU-të dhe komunat për integrimin e sistemeve rurale në KRU. • Në kuadër të projektit RËSSP-VI të financuar nga qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës në vlerë 15.75 milion EUR janë rehabilituar dhe integruar një numër i sistemeve rurale dhe komunale të ujësjellësit. • Deri në vitin 2021 janë integruar gjithsej 184 sisteme rurale në KRU. Kanë mbetur pa u integruar edhe mbi 100 sisteme rurale.	Progres i pjesshëm
Masa 1.6: Arritja e përputhshmëris ë me Direktivën Evropiane për Ujë të Pijshëm.	• Modernizimi i laboratorëve të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit. • Përmirësimi i impianteve të trajtimit të ujit të pijshëm. • Përmirësimet në mbrojtjen e burimeve. • Përmirësimi i performancës së rrjeteve ekzistuese të furnizimit. Riparimi i rrjeteve të vjetëruara, Instalimi i matësve zonal të prurjes, Instalimi i ujëmatësve te konsumatorët.	PO Pjesërisht PO Pjesërisht	• Dy prej shtatë KRU-ve i kanë laboratorët e akredituar, të tjerat i kanë laboratorët por janë në proces të akreditimit. • Është miratuar nga MMPHI Udhëzimi Administrativ për Zonat e Mbrojtura Sanitare të Burimeve të në vitin 2017. • Është miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2021 Udhëzimi Administrativ për Cilësinë e Ujit të Pijshëm me të cilin janë transpozuar direktivat relevante të BE-së. • Është marrë vendimi nga MMPHI për ndalimin e transportit të materieve të rrezikshme në rrugën afër liqenit të Badovcit. • Shkalla e përputhshmërisë së mostrave të testuara për cilësinë e ujit të pijshëm që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU-të është mbi 98%.	Progres substancial

Masa 1.7: Programi investues për sistemin e furnizimit me ujë (24.7 mil. EUR për periudhën 2017-2021)	• Renovimi i sistemeve të ujësjellësit, me qëllim që deri në vitin 2024, të: Ngritet shkalla e mbulueshmërisë me sistem publik të ujësjellësit në 100% në zonat urbane dhe te Ngritet mbulueshmëria me sistem publik të ujësjellësit në 90% në zonat rurale. - Përmirësohet trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së.	Pjesërisht zona urbane 99.15% zonat rurale: 66.7%	• Janë investuar në total rreth 129 milion EUR si vijon: • Është zbatuar faza e VI-të e programit RËSSP për sistemet rurale në bashkëfinancim të Qeverisë së Kosovës me Qeverinë Zvicerane në vlerë 15.75 mil EUR. • Përmes KRU-ve (nga të hyrat vetanake dhe grantet) janë investuar 88.5 mil EUR. • Përmes komunave janë investuar rreth 20 mil EUR. • Përmes MMPHI janë investuar rreth 5 mil EUR.	Progres substancial.
Masa 1.8: Optimizimi i mbulueshmëris ë me sistem për ujitje.	• Përgatitja e planeve investive nga Kompanitë e Ujitjes. • Implementimi i planeve biznesore të zhvillimit të Kompanive të Ujitjes. • Investimet në Sistemin e Ujitjes (2017-2022: 23.21 milion EUR)	PO PO JO	• Është hartuar Masterplani i Ujitjes ku janë identifikuar nevojat dhe projektet e ujitjes. • Investimet e realizuara (rreth 3.5 milion EUR): -KU "Radoniqi-Dukagjini": 2021-2022 – 3,176,629 EUR dhe KU "Drini i Bardhë" 2017-2018 – 313,000 EUR	Progres i pjesshëm.
Masa 1.9: Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit nga shfrytëzues tjerë.	• Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion. • Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve. • Përgatitja e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore. • Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale duke respektuar nevojat dhe të drejtat e shfrytëzuesve që gjenden në rrjedhën e poshtme	JO JO JO JO	• Nuk është hartuar një plan afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve nga MBPZHR dhe MMPHI. • Nuk është hartuar një plan afatgjatë për shfrytëzim të ujit për turizëm dhe rekreacion nga MINT dhe MMPHI. • Nuk është hartuar një strategji për shfrytëzim të qëndrueshëm të aluvioneve të lumenjve nga MZHE dhe MMPHI. • MMPHI ka kryer rishikimin e lejeve të lëshuara për hidrocentrale të vogla dhe janë dhënë rekomandimet për të ardhmen.	Pa progres.
Masa 1.10: Plani për menaxhimin e thatësirave.	• Masat Ligjore dhe Institucionale për Menaxhimin e Thatësirave (Udhëzim administrativ për monitorimin dhe menaxhimin e thatësirave); • Përcaktimi i përgjegjësive institucionale (Masat për koordinim ndërkombëtar] Planet e Menaxhimit të Thatësirave. • Sistemi i Paralajmërimit të Thatësirave.	Pjesërisht PO PO	• KRU-të i kanë hartuar planet e tyre të menaxhimit të thatësirës. • MMPHI nuk e ka hartuar ende një plan kombëtar për menaxhimin e thatësisë.	Progres i pjesshëm.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE "Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që bëjnë presion në mjedisin ujor në mënyrë proporcionale, efiçente dhe efektive që të arrihen objektivat mjedisore në mënyrë të arsyeshme ekonomike për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe në të njëjtën kohë të respektohen parimet e menaxhimit të qëndrueshëm."				
Masa 2.1: Kontrollimi i shkarkimeve ndotëse.	• Kampanja për zbatimin e rregullave për shkarkimin e ujërave. • Lejet për shkarkime të drejtpërdrejta nga impiantet e mëdha industriale. Regjistri i impianteve të mëdha • Karakteristikat e shkarkimeve • Aplikimi dhe procedimi i lejeve • Licencimi i shkarkuesve indirekt. • Programi i Vlerësimit të Lejeve për Shkarkimin e Ujërave.	JO Pjesërisht JO JO	• MMPHI nuk e ka krijuar ende një regjistër të plotë të shkarkimeve të ujërave të ndotura më trupat ujorë nga objektet e mëdha industriale me karakteristikat e shkarkimeve. • Prej 6 subjekteve të mëdha industriale, 3 nuk kanë leje, 2 kanë leje të integruar dhe vetëm 1 ka leje ujore: (Trepça – SH.A, S`ka leje, Neë Co - Ferronikeli Ka leje të integruar, Kek - SH.A Ka apliku për leje ujore, Sharrcem - SH.P.K Ka leje të integruar, F.P.K - Deve Ka leje ujore, Birra Peja – SH.A Ka apliku • KRU-të nuk i kanë kompletuar regjistrat për shkarkimet e ujërave të ndotura industriale në kanalizimin publik. • Është miratuar nga MMPHI Udhëzimi i ri Administrativ nr. 02/2022 për Vlerat Kufizuese të Shkarkimeve të Ujërave të Ndotura në Trupat Ujorë dhe në Kanalizimin Publik me të cilin është transpozuar Direktiva Nr. 91/271/EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane.	Progres i vogël.
Masa 2.2: Zgjerimi i mbulueshmëris ë me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura.	• Investimet nga Qeveria dhe donatorët në ndërtimin e sistemeve të grumbullimit të ujërave të ndotura. • *Shënim:Në dokumentin e Strategjisë nuk janë specifikuar veprimet e planifikuara.*	Pjesërisht	• Mbulueshmëria me sisteme publike të grumbullimit të ujërave të ndotura ka arritur në 75% të popullsisë – prej tyre 65% menaxhohen nga KRU-të (në zonat urbane 97% ndërsa në zonat rurale 46%) • Në periudhën 2018-2020 janë zbatuar 8 projekte përmes MMPHI me të cilat janë ndërtuar sistemet e kanalizimit për 30 fshatra.	Progres i pjesshëm.

Masa 2.3: Përmirësimi dhe ruajtja e funksionalitetit të sistemeve ekzistuese të grumbullimit të ujërave të ndotura.	• Investimet nga Qeveria dhe donatorët në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të grumbullimit të ujërave të ndotura. • *Shënim: Në dokumentin e Strategjisë nuk janë specifikuar veprimet e planifikuara.*	Pjesërisht	• Janë zbatuar projektet e mbështetura nga KfË në Prizren, Pejë dhe Gjakovë në vlerë totale 17.5 mil. EUR; • Është kompletuar studimi i fizibilitetit për sistemin e kanalizimit ë rajonit të Prishtinës mbështetur nga KfË. • Është në përgatitje projekti për përmirësimin e sistemit të kanalizimit në rajonin e Prishtinës (komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Podujevë) mbështetur nga KfË në vlerë rreth 70 milion EUR.	Progres i pjesshëm.
Masa 2.4: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura.	• Investimet nga Qeveria dhe donatorët në trajtimin e ujëfrave të ndtura urbane. • *Shënim: Në dokumentin e Strategjisë nuk janë specifikuar veprimet e planifikuara.*	PO	• Përqindja e ujërave të ndotura që trajtohen është rritur nga 1% në 11%. • Janë finalizuar dhe janë lëshuar në funksion impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën. • Janë në fazën e planifikimit dhe projektimit impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prishtinën, Gjilanin dhe Mitrovicën (këto impiante planifikohet të kompletohen deri në vitin 2026). • Është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Orllan me qëllim të mbrojtjes së akumulimit të Batllavës.	Progres substancial.
Masa 2.5: Programi i investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura (46.2 mil. EUR, 2017-2021)	• Investimet e planifikuara 2017-2021: 46 milion EUR.	PO	• Janë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën). • Janë zgjidhur modalitetet e investimit për implementimin e investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura në vlerë rreth 150 mil. EUR (ITUN për Prishtinën, Mitrovicën dhe Gjilanin).	Progres substancial.
Masa 2.6: Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.	• Përgatitja e strategjisë shtetërore për menaxhimin dhe largimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura. • Investimet që kanë të bëjnë me strategjinë e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura.	Pjesërisht JO	• Është iniciuar hartimi i planeve për menaxhimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me vendim të Këshillit Ndërministror për Ujëra • Operatorët e impianteve të ujërave të ndotura (KRU-të) duhet t`i hartojnë ato deri në fund të vitit 2022.	Progres i vogël.

Masa 2.7: Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia.	• Udhëzues për prodhuesit bujqësorë – përdorimi i plehrave organike. • Udhëzimet për Prodhuesit Bujqësorë – Përdorimi i Biocideve.	JO JO	• Nuk ka pasur asnjë progres: nuk janë hartuar udhëzimet për përdorimin e plehrave në bujqësi e as udhëzimet për përdorimin e biocideve nga MBPZHR.	Pa progres.
Masa 2.8: Ulja e ndotjeve difuzive nga burimet jo-bujqësore	• Regjistri i tokave të kontaminuara: • Identifikimi i zonave më të kontaminuara • Përgatitja e hartave • Plani dhe Strategjia për Rehabilitimin e Tokave të Kontaminuara. • Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale – i menjëhershëm.	JO	• Nuk ka pasur asnjë progres: nuk është përgatitur nga MMPHI regjistri i tokave të kontaminuara e as strategjia për rehabilitimin e tokave të kontaminuara.	Pa progres.
OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: MBROJTJA NGA UJËRAT "Të arrihet niveli i pranueshëm i mbrojtjes së popullatës dhe pronave nga efektet negative të ujit duke përfshirë vërshimet, erozionin dhe vërshimet në mënyrë të balancuar ekonomike dhe kosto-efektive."				
Masa 3.1: Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet.	• Krijimi i një sistemi të mbledhjes, verifikimit dhe publikimit të të dhënave. • Përgatitja e Planeve të para të Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet (këtu përfshihen hartat e rrezikut dhe hartat e rrezikshmërisë nga vërshimet). • Mbështetja për zbatimin e Planeve për Menaxhimin e Rrezikut nga Vërshimet. • Sistemi për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës për parandalimin e vërshimeve.	Pjesërisht JO JO JO	• Në vitin 2021 është filluar projekti për përgatitjen e hartave të rrezikut nga përmbytjet për të gjitha pellgjet lumore të Kosovës, të cilat janë kompletuar në vitin 2022. Vlera e projektit 2.5 mil. EUR. • Në vitin 2020 është kryer vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet, projekt i financuar nga donatorët në vlerë 0.6 mil. EUR. • Planet e menaxhimit të rrezikut nga vërshimet nuk janë kompletuar ende (sipas Strategjisë është dashur të kompletohen në vitin 2019). • Nuk ka sistem për mirëmbajtjen e rregulltë dhe prevetive të infrastrukturës për mbrojtje nga vërshimet.	Progres i vogël.

Masa 3.2: Paralajmërimi i vërshimeve dhe menaxhimi i emergjencave.	• Sistemi i monitorimit dhe paralajmërimit të rrezikut nga vërshimet. [Sistemi përfshin: (i) përgatitjen e sistemit shtetëror për paralajmërimin e vërshimeve të bazuar në ISR (ii) monitorimin e sistemit rajonal të paralajmërimit për vërshime bazuar në MeteoAlarm (iii) monitorimin e statusit të vërshimeve dhe lëshimi i paralajmërimeve sipas nevojës (iv) regjistrimin në forumin EFAS dhe monitorimi në baza të rregullta.] • Menaxhimi i emergjencave të vërshimeve. [(i) Procedurat në rast emergjence, (ii) Prokurimi i pajisjeve, (iii) Trajnimi]	Pjesërisht Pjesërisht	• Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës e ka krijuar sistemin e paralajmërimit të hershëm të përmbytjeve përmes SPI. Ky sistem duhet të avancohet dhe të lidhet me MeteoAlarm. • Procedurat për veprim në rast të vërshimeve janë përcaktuar me UA nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave.	Progres i pjesshëm.
Masa 3.3: Infrastruktura për parandalimin dhe mbrojtjen nga vërshimet.	• Investimet në Infrastrukturën për Mbrojtje nga Vërshimet– Faza 1 [Rehabilitimi i strukturave ekzistuese për mbrojtje nga vërshimet. Implementimi i projekteve të gatshme për investime për infrastrukturën e re për parandalimin e vërshimeve] • Sistemi i Drenazhimit Urban (Kanalizimi i ujërave atmosferike në zonat urbane). • Investimet në infrastrukturën për mbrojtje nga vërshimet – Faza 2 [Implementimi i masave dhe projekteve të përcaktuara me prioritet me Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet]	PO JO JO	• Në periudhën 2017-2021 janë realizuar investime të konsiderueshme përmes MMPHI dhe në bashkëfinancim me komunat në rregullimin e lumenjve – 33 projekte. Këto investime tejkalojnë investimet e parapara me Strategji për këtë qëllim në periudhën 2017-2021 në vlerë 4.3 mil. EUR. • Asnjë komunë nuk ka plan për drenazhimin urban – sistemin e kanalizimit atmosferik. • Investimet e fazës 2 bazuar në Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet nuk kanë mundur të implementohen duke pasur parasysh se ky plan nuk është kompletuar ende.	Progres i vogël.

Masa 3.4: Sigurimi që të gjitha strukturave ekzistuese akumuluese janë të sigurta.	• Sistemi i menaxhimit të sigurisë së digave. • Renovimi i digave ekzistuese dhe akumulimeve	PO Pjesërisht	• MMPHI ka zbatuar një projekt për vlerësimin e sigurisë së digave dhe rrezikun sizmik i cili është zbatuar në vitin 2021-2022. Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar personeli i KRU-ve për sigurinë e digave. • Në vitin 2018 është rehabilituar diga e Përlepnicës. • MMPHI ka hartuar Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave me të cilin janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale për operimin dhe mirëmbajten e digave si dhe standardet e projektimit dhe ndërtimit.	Progres i pjesshëm.
Masa 3.5: Menaxhimi i erozionit dhe rrëkeve.	• Përgatitja e Planeve për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit. • Implementimi i Planeve për Menaxhimin e Rrëkeve dhe Erozionit.	JO JO	• Nuk ka pasur progres.	Pa progres.
OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: QEVERISJA "Krijimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të qeverisjes me ujërat që është i drejtë, transparent, efiçent, i koordinuar dhe me kapacitete të tilla profesionale dhe teknike që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efiçiente arritjen e objektivave strategjike"				
Masa 4.1: Legjislacioni për menaxhimin mjedisor të ujërave.	• Vlerësimi i kostos së përputhshmërisë së legjislacionit të propozuar. Vlerësimi fillestar i Kostos së Zbatimit (i thjeshtuar) Përcaktimi i rëndësisë së kostove Vlerësimi i detajuar nëse konstatohet se kostot janë të rëndësishme Analiza e ndjeshmërisë: standardet kundrejt kostos • Vlerësimi i ndikimit rregullator nga legjislacioni i propozuar. • Mbështetja për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e ujërave: [(i) Publikimi i legjislacionit – baza e plotë e të dhënave në internet, (ii) Procedura e shpërndarjes – reklama, njoftime, (iii) Tekste shpjeguese për të gjitha instrumentet ligjore, (iv) Udhëzues dhe këshilla teknike për të gjitha palët e interesit]	Pjesërisht JO JO	• Miratimi i secilit akt nënligjor përcillet me vlerësimin e kostove për zbatim. • Janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore që kërkohen sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës - gjashtë në periudhën 2017-2021. • Nuk është hartuar një vlerësim i plotë i kostove për zbatimin e legjislacionit ujor dhe transpozimit të direktivave të ujit. • Nuk është kompletuar një sistem për mbështetje të zbatimit të legjislacionit që do të përfshinte udhëzuesit për zbatimin e të gjitha akteve normative.	Progres i vogël.

Masa 4.2: Tranzicioni drejt transpozimit të legjislacionit të BE.	• Transpozimi i procesit ë planifikimit të menaxhimit të ujërave. • Transpozimi i objektivave afatgjata për menaxhimin e ujërave. • Përcaktimi i Objektivave Kalimtare.	PO PO Pjesërisht	• Me Ligjin për Ujëra dhe aktet nënligjore të miratuara nga MMPHI gjatë periudhës 2017-2019 është tranpozuar procesi i planifikimit të menaxhimit të resurseve ujore (PMPL, Planet e Vërshimeve, afatet dhe përmbajtja etj.). • Përmes Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore që janë në proces të hartimit, janë duke u zbatuar parimet e planifikimit të menaxhimit të pellgjeve lumore, përfshirë përcaktimin e objektivave mjedisore, klasifikimin e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, analizën e • presioneve dhe programin e masave.	Progres i pjesshëm.
Masa 4.3: Përforcimet institucionale.	• Themelimi dhe Funksionalizimi i plotë i Autoritetit të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore. • Përforcimi i Inspektoratit Mjedisor të Divizionit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. • Përforcim substancial i Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës. • Themelimi i Institutit për Ujërat • Fuqizimi i ARRU për rregullimin e trajtimit të ujërave të ndotura [4 pozita të reja]	Pjesërisht JO JO JO JO	• Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) është themeluar dhe prej vitit 2017 funksionon si departament brenda MMPHI. • Personeli i ARPL nuk është kompletuar ende sipas strukturës organizative të tij. • Nuk ka pasur progres të duhur në fuqizimin institucional të Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK): laboratori ka mbetur i pa-akreditуar, personeli nuk është rritur. • Inspektorati Mjedisor nuk është kompletuar sipas SSHUK–nuk është rritur numri i inspektorëve me 5 inspektorë shtesë siç ishte planifikuar. • Instituti për Ujëra nuk është themeluar.	Progres i vogël.
Masa 4.4: Menaxhimi i informacioneve.	• Sistemi i informativ për ujërat. • Marrëveshja dhe procedura e shkëmbimit ndër institucional i të dhënave. • Publikimi i të gjitha të dhënave për sektorin e ujërave përmes një portali në internet.	PO JO Pjesërisht	• Është krijuar një sistem informativ i menaxhimit të ujërave në vitin 2021, i cili duhet të zhvillohet më tutje dhe të plotësohet me të dhëna.	Progres i pjesshëm.

Masa 4.5: Edukimi në menaxhimin e ujërave.	• Fushata publike e ndërgjegjësimit për çështjet e ujërave. • Të sigurohet që kurrikula shkollore të përfshijë përmbajtje të duhur që ka të bëjë me ujërat duke përfshirë: Ciklin Ujor, Shfrytëzimin e Ujërave, Ndotjen e Ujërave, Kursimin e Ujit, Parandalimin e ndotjes së ujërave, Rrezikun nga vërshimet. • Implementimi i rekomandimeve të studimit të TFU për zhvillimin akademik.	PO Pjesërisht Pjesërisht	• Përmes projektit Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU) i financuar nga Qeveria e Zvicrës, publikohet buletini "Uji i Kosovës" ku jepen informacione për qëllime të ndërgjegjësimit për çështjet për ujërat. • Përmes projektit MIRU është planifikuar dhe pritet të fillojë në vitin 2023 programi Master në menaxhimin e resurseve ujore në kuadër të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".	Progres i pjesshëm.
Masa 4.6: Planifikimi për menaxhim të integruar të pellgjeve lumore	• Planet e para për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve. • Përgatitja e Planeve të Dyta për Menaxhimin e Pellgjeve të Lumenjve. • Ndërveprimi i dytë me Planet për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve.	Pjesërisht JO JO	• Plani për Menaxhimin e Pellgut të Lumit Drini i Bardhë është në fazën e finalizimit, me mbështetjen financiare nga Qeveria e Suedisë (SIDA). • Planet për menaxhimin e tri pellgjeve tjera lumore (Lepenci, Ibri dhe Morava e Binçës) janë në fazën fillestare të planifikimit, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Zvicrës përmes programit MIRU.	Progres i vogël.

Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2022,

është përgatitur nga Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit e AMMK,

në mbështetje edhe të njësive tjera të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Adresa e AMMK-së:

Adresa: *Rruga Luan Haradinaj, Ndërtesa e Re e Qeverisë së Kosovës (ish Pallati i Mediave Rilindja) Kati XV/04, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës*

Tel: *+383 38 200 74093 Email: ammk@rks-gov.net*

Prishtinë, Korrik 2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructur

www.ammk-rks.net

Adresa: Rruga Luan Haradinaj,
Ndërtesa e Re e Qeverisë së Kosovës
(ish Pallati i Mediave Rilindja),
Kati XV/04, 10000 Prishtinë
Tel:+383 38 200 74093
email: ammk@rks-gov.net